

DIREKTIVA 2009/65/KE E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E KËSHILLIT, datë 13 Korrik 2009, “Për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT)”

(reformulim)

(Tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe në veçanti Nenin 47, paragrafi 2 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në Nenin 251 të traktatit ⁽¹⁾,

Meqë:

- ¹ Direktiva e Këshillit 85/611/KEE e 20 Dhjetorit 1985 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative që lidhen me sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT) ⁽²⁾ është ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme disa herë ⁽³⁾. Meqë do të bëhen ndryshime të reja, kjo direktivë duhet të riformulohet për të qenë më e qartë.
- Direktiva 85/611/KEE ka kontribuar së tepërmi në zhvillimin dhe suksesin e industrisë së fondeve evropiane të investimeve. Sidoqoftë, pavarësisht përmirësimeve të prezantuara që prej miratimit të saj, në veçanti në vitin 2001, është bërë gjithmonë e më e qartë se në kuadrin ligjor të SIKTT-ve duhet të bëhen ndryshime me qëllim përshtatjen e tij me tregjet financiare të shekullit të njëzetë e një. Dokumenti i Gjellbër i Komisionit i 12 Korrikut 2005 për zgjerimin e kuadrit të BE-së për fondet e investimeve, nisi një debat publik për mënyrën në të cilën duhet të ndryshohet Direktiva 85/611/KEE, me qëllim përmbushjen e atyre sfidave të reja. Nga ky proces i thelluar konsultimesh u arrit në përfundimin e rënë dakord gjerësisht se, në atë direktivë nevojiten ndryshime thelbësore.
- Ligjet e brendshme që rregullojnë sipërmarrjet e investimeve kolektive duhet të koordinohen me synimin e përafrimit të kushteve të konkurrencës ndërmjet këtyre sipërmarrjeve në nivel Komuniteti, ndërkohë që në të njëjtën kohë garantohet mbrojtje më tepër efikase dhe më tepër uniforme për mbajtësit e kuotave. Ky koordinim lehtëson heqjen e kufizimeve për lëvizjen e lirë të kuotave të SIKTT-ve në Komunitet.
- Duke pasur parasysh ato objektiva, preferohet të parashikohen rregulla bazë të përbashkëta për autorizimin, mbikëqyrjen, strukturën dhe veprimtarinë e SIKTT-ve të themeluara në shtetet anëtare dhe për informacionin që ato duhet të publikojnë.
- Koordinimi i ligjeve të shteteve anëtare, duhet të kufizohet për SIKTT-të, përveç atyre me pjesëmarrje të mbyllur, që nxisin shitjen e kuotave të tyre për publikun në Komunitet. Preferohet që si pjesë e objektivit të tyre të investimit, SIKTT-të të lejohen të investojnë në instrumente financiare, përveç titujve të transferueshëm, të cilat kanë likuiditet të

mjaftueshëm. Instrumentet financiare, të cilat kualifikohen për të qenë asete investimesh të portofolit të SIKTT-ve, duhet të renditen në këtë Direktivë. Përzgjedhja e investimeve për portofolin nëpërmjet indeksit është teknikë menaxhimi.

6. Në rastet kur një dispozitë e kësaj direktive kërkon që SIKTT-të të ndërmarrin veprime, kjo dispozitë duhet të kuptohet se i referohet shoqërisë administruese në rastet kur SIKTT ka formën e një fondi të përbashkët të administruar nga një shoqëri administruese dhe në rastet kur fondi i përbashkët nuk është në pozicionin për të vepruar më vete për shkak se nuk ka personalitet juridik të vetin.
7. Kuotat e SIKTT-ve konsiderohen se janë instrumente financiare për qëllime të Direktivës 2004/39/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 21 Prillit 2004 për tregjet e instrumenteve financiare. ⁽⁴⁾.
8. Autorizimi i dhënë për shoqërinë administruese në shtetin e saj anëtar të origjinës duhet të garantojë mbrojtjen e investitorit dhe aftësinë paguese të shoqërive administruese, me synimin për të kontribuar në qëndrueshmërinë e sistemit financiar. Qasja e miratuar në këtë direktivë është garantimi i harmonizimit thelbësor të nevojshëm dhe të mjaftueshëm për të siguruar njohjen reciproke të autorizimit dhe të sistemeve të kujdesshme të mbikëqyrjes, duke mundësuar dhënien e një autorizimi të vetëm të vlefshëm nëpër të gjithë Komunitetin dhe zbatimin e parimit të mbikëqyrjes nga shteti anëtar i origjinës.
9. Për të garantuar se shoqëria administruese do të mund të përmbushë detyrimet që lindin nga veprimtaritë e saj dhe, si rezultat, për të garantuar qëndrueshmërinë e saj, kërkohet që ajo të ketë kapital themeltar dhe fonde vetjake shtesë. Këto kërkesa, duke përfshirë përdorimin e garancive, duhet të rishikohen në mënyrë që të marrin në konsideratë zhvillimet, sidomos sa i përket tarifave të kapitalit për riskun operacional, brenda Komunitetit dhe forumeve të tjera ndërkombëtare.
10. Për mbrojtjen e investitorëve është e nevojshme që të garantohet mbikëqyrja e brendshme e çdo shoqërie administruese, veçanërisht nëpërmjet një sistemi administrimi me dy persona dhe nëpërmjet mekanizmave të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm.
11. Sipas parimit të mbikëqyrjes që ka shteti anëtar i origjinës, shoqëritë administruese të autorizuar në shtetin e tyre anëtar të origjinës duhet të lejohen që të ofrojnë shërbime për të cilat kanë marrë autorizim në të gjithë Komunitetin, nëpërmjet themelimit të degëve ose në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime.
12. Për sa i përket administrimit të portofolit të investimeve kolektive (menaxhimi i fondeve të kujdestarisë/fondeve të përbashkëta ose shoqërive të investimeve), autorizimi që i jepet një shoqërie administruese në shtetin e saj anëtar të origjinës duhet ta lejojë shoqërinë të ndjekë në shtetet anëtare pritëse veprimtaritë e mëposhtme, pa cenuar Kapitullin XI: shpërndarjen, nëpërmjet themelimit të një dege, të kuotave të fondeve të kujdestarisë/fondeve të përbashkëta, të harmonizuara, të administruara nga ajo shoqëri në shtetin e saj anëtar të origjinës; shpërndarjen, nëpërmjet themelimit të një dege, të aksioneve të shoqërive të

investimeve të harmonizuara, të administruara nga ajo shoqëri; shpërndarjen e kuotave të fondeve të kujdestarisë/fondeve të përbashkëta, të harmonizuara, ose të aksioneve të shoqërive të investimeve të harmonizuara, të administruara nga shoqëri të tjera administruese; kryerjen e të gjitha funksioneve dhe detyrave të tjera të përfshira në veprimtarinë e administrimit të portofolit të investimeve kolektive; administrimin e aseteve të shoqërive të investimeve të themeluara në shtete anëtare, përveç shtetit të saj anëtar të origjinës, kryerjen e funksioneve që përfshihen në veprimtarinë e administrimit të portofolit të investimeve kolektive mbi bazën e mandateve, për llogari të shoqërive administruese të themeluara në shtete anëtare, përveç shtetit të saj anëtar të origjinës. Në rastet kur një shoqëri administruese i shpërndan kuotat e fondeve të saj të kujdestarisë/fondeve të përbashkëta, të harmonizuara, ose aksionet e shoqërive të saj të investimeve të harmonizuara në shtetet anëtare pritëse, pa themeluar degë, ajo i nënshtrohet vetëm rregullave për marketimin ndërkufitar.

13. Për sa i përket objektit të veprimtarisë së shoqërive administruese dhe për të marrë në konsideratë legjislacionin e brendshëm dhe për t'i lejuar këto shoqëri që të arrijnë ekonomi të konsiderueshme të shkallës, preferohet që gjithashtu t'u lejohet të ndjekin veprimtarinë e administrimit të portofolave të investimeve për çdo klient (administrimi i portofolave individualë), duke përfshirë administrimin e fondeve të pensioneve si edhe disa veprimtari specifike dytësore që lidhen me biznesin kryesor pa cenuar stabilitetin e këtyre shoqërive. Sidoqoftë, duhet të përcaktohen rregulla specifike me qëllim shmangien e konflikteve të interesit në rastin kur shoqëritë administruese janë autorizuar që të ndjekin biznesin e administrimit si të portofolit kolektiv ashtu edhe të atij individual.
14. Veprimtaria e administrimit të portofolave individualë të investimeve është një shërbim investimi, i mbuluar nga Direktiva 2004/39/KE. Për të garantuar një kuadër rregullator homogjen në këtë fushë, preferohet që shoqëritë administruese, autorizimi i të cilave mbulon edhe atë shërbim, t'u nënshtrohen kushteve të funksionimit të përcaktuara në atë direktivë.
15. Si rregull i përgjithshëm, shteti anëtar i origjinës duhet të jetë në gjendje të vendosë rregulla më strikte se sa ato të përcaktuara në këtë direktivë, sidomos sa i përket kushteve të autorizimit, kërkesave më të kujdesshme dhe rregullave për raportimin dhe prospektin.
16. Preferohet që të hartohen rregulla, ku të përcaktohen kushtet paraprake, sipas të cilave një shoqëri administruese, mund t'u delegojë mbi bazën e mandateve, detyra dhe funksione specifike palëve të treta, me qëllim rritjen e efikasitetit të ushtrimit të veprimtarisë së saj. Për të garantuar funksionimin e rregullt të parimit të mbikëqyrjes, që ka shteti anëtar i origjinës, shtetet anëtare që lejojnë këto delegime duhet të garantojnë se shoqëria administruese, të cilës i kanë dhënë autorizimin, nuk i delegon të gjitha funksionet e saj te një ose më shumë palë të treta, në mënyrë të atillë që të bëhet një shoqëri kuti-poste dhe se ekzistenca e mandateve nuk e rrezikon mbikëqyrjen efikase mbi shoqërinë administruese. Sidoqoftë, fakti që shoqëria administruese i ka deleguar funksionet e saj nuk duhet të ndikojë në përgjegjësitë e asaj shoqërie ose të depozitarit kundrejt mbajtësit e kuotave dhe autoriteteve kompetente.

17. Për të garantuar një terren me kushte të barabarta dhe mbikëqyrje të përshtatshme në terma afatgjatë, Komisioni duhet të jetë në gjendje të shqyrtojë mundësitë për harmonizimin e marrëveshjeve të delegimit në nivel Komuniteti.
18. Parimi i mbikëqyrjes, që ka shteti anëtar i origjinës, kërkon që autoritetet kompetente të tërheqin ose të refuzojnë dhënien e autorizimit në raste të tilla kur faktorë si përmbajtja e programeve të operacioneve, shpërndarja gjeografike apo veprimtaritë e ndjekura në realitet tregojnë qartë që një shoqëri administruese ka preferuar sistemin ligjor të një shteti anëtar për qëllime të shmangies së standardeve më strikte në fuqi në një shtet tjetër anëtar brenda territorit të të cilit ajo synon të ndjekë ose ndjek pjesën më të madhe të veprimtarive të saj. Për qëllime të kësaj direktive, shoqëria administruese duhet të autorizohet në shtetin anëtar në të cilin ka adresën e regjistruar. Në përputhje me parimin e mbikëqyrjes nga shteti anëtar i origjinës, vetëm autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese duhet të konsiderohen kompetente për të mbikëqyrur organizimin e shoqërisë administruese, duke përfshirë të gjitha procedurat dhe burimet për kryerjen e funksionit të administrimit të përmendur në Shtojcën II, të cilat duhet t'i nënshtrohen legjislacionit të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese.
19. Në rastet kur SIKTT administrohet nga një shoqëri administruese e autorizuar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës i SIKTT-së, kjo shoqëri administruese duhet të miratojë dhe të krijojë procedura dhe marrëveshje të përshtatshme për të trajtuar ankesat e investitorëve, si për shembull nëpërmjet dispozitave të përshtatshme në marrëveshjet e shpërndarjes ose nëpërmjet një adrese në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së, e cila jo domosdoshmërisht duhet të jetë adresa e vetë shoqërisë administruese. Kjo shoqëri administruese gjithashtu duhet të krijojë procedura dhe marrëveshje të përshtatshme për ta vendosur informacionin në dispozicion të publikut ose të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, si për shembull nëpërmjet caktimit të një personi kontakti, mes punonjësve të shoqërisë administruese, për të trajtuar kërkesat për informacion. Sidoqoftë, legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së nuk duhet t'i kërkojë kësaj shoqërie administruese të ketë një përfaqësues lokal në atë shtet anëtar, me qëllim përmbushjen e atyre detyrimeve.
20. Autoritetet kompetente që autorizojnë SIKTT-në duhet të marrin në konsideratë rregullat e fondit të përbashkët ose dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimeve, zgjedhjen e depozitarit dhe kompetencën e shoqërisë administruese për të administruar SIKTT-në. Në rastet kur shoqëria administruese është themeluar në një shtet tjetër anëtar, autoritetet kompetente duhet të jenë në gjendje të mbështeten në një vërtetim të lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, lidhur me llojin e SIKTT-së që shoqëria administruese është autorizuar të administrojë. Autorizimi i një SIKTT-je nuk duhet t'i nënshtrohet kërkesës për kapital shtesë në nivelin e shoqërisë administruese, vendndodhjes së adresës së regjistruar të shoqërisë administruese në shtetin anëtar të origjinës së SIKTT-së ose vendndodhjes së çdo veprimtarie të shoqërisë

administruese në shtetin anëtar të origjinës së SIKTT-së.

21. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së duhet të jenë kompetente për të mbikëqyrur pajtueshmërinë me rregullat për përbërjen dhe funksionimin e SIKTT-së, të cilat duhet t'i nënshtrohen legjislacionit të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së. Për këtë arsye, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së duhet të jenë në gjendje ta marrin informacionin direkt nga shoqëria administruese. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese mund t'u kërkojnë shoqërive administruese të japin informacion mbi transaksionet për investimet e SIKTT-së, të autorizuara në atë shtet anëtar, duke përfshirë informacionin që përmbajnë librat dhe regjistrat e atyre transaksioneve dhe llogaritë e fondeve. Për të zgjidhur çdo shkelje të rregullave që janë nën përgjegjësinë e tyre, autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të shoqërisë administruese duhet të jenë në gjendje të mbështetet në bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese dhe, nëse është e nevojshme, duhet të jenë në gjendje të marrin masa direkt kundër shoqërisë administruese.
22. Shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së duhet të ketë mundësinë të parashikojë rregulla për përmbajtjen e regjistrit të mbajtësit të kuotave të SIKTT-së. Sidoqoftë, organizimi i mirëmbajtjes dhe vëndndodhja e këtij regjistri duhet të mbeten pjesë e masave organizative të shoqërisë administruese.
23. Është e nevojshme që shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së, t'i ofrohen të gjitha mjetet për të zgjidhur çdo shkelje të rregullave të SIKTT-së. Për këtë arsye, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së duhet të jenë të afta të ndërmarrin masa parandaluese dhe të miratojnë sanksione për shoqërinë administruese. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së duhet të kenë, si mjet të fundit, mundësinë për t'i kërkuar shoqërisë administruese të pushojë së administruari SIKTT-në. Shtetet anëtare duhet të parashikojnë dispozita të nevojshme për administrimin ose likuidimin e rregullt të SIKTT-së, në këtë rast.
24. Për të shmangur arbitraritetin në mbikëqyrje dhe për të nxitur besimin në efikasitetin e mbikëqyrjes nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës, autorizimi duhet të refuzohet në rastet kur SIKTT-së i ndalohe t'i marketojë kuotat e saj në shtetin e saj anëtar të origjinës. Pasi autorizohet, SIKTT duhet të jetë e lirë që të zgjedhë shtetet anëtare në të cilat do të kuotat e saj, në përputhje me këtë direktivë.
25. Për të mbrojtur interesat e aksionarëve dhe për të siguruar kushte të barabarta në treg për sipërmarrjet e investimeve kolektive të harmonizuara, kërkohet që shoqëritë e investimit të kenë kapital themeltar. Sidoqoftë, shoqëritë e investimit të cilat kanë caktuar një shoqëri administruese mbulohen nga fondet shtesë të vetë shoqërisë administruese.
26. Në rastet kur ka rregulla të zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë dhe delegimin e funksioneve dhe kur një delegim i tillë nga shoqëria administruese lejohet nga legjislacioni i shtetit të saj anëtar të origjinës, shoqëritë e autorizuara të investimeve duhet t'i respektojnë

këto rregulla, *mutatis mutandis*, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt, në rastet kur nuk kanë caktuar një shoqëri administruese të autorizuar në përputhje me këtë direktivë, ose në mënyrë të tërthortë, në rastet kur e kanë caktuar një shoqëri të tillë administruese.

27. Pavarësisht nevojës për konsolidim të SIKTT-ve, bashkimet e SIKTT-ve hasin shumë vështirësi ligjore dhe administrative në Komunitet. Prandaj, për të përmirësuar funksionimin e tregut të brendshëm është e nevojshme që të përcaktohen dispozita të Komunitetit, të cilat lehtësojnë bashkimin e SIKTT-ve (dhe të divizioneve të tyre të investimeve). Pavarësisht se disa shtete anëtare kanë gjasa të autorizojnë vetëm fonde kontraktuale, bashkimet ndërkufitare ndërmjet të gjitha llojeve të SIKTT-ve (kontraktuale, korporata dhe fonde kujdestarie) duhet të lejohen dhe të njihen nga çdo shtet anëtar pa qenë nevoja që shtetet anëtare të parashikojnë forma të reja ligjore të SIKTT-ve në legjislacionin e tyre të brendshëm.
28. Kjo direktivë prek ato teknika bashkimi, të cilat përdoren më gjerësisht në shtetet anëtare. Ajo nuk u kërkon të gjitha shteteve anëtare të integrojnë të tre teknikat në legjislacionin e tyre të brendshëm, por secili shtet anëtar duhet të njohë transferimin e aseteve që rezultojnë nga këto teknika bashkimi. Kjo direktivë nuk i ndalon SIKTT-të të përdorin teknika të tjera mbi baza tërësisht kombëtare, në kushtet ku asnjë prej SIKTT-ve të prekura nga bashkimi nuk është njoftuar për marketimin ndërkufitar të kuotave të saj. Ato bashkime do të mbeten objekt i dispozitave përkatëse të legjislacionit të brendshëm. Rregullat e brendshme për kuorumin nuk duhet të bëjnë dallime ndërmjet bashkimeve kombëtare dhe ndërkufitare, dhe as të jenë më rigorozë se sa ato të përcaktuara për bashkimet e subjekteve korporata.
29. Për të mbrojtur interesat e investitorëve, shtetet anëtare duhet t'u kërkojnë bashkimeve të propozuara SIKTT-ve, ndërkufitare ose vendase, që të jenë objekt i autorizimit nga autoritetet e tyre kompetente. Për sa u përket bashkimeve ndërkufitare, autoritetet kompetente të SIKTT-së bashkuese duhet të autorizojnë bashkimin, me qëllim që të garantohet se interesat e mbajtësve të kuotave, të cilët ndërrojnë plotësisht SIKTT, të jenë ligjërisht të mbrojtura. Nëse bashkimi përfshin më shumë se sa një SIKTT bashkuese dhe këto SIKTT janë të vendosura në shtete të ndryshme anëtare, autoritetet kompetente të secilës SIKTT bashkuese do të duhet të autorizojnë bashkimin, në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, edhe përmes shkëmbimit të informacionit, në mënyrën e duhur. Duke qenë se edhe interesat e mbajtësve të kuotave të SIKTT-së përfituese duhet të mbrohen plotësisht, ato duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së përfituese.
30. Mbajtësit e kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese gjithashtu duhet të jenë të afta të kërkojnë riblerjen ose shlyerjen e kuotave të tyre ose, sipas rastit, shndërrimin e tyre në kuota në SIKTT të tjera me politika të ngjashme investimi dhe të administruara nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një shoqëri e lidhur. Kjo e drejtë nuk duhet të jetë objekt i asnjë tarife tjetër shtesë, përveç komisioneve, që duhen mbajtur ekskluzivisht nga SIKTT-të përkatëse, për të mbuluar kostot e tërheqjes së investimeve në të gjitha situatat, siç përcaktohet në

prospektet e SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese.

31. Duhet të sigurohet gjithashtu edhe kontrolli i bashkimeve nga palë të treta. Depozitarët e secilës prej SIKTT-ve të përfshira në bashkim duhet të verifikojnë pajtueshmërinë e draftit të kushteve të bashkimit me dispozitat përkatëse të kësaj direktive dhe të rregullave të fondit të SIKTT-ve. Qoftë depozitari ose eksperti kontabël i jashtëm duhet të hartojnë një raport për llogari të të gjitha SIKTT-ve të përfshira në bashkim, duke certifikuar metodat e vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve të këtyre SIKTT-ve dhe metodën e përlllogaritjes së normës së këmbimit, të përcaktuar në draftin e kushteve të përbashkëta të bashkimit si edhe normën aktuale të këmbimit, dhe sipas rastit, pagesën në para për kuotë. Për të kufizuar kostot që lidhen me bashkimet ndërkufitare, duhet të jetë e mundur që të hartohet një raport i vetëm për të gjitha SIKTT-të e përfshira dhe ekspertit kontabël të miratuar të SIKTT-së bashkuese ose përfituese duhet t'i krijohet mundësia për ta bërë këtë. Për arsye të mbrojtjes së investitorëve, mbajtësit e kuotave duhet të jenë të aftë të sigurojnë një kopje të këtij raporti me kërkesë dhe pa pagesë.
32. Është veçanërisht e rëndësishme që mbajtësit e kuotave të jenë të informuar plotësisht rreth bashkimit të propozuar dhe të drejtat e tyre mbrohen njaftueshëm. Pavarësisht se interesat e mbajtësit të kuotave të SIKTT-ve bashkuese janë më të rëndësishme për bashkimin, duhet të mbrohen edhe interesat e SIKTT-ve përfituese.
33. Dispozitat për bashkimet e përcaktuara në këtë Direktivë nuk cenojnë zbatimin e legjislacionit për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet sipërmarrjeve, sidomos Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 139/2004 të 20 Janarit 2004 për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet sipërmarrjeve (Rregullorja për bashkimet e KE-së) ⁽⁵⁾.
34. Marketimi i lirë i kuotave të emetuara nga SIKTT-të e autorizuara, që të investojnë deri në 100% të aseteve të tyre në tituj të transferueshëm të emetuar nga i njëjti organ (shteti, autoritet lokal, etj), nuk duhet të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në çrregullimin e funksionimit të tregut të kapitalit ose në financimin e shteteve anëtare.
35. Përkufizimi i titujve të transferueshëm i përfshirë në këtë direktivë zbatohet vetëm për qëllime të kësaj direktive dhe nuk ka ndikim në përkufizimet e ndryshme të përdorura në legjislacionin e brendshëm për qëllime të tjera, si p.sh. tatimi. Si rrjedhojë, aksionet dhe titujt e tjerë të barasvlershëm me aksionet e emetuara nga organe të tilla si shoqëri ndërtimi dhe shoqëri industriale dhe kursimi, pronësia e të cilave në praktikë nuk mund të transferohet me përjashtim të organit emetues që i riblen ato, nuk mbulohen nga kjo direktivë.
36. Instrumentet e tregut të parasë përbëhen nga instrumente të transferueshme të cilat blihen dhe shiten në tregun e parasë dhe jo në tregjet e rregulluara, për shembull obligacione thesari dhe obligacione të autoriteteve lokale, certifikata depozitash, letra tregtare, nota afatmesme dhe garancitë bankare.
37. Koncepti i tregut të rregulluar në këtë direktivë i korrespondon atij në Direktivën 2004/39/KE.

38. Preferohet që një SIKTT të lejohet t'i investojë asetet e saj në kuota të SIKTT-së dhe të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur që gjithashtu investojnë në asete financiare likuide të përmendura në këtë direktivë dhe që funksionojnë mbi parimin e shpërndarjes së riskut. Është e nevojshme që SIKTT-të ose sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive në të cilat investon një SIKTT t'u nënshtrohen mbikëqyrjes efikase.
39. Duhet të lehtësohen mundësitë që një SIKTT të investojë në SIKTT dhe në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive. Prandaj është thelbësore që të garantohet se kjo veprimtari investimi nuk zvogëlon mbrojtjen e investitorit. Për shkak të mundësive të rritura për SIKTT-të që të investojnë në kuotat e SIKTT-ve të tjera dhe të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, është e nevojshme që të përcaktohen disa rregulla për kufijtë sasiore, nxjerrjen e informacionit dhe parandalimin e fenomenit kaskadë.
40. Për të marrë në konsideratë zhvillimet e tregut dhe duke pasur parasysh përmbushjen e bashkimit ekonomik dhe monetar preferohet që SIKTT-të të lejohen të investojnë në depozita bankare. Për të garantuar likuiditet të mjaftueshëm të investimeve në depozita, këto depozita duhet të jenë me opsionin e shlyerjes me kërkesë ose me të drejtë tërheqjeje. Nëse depozitat janë hapur në një institucion kreditimi adresa e regjistruar e të cilit ndodhet në një shtet të tretë, institucioni kreditor duhet të jetë objekt i rregullave të mirëmbenduar të barasvlershme me ato të përcaktuara në legjislacionin e komunitetit.
41. Përveçse rastit në të cilin një SIKTT investon në depozita bankare në përputhje me rregullat e fondit të saj ose dokumentet e themelimit, duhet të mundësohet që të lejohen të gjitha SIKTT-të që të mbajnë asete likuide për qëllime dytësore, si depozita bankare pa afat. Ndër të tjera, mbajtja e këtyre aseteve likuide për qëllime dytësore mund të justifikohet për të mbuluar pagesat aktuale ose të jashtëzakonshme; në rastin e shitjeve, për kohën që nevojitet për të riinvestuar në tituj të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë ose në asete të tjera financiare të parashikuara në këtë direktivë; ose për periudhën kohore shumë të nevojshme në rastet kur, për shkak të kushteve të pafavorshme të tregut, pezullohet investimi në tituj të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë dhe në asete të tjera financiare.
42. Për arsye të mirëmbenduar është e nevojshme që të shmanget përqendrimi i tepërt nga një SIKTT në investime që e ekspozojnë atë ndaj riskut të palës tjetër të të njëjtit subjekt ose subjekteve që i përkasin të njëjtit grup.
43. SIKTT-të duhet të lejohen shprehimisht që të investojnë në instrumente financiare derivative, si pjesë e politikës së tyre të përgjithshme të investimeve ose për qëllime mbrojtjeje, për të arritur objektivin financiar të vendosur ose profilin e riskut të cilësuar në prospekt. Për të garantuar mbrojtjen e investitorit, është e nevojshme që të kufizohet ekspozimi maksimal i mundshëm lidhur me instrumentet derivative, me qëllim që mos ta kalojë vlerën e përgjithshme neto të portofolit të SIKTT-së. Për të garantuar ndërgjegjësimin konstant mbi risqet dhe angazhimet që rrjedhin nga transaksionet derivative dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë me kufijtë e investimeve, këto risqe dhe angazhime duhet të maten dhe të

monitorohen rregullisht. Si përfundim, për të garantuar mbrojtjen e investitorit përmes zbulimit të informacionit, SIKTT-të duhet të përshkruajnë strategjitë, teknikat dhe kufijtë e tyre të investimeve, të cilat rregullojnë operacionet e tyre derivative.

44. Është e nevojshme që masat që do të trajtojnë mungesën e mundshme të rakordimit të interesave në produkte, ku risku i kredisë transferohet nëpërmjet procesit të krijimit të titujve, siç parashikohet në Direktivën 2006/48/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 14 Qershorit 2006 për nisjen dhe ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të kreditit ⁽⁶⁾ dhe Direktivën 2006/49/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 14 Qershorit 2006 për mjaftueshmërinë e kapitalit të firmave të investimit dhe institucioneve të kreditit ⁽⁷⁾, të jenë konsistente dhe koherente në të gjitha rregulloret përkatëse të sektorit financiar. Komisioni do të parashtojë propozimet e duhura legjislative, duke përfshirë edhe ato lidhur me këtë direktivë, për të garantuar një konsistencë dhe koherencë të tillë, pasi të jetë marrë në konsideratë ndikimi i këtyre propozimeve.
45. Për sa i përket derivativëve të tregtuar mbi banak, duhet të vendosen kërkesat lidhur me të drejtën e palëve të tjera dhe instrumenteve, likuiditetin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të pozicionit. Qëllimi i këtyre kërkesave është garantimi i mbrojtjes së investitorit në një nivel të mjaftueshëm dhe të afërt me atë që marrin në rastet kur blejnë derivativë që tregtohen në tregje të rregulluara.
46. Veprimet me derivativë nuk duhet të përdoren kurrë për të shmangur parimet ose rregullat e përcaktuara në këtë direktivë. Për sa u përket derivativëve të tregtuar mbi banak, duhet të zbatohen rregulla shtesë për shpërndarjen e riskut, për ekspozimet ndaj një pale të vetme ose një grupi palësh.
47. Disa teknika të menaxhimit të portofolit për sipërmarrjet e investimeve kolektive që investojnë kryesisht në aksione ose në instrumente borxhi, mbështeten në replikimin e një indeksi aksionesh ose instrumentesh borxhi. Preferohet që SIKTT-të të lejohen të replikojnë indekse aksionesh ose instrumentesh borxhi të njohura dhe të pranuar. Prandaj, mund të jetë e nevojshme të vendosen rregulla të reja më tepër fleksibël, për përhapjen e rrezikut për SIKTT-të që investojnë në aksione ose instrumente borxhi, për këtë qëllim.
48. Sipërmarrjet e investimeve kolektive që përfshihen brenda fushës së veprimit të kësaj direktive nuk duhet të përdoren për qëllime të ndryshme nga investimi kolektiv i kapitalit të mbledhur nga oferta publike, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë direktivë. Në rastet e identifikuar nga kjo direktivë, një SIKTT duhet të ketë mundësinë që të ketë filiale vetëm kur është e nevojshme për të ndjekur plotësisht, për llogari të vet, disa veprimtari të caktuara, të përcaktuara gjithashtu në këtë direktivë. Është e nevojshme që të garantohet një mbikëqyrje efikase e SIKTT-ve. Si rrjedhojë, themelimi i filialit të një SIKTT-je në një shtet të tretë duhet të lejohet vetëm në rastet e identifikuar në këtë direktivë dhe në përputhje me kushtet e saj. Detyrimi i përgjithshëm për të vepruar vetëm në interes të mbajtësit të kuotave dhe, në veçanti, objektivi për të rritur efikasitetin në kosto, nuk e justifikojnë kurrë marrjen e masave nga SIKTT-ja, të cilat mund t'i pengojnë autoritetet kompetente të ushtrojnë

plotësisht funksionet e tyre mbikëqyrëse.

49. Versioni origjinal i Direktivës 85/611/KEE përmbante një derogim nga kufizimi në përqindjen e asetëve që një SIKTT mund të investojë në tituj të transferueshëm të emetuar nga i njëjti organ, i cili zbatohet në rastin e bonove të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar. Ky derogim i lejonte SIKTT-të të investonin specifikisht deri në 35% të asetëve të tyre në këto bono. Një tjetër derogim i ngjashëm por më i kufizuar justifikohet në lidhje me bonot e sektorit privat, të cilat, edhe në mungesë të garancisë nga shteti, i japin investitorit garanci të veçanta sipas rregullave specifike që zbatohen për to. Prandaj, është e nevojshme që derogimi të shtrihet në të gjitha bonot e sektorit privat, të cilat përmbushin kriteret e vendosura bashkërisht, ndërkohë që u takon shteteve anëtare të hartojnë një listë të bonove, për të cilat ato synojnë të lejojnë derogimin, sipas rastit.
50. Disa shtete anëtare kanë miratuar dispozita të cilat u mundësojnë sipërmarrjeve të investimeve kolektive jo të koordinuara që t'i grupojnë asetet e tyre në një të ashtuquajtur fond kryesor. Për t'i lejuar SIKTT-të që të përdorin këto struktura, është e nevojshme që SIKTT-të furnizuese të cilat dëshirojnë t'i grupojnë asetet e tyre në një SIKTT kryesore, të përjashtohen nga ndalimi për të investuar më shumë se sa 10% të asetëve të tyre ose, sipas rastit, 20% të asetëve të tyre në një sipërmarrje të vetme investimesh kolektive. Ky përjashtim është i justifikuar për shkak se SIKTT-ja furnizuese i investon të gjitha ose pothuajse të gjitha asetet e saj në portofolin e diversifikuar të SIKTT-së kryesore, që në vetvete është objekt i rregullave të diversifikimit të SIKTT-së.
51. Për të lehtësuar funksionimin efikas të tregut të brendshëm dhe për garantuar të njëjtin nivel mbrojtjeje të investitorëve në të gjithë Komunitetin, strukturat kryesore-furnizuese duhet të lejohen si në rastin kur strukturat kryesore dhe furnizuese ndodhen në të njëjtin shtet anëtar, ashtu edhe në rastin kur ndodhen në shtete të ndryshme anëtare. Për t'i lejuar investitorët që të kuptojnë më mirë strukturat kryesore-furnizuese dhe rregullatorët që t'i mbikëqyrin ato më lehtësisht, kryesisht në kushte ndërkufitare, asnjë SIKTT furnizuese nuk mund të investojë në më shumë se një strukturë kryesore. Për të garantuar të njëjtin nivel mbrojtjeje të investitorëve në të gjithë Komunitetin, struktura kryesore duhet të jetë vetë një SIKTT e autorizuar. Për të shmangur një barrë të padrejtë administrative, dispozitat për njoftimin e marketimit ndërkufitar nuk duhet të zbatohen nëse një SIKTT kryesore nuk mbledh kapital nga oferta publike në një shtet anëtar të ndryshëm nga ai në të cilin është themeluar, por ka vetëm një ose më shumë SIKTT furnizuese në atë shtet.
52. Për të mbrojtur investitorët e SIKTT-së furnizuese, investimi i SIKTT-së furnizuese në SIKTT-në kryesore duhet t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së furnizuese. Miratimi kërkohet vetëm për investimin fillestar në SIKTT-në kryesore, nëpërmjet të cilit SIKTT-ja furnizuese e tejkalon kufirin e zbatueshëm për të investuar në një SIKTT tjetër. Për të lehtësuar funksionimin efikas të tregut të brendshëm dhe për të garantuar të njëjtin nivel mbrojtjeje të investitorëve në të gjithë Komunitetin, kushtet të cilat duhet të plotësohen si dhe dokumentet dhe informacioni

që duhet të paraqiten për të miratuar investimin e SIKTT-së furnizuese në SIKTT-në kryesore, duhet të jenë shteruese.

53. Për ta lejuar SIKTT-në furnizuese që të veprojë në interesin më të mirë të mbajtësve të kuotave të saj dhe, veçanërisht, për t'i lejuar asaj të marrë nga SIKTT-ja kryesore të gjithë informacionin dhe dokumentet e nevojshme për të përmbushur të gjitha detyrimet e saj, SIKTT-ja furnizuese dhe ajo kryesore duhet të lidhin një marrëveshje detyruese. Sidoqoftë, nëse SIKTT-ja furnizuese dhe ajo kryesore administrohen nga e njëjta shoqëri administrative, mjafton që kjo e fundit të vendosë rregulla të brendshme për ushtrimin e veprimtarisë. Marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve dhe ekspertëve kontabël, të SIKTT-së furnizuese dhe SIKTT-së kryesore përkatësisht, duhet të garantojnë qarkullimin e informacionit dhe të dokumenteve që u nevojiten depozitarit ose ekspertëve kontabël të SIKTT-së furnizuese për të përmbushur detyrat e tyre. Në rast të përmbushjes së këtyre kërkesave, kjo direktivë duhet të garantojë që depozitarët ose ekspertët kontabël të mos gjenden në shkelje të ndonjë kufizimi për nxjerrjen e informacionit ose për mbrojtjen e të dhënave.
54. Për të garantuar një nivel të lartë mbrojtjeje të interesave të investitorëve të SIKTT-së furnizuese, prospekti, informacioni kryesor për investitorët si edhe i gjithë komunikimi i marketimit duhet të përshtatet sipas specifikimeve të strukturave kryesore-furnizuese. Investimi i SIKTT-së furnizuese në SIKTT-në kryesore nuk duhet cenojë aftësinë e vetë SIKTT-së furnizuese për të riblerë ose shlyer kuotat, me kërkesë të mbajtësit të kuotave të saj, apo për të vepruar në interesin më të mirë të mbajtësit të kuotave të saj.
55. Sipas kësaj direktive, mbajtësit e kuotave duhet të mbrohen nga tarifimi i kostove shtesë të pajustificuara, me anë të ndalimit që i bëhet SIKTT-së kryesore për të vendosur tarifa nënshkrimi dhe shlyerjeje. Por SIKTT-ja kryesore gjithsesi duhet të ketë mundësinë t'u vendosë tarifa nënshkrimi ose shlyerjeje investitorëve të tjerë në SIKTT-në kryesore.
56. Rregullat e shndërrimit duhet t'i mundësojnë një SIKTT-je ekzistuese që të shndërrohet në një SIKTT furnizuese. Në të njëjtën kohë ato duhet të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme për mbajtësit e kuotave. Duke qenë se shndërrimi është një ndryshim thelbësor i politikës së investimeve, SIKTT-ja që do të shndërrohet duhet t'u japë informacion të mjaftueshëm mbajtësve të kuotave të saj, me qëllim që ato të mund vendosin nëse duan ta mbajnë apo jo investimin e tyre. Autoritetet kompetente nuk duhet t'i kërkojnë SIKTT-së furnizuese që të japë më tepër informacion ose informacion të ndryshëm nga ai i specifikuar në këtë direktivë.
57. Në rastet kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së kryesore informohen për një parregullsi lidhur me SIKTT-në kryesore ose zbulojnë se SIKTT-ja kryesore nuk i respekton dispozitat e kësaj direktive, ato, sipas rastit, mund të vendosin të ndërmarrin masa përkatëse për t'u siguruar që mbajtësit e kuotave të SIKTT-së kryesore të informohen siç duhet.

58. Shtetet anëtare duhet të bëjnë dallimin e qartë ndërmjet komunikimeve të marketimit dhe nxjerrjes së detyrueshme të informacionit për investitorin, të parashikuar në këtë direktivë. Nxjerrja e detyrueshme e informacionit për investitorin, përfshin informacione kryesore për investitorët, prospektin dhe raportet vjetore dhe gjashtëmujore.
59. Informacionet kryesore për investitorët duhet t'u japin investitorëve falas, në formën e një dokument specifik, dhe brenda një kohe të mjaftueshme përpara nënshkrimit të SIKTT-së, për t'i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara mbi investimet. Këto informacione kryesore për investitorët duhet të përmbajnë vetëm elemente thelbësore për marrjen e këtyre vendimeve. Natyra e informacionit që duhet të gjendet në informacionet kryesore për investitorët duhet të jetë plotësisht i harmonizuar, me qëllim që të garantojë krahasueshmëri dhe mbrojtje të përshtatshme për investitorin. Informacionet kryesore për investitorët duhet të paraqiten në një format të shkurtër. Mënyra më e përshtatshme për të arritur qartësinë dhe thjeshtësinë e paraqitjes së informacionit, që kërkohet nga investitorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë, është një dokument i vetëm me gjatësi të kufizuar që e paraqet informacionin në sekuenca të specifikuar dhe që lejon krahasime të dobishme, kryesisht të kostove dhe profilit të riskut, të cilat kanë rëndësi për vendimin mbi investimin.
60. Autoritetet kompetente të secilit shtet anëtar mund të vënë në dispozicion të publikut, në një seksion të posaçëm të faqes së tyre të internetit, informacionet kryesore për investitorët, për të gjitha SIKTT-të e autorizuara në atë shtet anëtar.
61. Informacionet kryesore për investitorët duhet të përgatiten për të gjitha SIKTT-të. Shoqëritë administruese ose, sipas rastit, shoqëritë e investimit duhet t'u ofrojnë subjekteve përkatëse informacione kryesore për investitorët, në përputhje me metodën e shpërndarjes që përdoret (shitje direkte ose shitje me ndërmjetësim). Ndërmjetësuesit duhet t'u japin klientëve ekzistues dhe klientëve të mundshëm informacione kryesore për investitorët.
62. SIKTT-të duhet të kenë mundësinë të marketojnë kuotat e tyre në shtete të tjera nëtare nëpërmjet një procedure njoftimi, mbështetur në komunikimin e përmirësuar ndërmjet autoriteteve kompetente të shteteve anëtare. Pasi është përcjellë dosja e plotë e njoftimit nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së, SIKTT-ja e shtetit anëtar pritës nuk e ka më të mundur të kundërshtojë aksesin në tregun e saj të SIKTT-ve të themeluara në një tjetër shtet anëtar ose të kundërshtojë autorizimin e dhënë nga ai shtet tjetër anëtar.
63. SIKTT-të duhet të kenë mundësinë të marketojnë kuotat e tyre me kusht që të ndërmarrin masat e nevojshme për të garantuar disponueshmërinë e lehtësirave për kryerjen e pagesave ndaj mbajtësve të kuotave, për riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe vënien në dispozicion të informacionit që SIKTT-ve u kërkohet të japin.
64. Për të lehtësuar marketimin ndërkufitar të kuotave të SIKTT-së, kontrolli i pajtueshmërisë së marrëveshjeve të bëra për marketimin e kuotave të SIKTT-së, me ligjet, rregulloret dhe

procedurat administrative në fuqi në shtetin anëtar pritës të SIKTT-së, duhet të kryhet pasi SIKTT-ja të ketë hyrë në tregun e atij shteti anëtar. Ky kontroll mund të mbulojë përshtatshmërinë e marrëveshjeve të bëra për marketimin, veçanërisht përshtatshmërinë e marrëveshjeve të shpërndarjes dhe detyrimin që komunikimet e marketimit të paraqiten në një mënyrë që është e drejtë, e qartë dhe jo çorientuese. Kjo direktivë nuk duhet t'i pengojë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës që të verifikojnë nëse komunikimet e marketimit, të cilat nuk përfshijnë informacionet kryesore për investitorët, prospektin dhe raportet vjetore dhe gjashtëmujore, janë në përputhje me legjislacionin e brendshëm, përpara përdorimit të tyre nga SIKTT-ja, me kusht që ky kontroll të mos jetë diskriminues dhe të mos e pengojë SIKTT-në të hyjë në treg.

65. Për qëllime të rritjes së sigurisë ligjore është e nevojshme që të garantohet se SIKTT-ja që i marketon kuotat e saj jashtë kufijve, të mund të aksesojë lehtësisht informacionin, në formën e publikimit elektronik dhe në gjuhën që përdoret gjerësisht në sferën e financave ndërkombëtare, për të plotësuar informacionin mbi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të zbatueshme në shtetin anëtar pritës të SIKTT-së, specifikisht lidhur me marrëveshjet e bëra për marketimin e kuotave të SIKTT-ve. Përgjegjësitë që lidhen me këto publikime duhet të jenë objekt i legjislacionit të brendshëm.
66. Për të lehtësuar aksesin e SIKTT-së në tregjet e shteteve të tjera anëtare, SIKTT-së do t'i duhet të përkthejë vetëm informacionet kryesore për investitorët në gjuhën zyrtare ose në njërën prej gjuhëve zyrtare të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së ose në gjuhën e miratuar nga autoritetet e tij kompetente. Në informacionet kryesore për investitorin duhet të specifikohet gjuha ose gjuhët në të cilat janë të disponueshme dokumente të tjera të detyrueshme për dhënien e informacioneve shpjeguese dhe informacione shtesë. Përkthimet duhet të bëhen nën përgjegjësinë e SIKTT-së, e cila duhet të vendosë nëse nevojitet një përkthim i thjeshtë ose zyrtar.
67. Për të lehtësuar aksesin në tregjet e shteteve të tjera anëtare është e rëndësishme që të bëhen të ditura tarifat e njoftimit.
68. Shtetet anëtare duhet të marrin masat e nevojshme administrative dhe organizative për të mundësuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve vendase dhe autoriteteve kompetente të shteteve të tjera anëtare, duke përfshirë përmes marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe ndërmjet këtyre autoriteteve, të cilat mund të parashikojnë delegimin vullnetar të detyrave.
69. Është e nevojshme që të rritet konvergjenca e kompetencave në dispozicion të autoriteteve kompetente, me qëllim që të ketë një zbatim të barabartë të kësaj direktive në të gjitha shtetet anëtare. Efikasiteti i mbikëqyrjes duhet të garantohet nga një grup i përbashkët minimal kompetencash, në përputhje me ato që u janë dhënë autoriteteve kompetente nga legjislacione të tjera të Komunitetit për shërbimet financiare. Për më tepër, shtetet anëtare duhet të përcaktojnë rregullat për sanksionet, të cilat mund të përfshijnë sanksione penale ose administrative, si dhe masat administrative, që do të zbatohen në rast shkeljeje të kësaj

direktive. Shtetet anëtare gjithashtu duhet të marrin masat e nevojshme për të garantuar vënien në zbatim të këtyre sanksioneve.

70. Është e nevojshme që të përforcohen dispozitat mbi shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente kombëtare, si dhe të përmirësohen detyrat për dhënien e asistencës dhe bashkëpunimin ndërmjet tyre.
71. Për qëllime të ofrimit të shërbimeve ndërkufitare, autoriteteve kompetente përkatëse duhet t'u caktohen kompetenca të qarta me qëllim eliminimin e çdo hendeku ose mbivendosjeje, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.
72. Dispozitat për ushtrimin efikas të funksioneve mbikëqyrëse të autoriteteve kompetente, të parashikuara në këtë direktivë, mbulojnë mbikëqyrjen e konsoliduar që duhet t'i bëhet një SIKTT-je ose një sipërmarrjeje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare, në rastet kur kjo parashikohet nga dispozitat e legjislacionit të komunitetit. Në këto raste, autoritetet në të cilat aplikohet për autorizim duhet të jenë të afta të identifikojnë autoritetet kompetente që duhet të bëjnë mbikëqyrjen e konsoliduar të asaj SIKTT-je ose të një sipërmarrjeje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare.
73. Parimi i mbikëqyrjes nga shteti anëtar i origjinës kërkon që autoritetet kompetente të tërheqin ose të refuzojnë dhënien e autorizimit në raste të tilla kur faktorë si, përmbajtja e programeve të operacioneve, shpërndarja gjeografike apo veprimtaritë e ndjekura në realitet, tregojnë qartë që një SIKTT ose sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare ka preferuar sistemin ligjor të një shteti anëtar me qëllim shmangien e standardeve më strikte që janë në fuqi në një tjetër shtet anëtar, brenda territorit të të cilit ajo synon të ndjekë ose ndjek pjesën më të madhe të veprimtarive të saj.
74. Sjellje të tilla si, mashtrimi ose shkeljet nga persona të brendshëm, kanë gjasa të ndikojnë në stabilitetin, si dhe në integritetin e sistemit financiar, edhe në rastet kur bëhet fjalë për sipërmarrje të ndryshme nga SIKTT-ja ose nga sipërmarrjet që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare.
75. Është me vend të parashikohet mundësia e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve të cilat, në bazë të funksionit të tyre, ndihmojnë në forcimin e stabilitetit të sistemit financiar. Sidoqoftë, për të ruajtur natyrën konfidenciale të informacioneve të përcjella, marrësit e këtyre informacioneve duhet të mbeten brenda kufijve striktë.
76. Është e nevojshme që të specifikohen kushtet sipas së cilave autorizohen këto shkëmbime informacioni.
77. Në rastet kur përcaktohet se informacioni mund të bëhet i ditur vetëm me marrëveshje të shprehur të autoriteteve kompetente, këto të fundit, sipas rastit, mund ta bëjnë marrëveshjen e tyre objekt të pajtueshmërisë me kushtet strikte.

78. Duhet të autorizohen shkëmbimet e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente në njërin krah dhe bankave qendrore, organeve me funksione të ngjashme me bankat qendrore, në cilësinë e tyre si autoritete monetare ose, sipas rastit, autoriteteve të tjera publike përgjegjëse për mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave në krahun tjetër.
79. Kjo direktivë duhet të përmbajë të njëjtin detyrim për ruajtjen e sekretit profesional nga autoritetet përgjegjëse për autorizimin dhe mbikëqyrjen e SIKTT-ve dhe nga sipërmarrjet që kontribuojnë në këtë autorizim dhe mbikëqyrje dhe të njëjtat mundësi për shkëmbim informacioni me ato që u janë dhënë autoriteteve përgjegjëse për autorizimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të kreditimit, firmave të investimit dhe sipërmarrjeve të sigurimit.
80. Për qëllime të forcimit të mbikëqyrjes së kujdesshme të SIKTT-ve ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare dhe mbrojtjen e klientëve të SIKTT-ve ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare, ekspertët kontabël duhet të kenë si detyrë t'i raportojnë menjëherë autoriteteve kompetente në çdo rast, kur, siç parashikohet në këtë direktivë, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, ata vihen në dijeni të fakteve të cilat kanë gjasa të kenë efekte negative në gjendjen financiare ose organizimin administrativ dhe kontabël të një SIKTT-je ose të një sipërmarrjeje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare.
81. Duke pasur parasysh qëllimin në këtë direktivë, preferohet që shtetet anëtare të parashikojnë që kjo detyrë duhet të zbatohet në të gjitha rrethanat në të cilat zbulohen fakte të tilla nga një ekspert kontabël gjatë kryerjes së detyrave të tij në një sipërmarrje, e cila ka lidhje të ngushta me një SIKTT ose një sipërmarrje e cila kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare.
82. Detyra e ekspertëve kontabël për t'u komunikuar autoriteteve kompetente, kur është rasti, fakte të caktuara dhe vendime lidhur me një SIKTT ose një sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare, të cilat ata i zbulojnë gjatë kryerjes së detyrave të tyre në një subjekt që nuk është as SIKTT dhe as sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë tregtare të një SIKTT-je, nuk ndryshon në vetvete natyrën e detyrave të tyre në atë subjekt dhe as mënyrën në të cilën ata duhet të kryejnë këto detyra.
83. Direktiva nuk duhet të ndikojë në rregullat e brendshme për tatimin, duke përfshirë masat që mund të vendosen nga shtete anëtare për të garantuar pajtueshmërinë me këto rregulla në territorin e tyre.
84. Masat e nevojshme për zbatimin e kësaj direktive duhet të miratohen në përputhje me Vendimin 1999/468/KE të Këshillit të 28 Qershorit 1999, që parashtron procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i delegohen Komisionit ⁽⁸⁾.
85. Në veçanti, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat e mëposhtme zbatuese. Sa i përket shoqërive administruese, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masa që specifikojnë detajet e kërkesave organizative, administrimit të riskut,

konfliktit të interesit dhe rregullave të sjelljes. Sa i përket depozitarëve, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat që specifikojnë masat të cilat duhen ndërmarrë nga depozitarët me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre lidhur me SIKTT-në e administruar nga një shoqëri administrimi, e themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së dhe detajet e marrëveshjes ndërmjet depozitarit dhe shoqërisë administruese. Këto masa zbatuese duhet të lehtësojnë zbatimin uniform të detyrimeve të shoqërive administruese dhe depozitarëve, por nuk duhet të jenë një kusht paraprak për zbatimin e së drejtës së shoqërive administruese për të ndjekur veprimtaritë për të cilat janë autorizuar në shtetin e tyre anëtar të origjinës nëpër të gjithë Komunitetin, nëpërmjet themelimit të degëve ose në kuadrin e lirisë për të ofruar shërbime duke përfshirë administrimin e SIKTT-së në një tjetër shtet anëtar.

86. Sa i përket bashkimeve, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat e hartuara për të specifikuar në detaje përmbajtjen, formatin dhe mënyrën se si do t'u jepet informacioni mbajtësve të kuotave.
87. Për sa i përket strukturave kryesore-furnizuese, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat e hartuara për të specifikuar përmbajtjen e marrëveshjes ndërmjet SIKTT-ve kryesore dhe furnizuese ose të rregullave të brendshme të ushtrimit të veprimtarisë së biznesit, përmbajtjen e marrëveshjes për shkëmbimin e informacionit ndërmjet depozitarëve ose ekspertëve kontabël të tyre, përcaktimin e masave të përshtatshme për koordinimin e sinkronizimit të përlllogaritjes së vlerës së tyre neto dhe të publikimit, me qëllim shmangien e parashikimit të ecurisë së tregut, ndikimin e bashkimit të strukturës kryesore mbi autorizimin e furnizuesit, llojin e parregullsisë që lindin nga struktura kryesore të cilat duhet t'i raportohen furnizuesit, formatin dhe mënyrën e ofrimit të informacionit për mbajtësit e kuotave në rast shndërrimi nga një SIKTT në një SIKTT furnizuese, procedurën për vlerësimin dhe auditimin e transferimit të asetëve nga një strukturë furnizuese në strukturën kryesore dhe rolin e depozitarit të furnizuesit në këtë proces.
88. Sa i përket dispozitave për nxjerrjen e informacionit, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat e hartuara për të specifikuar kushtet specifike që duhen përmbushur në rastet kur prospekti ofrohet në një medium të qëndrueshëm e jo në kopje fizike, ose nëpërmjet faqes së internetit, e cila nuk është një medium i qëndrueshëm, përmbajtjen e detajuar dhe shteruese, formën dhe paraqitjen e informacioneve kryesore për investitorët duke marrë në konsideratë natyrën e ndryshme ose komponentët e SIKTT-ve të përfshira dhe kushtet specifike për dhënien e informacioneve kryesore për investitorët në një medium të qëndrueshëm e jo në kopje fizike, ose nëpërmjet një faqeje interneti e cila nuk është një medium i qëndrueshëm.
89. Sa i përket njoftimit, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të miratuar masat e hartuara për të specifikuar qëllimin e informacionit mbi rregullat e zbatueshme vendase, që duhet të publikohen nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse dhe detajet teknike për aksesin e autoriteteve kompetente të shteteve anëtare pritëse në dokumentet e arkivuara dhe

të përditësuara të SIKTT-së.

90. Ndër të tjera, Komisioni duhet të marrë kompetencat për të qartësuar përkufizimet dhe për të bashkërenduar terminologjinë e strukturuar përkufizimet në përputhje me aktet vijuese për SIKTT-të dhe çështjet që lidhen me to.
- 91) Duke qenë se masat e përmendura në deklamimet 85 deri në 90 kanë fushë të përgjithshme zbatimi dhe janë hartuar për të ndryshuar elementet jothelbësore të kësaj direktive, duke e plotësuar atë me elemente jothelbësore të reja, ato duhet të miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të imtësishëm të parashikuar në nenin 5, germa (a) të Vendimit 1999/468/KE.
92. Meqenëse objektivat e kësaj direktive nuk mund të arrihen plotësisht nga shtetet anëtare, për aq kohë sa ato përfshijnë miratimin e rregullave me veçori të përbashkëta të zbatueshme në nivel Komuniteti dhe si rezultat, për shkak të shkallës dhe efekteve të këtyre masave, mund të arrihen më mirë në nivel Komuniteti, ky i fundit mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtyre objektiveve.
93. Detyrimi për transpozimin e kësaj direktive në legjislacionin e brendshëm, duhet të kufizohet në ato dispozita që paraqesin ndryshime thelbësore krahasuar me direktivat që ajo riformulon. Detyrimi për transpozimin e dispozitave të pandryshuara, lind nga direktivat e mëparshme.
94. Kjo direktivë nuk duhet të cenojë detyrimet e shteteve anëtare për afatin kohor për transpozim në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin e direktivave të përcaktuara në Shtojcën III, pjesa B.
95. Në përputhje me paragrafin 34 të marrëveshjes ndërinstucionale për hartim më të mirë të legjislacionit ⁽⁹⁾, shtetet anëtare nxiten që të hartojnë, për veten e tyre dhe në interes të Komunitetit, tabelat që ilustrojnë, për sa është e mundur, përputhshmërinë ndërmjet kësaj direktive dhe masave për transpozim dhe t'i bëjnë ato publike,

MIRATOJNË KËTË DIREKTIVË:

PËRMBAJTJA

KAPITULLI I	OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME
KAPITULLI II	AUTORIZIMI I SIKTT-VE
KAPITULLI III	DETYRIMET E SHOQËRIVE ADMINISTRUESE
SEKSIONI 1	Kushtet për nisjen e veprimtarisë tregtare
SEKSIONI 2	Marrëdhëniet me vendet e treta

SEKSIONI 3	Kushtet e funksionimit
SEKSIONI 4	Liria e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve
KAPITULLI IV	DETYRIMET PËR DEPOZITARIN
KAPITULLI V	DETYRIMET E SHOQËRIVE TË INVESTIMIT
SEKSIONI 1	Kushtet për nisjen e veprimtarisë tregtare
SEKSIONI 2	Kushtet e funksionimit
SEKSIONI 3	Detyrimet për depozitarin
KAPITULLI VI	BASHKIMI I SIKTT-ve
SEKSIONI 1	Parimi, autorizimi dhe miratimi
SEKSIONI 2	Kontrolli nga palë të treta, informacioni i mbajtësve të kuotave dhe të drejta të tjera të mbajtësve të kuotave
SEKSIONI 3	Kostot dhe hyrja në fuqi
KAPITULLI VII	DETYRIMET PËR POLITIKAT E INVESTIMIT TË SIKTT-VE
KAPITULLI VIII	STRUKTURAT KRYESORE-FURNIZUESE
SEKSIONI 1	Fusha e zbatimit dhe miratimi
SEKSIONI 2	Dispozita të përbashkëta për SIKTT-të furnizuese dhe ato kryesore
SEKSIONI 3	Depozitarët dhe ekspertët kontabël
SEKSIONI 4	Informacioni i detyrueshëm dhe komunikimet e marketimit nga SIKTT-ja furnizuese
SEKSIONI 5	Shndërrimi i SIKTT-ve ekzistuese në SIKTT furnizuese dhe ndryshimi i SIKTT-ve kryesore
SEKSIONI 6	Detyrimet dhe autoritetet kompetente
KAPITULLI IX	DETYRIMET LIDHUR ME INFORMACIONIN QË DUHET T'U JEPET INVESTITORËVE
SEKSIONI 1	Publikimi i prospektit dhe i raporteve periodike
SEKSIONI 2	Publikimi i informacioneve të tjera
SEKSIONI 3	Informacioni kryesor për investitorët
KAPITULLI X	DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË SIKTT-VE
KAPITULLI XI	DISPOZITA TË VEÇANTA TË ZBATUESHME PËR SIKTT-TË QË MARKETOJNË KUOTAT E TYRE NË SHTETE ANËTARE, PËRVEÇ SHTETIT KU JANË THEMELUAR
KAPITULLI XII	DISPOZITA PËR AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR AUTORIZIMIN DHE MBIKËQYRJEN
KAPITULLI XIII	KOMITETI EVROPIAN I LETRAVE ME VLERË
KAPITULLI XIV	DEROGIMET, DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE
SEKSIONI 1	Derogimet

SEKSIONI 2	Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare
SHTOJCA I	Tabela A dhe B
SHTOJCA II	Funksionet e përfshira në veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv
SHTOJCA III	
Pjesa A	Direktiva e shfuqizuar me listën e ndryshimeve vijuese
Pjesa B	Lista e afateve kohore për transpozim në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin
SHTOJCA IV	Tabela e përputhshmërisë

KAPITULLI I

OBJEKTI, FUSHA E ZBATIMIT DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

1. Kjo direktivë zbatohet për sipërmarrjet e investimeve kolektive në titujt e transferueshëm (SIKTT) të themeluara brenda territorit të shteteve nëtare.

2. Për qëllime të kësaj direktive dhe sipas nenit 3, SIKTT është një sipërmarrje:

- (a) që ka si objektiv të vetëm investimin kolektiv në tituj të transferueshëm ose në asete të tjera financiare likuide, të përmendura në nenin 50, paragrafi 1 të kapitalit të mbledhur nga oferta publike dhe që funksionon mbi parimin e shpërndarjes së rrezikut; dhe
- (b) me kuota, të cilat me kërkesë të mbajtësit, riblihen ose shlyhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga këto asete të sipërmarrjes. Veprimet e ndërmarra nga një SIKTT për të garantuar se vlera në bursë e kuotave të saj nuk ndryshon shumë nga vlera neto e aseteve të tyre, konsiderohen si të barasvlershme me riblerjen ose shlyerjen.

Shtetet anëtare mund të lejojnë që SIKTT-ja të përbëhet nga disa divizione investimi

3. Forma e sipërmarrjeve të përmendura në paragrafin 2 mund të jetë në përputhje me të drejtën kontraktore (si fonde të përbashkëta të administruara nga shoqëritë administruese), të drejtën e trusteeve (si fonde kujdestarie) ose statutin (si shoqëri investimi).

Për qëllimet e kësaj direktive:

- (a) "fonde të përbashkëta" përfshin edhe fondet e kujdestarisë;
- (b) "kuota" të SIKTT-ve përfshin edhe aksione të SIKTT-ve.

4. Shoqëritë e investimit, asetet e të cilave nuk investohen në tituj të transferueshëm nëpërmjet ndërmjetësimit të filialeve, nuk janë objekt i kësaj direktive.

5. Shtetet anëtare i ndalojnë SIKTT-të të cilat janë objekt i kësaj direktive që të shndërrohen në sipërmarrje investimesh kolektive, të cilat nuk mbulohen nga kjo direktivë.

6. Sipas dispozitave të legjislacionit të komunitetit që rregullon lëvizjet e kapitalit dhe sipas neneve 91 dhe 92 dhe nënparagrafit të dytë të nenit 108, paragrafi 1, asnjë shtet anëtar nuk do të

zbatohet asnjë dispozitë tjetër në fushën e mbuluar nga kjo direktivë për SIKTT-të e themeluara në një tjetër shtet anëtar ose për kuotat e emetuara nga këto SIKTT, në rastet kur këto SIKTT i marketojnë kuotat e tyre brenda territorit të atij shteti anëtar.

7. Pa cenuar këtë KapitullKapitull, një shtet anëtar mund të zbatohet për një SIKTT të themeluar brenda territorit të tij kërkesa të cilat janë më strikte ose kërkesa në shtesë të atyre të përcaktuara në këtë direktivë, me kusht që të jenë të një zbatimi të përgjithshëm dhe që të mos bien ndesh me dispozitat e kësaj direktive.

Neni 2

1. Për qëllime të kësaj direktive përdoren përkufizimet e mëposhtme:

- (a) "depozitar" është një institucion, të cilit i janë besuar detyrat e përcaktuara në nenet 22 dhe 32 dhe i cili është objekt i dispozitave të përcaktuara në KapitullKapitullin IV dhe Seksionin 3 të Kapitullit V;
- (b) "shoqëri administruese" është shoqëria, veprimtaria normale e biznesit, të të cilës është administrimi i SIKTT-ve në formën e fondeve të përbashkëta ose të shoqërive të investimit (administrimi i portofolit kolektiv të SIKTT-ve);
- (c) "shteti anëtar i origjinës i shoqërisë administruese" është shteti Anëtar në të cilin shoqëria administruese ka adresën e saj të regjistruar;
- (d) "shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese" është shteti anëtar, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës, brenda territorit të cilit shoqëria administruese ka degë ose ofron shërbime;
- (e) "shteti anëtar i origjinës i SIKTT-së" është shteti anëtar në të cilin SIKTT-ja është e autorizuar, në përputhje me nenin 5;
- (f) "shteti anëtar pritës i SIKTT-së" është shteti anëtar, i ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës i SIKTT-së, në të cilin marketohen kuotat e SIKTT-së;
- (g) "dega" është vendi i ushtrimit të veprimtarisë që është pjesë e shoqërisë administruese, që nuk ka personalitet juridik dhe ofron shërbimet për të cilat është autorizuar shoqëria administruese;
- (h) "autoritetet kompetente" janë autoritetet që caktohen nga shtetet anëtare sipas nenit 97;
- (i) "lidhjet e ngushta" është situata në të cilën dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë të lidhur përmes:
 - (i) "pjesëmarrjes", e cila është zotërimi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes kontrollit, i 20% ose më shumë të të drejtave të votës ose të kapitalit të një sipërmarrjeje; ose
 - (ii) "kontrollit", që është marrëdhënia ndërmjet një "sipërmarrjeje mëmë" dhe një "filiali", siç përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të Direktivës së Shtatë të Këshillit 83/349/KEE të 13 Qershorit 1983, mbështetur në nenin 54, paragrafi 3, germa (g) të traktatit për llogaritë e

konsoliduara ⁽¹⁰⁾ dhe në të gjitha rastet e përmendura në nenin 1, paragrafi 1 dhe 2 të Direktivës 83/349/KEE, ose marrëdhënia e ngjashme ndërmjet çdo personi fizik ose juridik dhe një sipërmarrjeje;

- (j) "pjesëmarrje influencuese" është pjesëmarrja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në një shoqëri administruese, që përfaqëson 10% ose më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës ose që mundëson ushtrimin e një ndikimi dominues mbi administrimin e shoqërisë administruese në të cilën bën pjesë pjesëmarrja;
- (k) "kapitali themeltar" janë fondet e përmendura në nenin 57, germa (a) dhe (b) të Direktivës 2006/48/KE;
- (l) "fonde të veta" janë fondet vetjake, të përmendura në Titullin V, Kapitulli 2, Seksioni 1 të Direktivës 2006/48/KE;
- (m) "medium i qëndrueshëm" është një instrument i cili i mundëson investitorit të ruajë informacione që i drejtohen atij personalisht, në mënyrë të atillë që të mund të aksesohen në të ardhmen, për një periudhë kohore të përshtatshme për qëllimin e informimit dhe i cili lejon riprodhimin e pandryshuar të informacionit të ruajtur;
- (n) "tituj të transferueshëm" janë:
 - (i) aksione në shoqëri dhe tituj të tjerë të barasvlershëm me aksionet në shoqëri (aksionet);
 - (ii) bono dhe forma të tjera të borxhit të siguar (instrumente të borxhit);
 - (iii) çdo titull tjetër i negociueshëm i cili mbart të drejtën për të blerë tituj të tillë të transferueshëm nëpërmjet nënshkrimit ose këmbimit;
- (o) "instrumente të tregut të parasë" janë instrumentet, të cilat tregtohen normalisht në tregun monetar, janë likuide dhe kanë një vlerë e cila mund të përcaktohet me saktësi në çdo kohë;
- (p) "bashkim" është një operacion, përmes të cilit:
 - (i) një ose më shumë SIKTT ose divizionet e saj të investimit, "SIKTT-ja bashkuese", pasi shpërbëhet pa hyrë në likuidim, i transferon të gjitha aktivet dhe pasivet në një SIKTT tjetër ekzistuese ose divizion të saj, "SIKTT-ja përfituese", në këmbim të emetimit të kuotave të SIKTT-së përfituese dhe, sipas rastit, të pagesës në para që nuk i kalon 10% të vlerës neto të aseteve të këtyre kuotave;
 - (ii) dy ose më shumë SIKTT ose divizionet e saj të investimit, "SIKTT-ja bashkuese", pasi shpërbëhen pa hyrë në likuidim, i transferojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e tyre në një SIKTT që ato krijojnë ose divizion të saj, "SIKTT-ja përfituese", në këmbim të emetimit të kuotave të SIKTT-së përfituese dhe, sipas rastit, të pagesës në para që nuk i kalon 10% të vlerës neto të aseteve të këtyre kuotave;
 - (iii) një ose më shumë SIKTT ose divizion investimi i saj, "SIKTT-ja bashkuese", të cilat

vijojnë të ekzistojnë derisa të jenë çliruar nga të gjitha detyrimet, i transferojnë asetet e tyre në një divizion tjetër investimi të të njëjtës SIKTT, në një SIKTT që ato krijojnë ose në një SIKTT ekzistuese apo divizion investimi të saj, "SIKTT-ja përfituese";

(q) "bashkim ndërkufitar" është bashkimi i SIKTT-ve:

(i) ku të paktën dy prej të cilave janë themeluar në shtete të ndryshme anëtare; ose

(ii) të themeluara në të njëjtin shtet anëtar në një SIKTT të sapokrijuar të themeluar në një tjetër shtet anëtar;

(r) "bashkim i brendshëm" është një bashkim ndërmjet SIKTT-ve të themeluara në të njëjtin shtet anëtar ku të paktën një prej SIKTT-ve të përfshira është njoftuar sipas nenit 93.

2. Për qëllime të paragrafit 1 germa (b), veprimtaria e rregullt tregtare e një shoqërie administruese përfshin funksionet e përmendura në Shtojcën II.

3. Për qëllime të paragrafit 1, germa (g), të gjitha vendet e veprimtarisë tregtare të themeluara në të njëjtin shtet anëtar nga një shoqëri administrimi, e cila i ka zyrat qendrore në një tjetër shtet anëtar, do të konsiderohet si një degë e vetme.

4. Për qëllime të pikës (i), (ii) të paragrafit 1 vlejnë pikat e mëposhtme:

(a) filiali i një filiali konsiderohet gjithashtu si filial i sipërmarrjes mëmë e cila është në krye të këtyre filialeve;

(b) situatat në të cilat dy ose më shumë persona fizikë ose juridikë janë përgjithmonë të lidhur me të njëjtin person nga një marrëdhënie kontrolli, konsiderohen gjithashtu se përbëjnë lidhje të ngushta ndërmjet këtyre personave.

5. Për qëllime të paragrafit 1, germa (j), merren në konsideratë të drejtat e votës të përmendura në nenet 9 dhe 10 të Direktivës 2004/109/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 15 Dhjetorit 2004 për harmonizimin e kërkesave për transparencë, në lidhje me informacionin rreth emetuesve, titujt e të cilëve janë pranuar për t'u tregtuar në një treg të rregulluar ⁽¹¹⁾.

6. Për qëllime të paragrafit 1, germa (I), nenet 13 deri në 16 të Direktivës 2006/49/KE do të zbatohen *mutatis mutandis*.

7. Për qëllime të paragrafit 1, germa (n), titujt e transferueshëm përjashtojnë teknikat dhe instrumentet e përmendura në nenin 51.

Neni 3

Sipërmarrjet e mëposhtme nuk janë objekt i kësaj direktive:

(a) sipërmarrjet e investimeve kolektive me pjesëmarrje të mbyllur;

(b) sipërmarrjet e investimeve kolektive, të cilat e mbledhin kapitalin pa e promovuar shitjen e kuotave të tyre në publik brenda Komunitetit ose në një pjesë të tij;

(c) sipërmarrjet e investimeve kolektive kuotat e të cilave, sipas rregullave të fondit ose

dokumenteve të themelimit të shoqërisë së investimit, mund t'i shiten vetëm publikut në vendet e treta;

- (d) kategoritë e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të përcaktuara nga rregulloret e shteteve anëtare ku janë themeluar këto sipërmarrje të investimeve kolektive, për të cilat rregullat e përcaktuara në Kapitullin VII dhe nenin 83 nuk janë të përshtatshme për politikat e tyre të huamarrjes dhe investimit.

Neni 4

Për qëllime të kësaj direktive, SIKTT-ja do të konsiderohet se është themeluar në shtetin e saj anëtar të origjinës.

KAPITULLI II AUTORIZIMI I SIKTT-VE

Neni 5

1. Asnjë SIKTT nuk do të ushtrojë veprimtarinë pa qenë e autorizuar në përputhje me këtë direktivë.

Ky autorizim vlen për të gjitha shtetet anëtare.

2. Fondi i përbashkët autorizohet vetëm nëse autoritetet kompetente të shtetit të tij anëtar të origjinës miratojnë aplikimin e shoqërisë administruese për të administruar këtë fond të përbashkët, rregullat e fondit dhe zgjedhjen e depozitarit. Shoqëria e investimit autorizohet vetëm nëse autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës miratojnë njëherazi dokumentet e saj të themelimit dhe zgjedhjen e depozitarit, dhe kur është rastit, aplikimin e shoqërisë administruese të caktuar për të administruar këtë shoqëri investimi.

3. Pa cenuar paragrafin 2, nëse SIKTT-ja nuk është themeluar në shtetin anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së marrin vendim mbi aplikimin e shoqërisë administruese për të administruar SIKTT-në në përputhje me nenin 20. Autorizimi nuk kushtëzohet me detyrimin që SIKTT-ja të administrohet nga një shoqëri administruese e cila ta ketë adresën e regjistruar në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së apo që shoqëria administruese ta ushtrojë apo ta delegojë veprimtarinë e saj në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së nuk e autorizojnë SIKTT-në nëse:

- (a) gjykojnë se shoqëria e investimit nuk i përmbush kushtet paraprake të përcaktuara në nenin V; ose
- (b) shoqëria administruese nuk është autorizuar për administrimin e SIKTT-së në shtetin e saj anëtar të origjinës.

Pa çënuar nenin 29, paragrafi 2, shoqëria administruese ose, sipas rastit, shoqëria e investimit, do të informohet brenda dy muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse është dhënë apo jo autorizimi për SIKTT-në.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së nuk e autorizojnë SIKTT-në nëse drejtorët e depozitarit nuk kanë reputacion mjaftueshëm të mirë ose nuk kanë përvojë të mjaftueshme me llojin e SIKTT-së që do të administrohet. Për këtë arsye, emrat e drejtorëve të depozitarit dhe të çdo pasardhësi të tyre në detyrë i komunikohen menjëherë autoriteteve kompetente.

Drejtorë janë ata persona të cilët, sipas ligjit ose dokumenteve të themelimit, përfaqësojnë depozitarin, apo që përcaktojnë plotësisht politikën e depozitarit.

5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së nuk japin autorizim nëse SIKTT-së i ndalohet ligjërisht (për shembull, nëpërmjet një dispozite në rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit) që t'i marketojë kuotat në shtetin e saj anëtar të origjinës.

6. Shoqëria administruese dhe depozitari nuk mund të zëvendësohen, si dhe rregullat e fondit dhe dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit nuk mund të ndryshohen, pa miratimin e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së.

7. Shtetet anëtare garantojnë se informacioni i plotë mbi ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative, në zbatim të kësaj direktive, sa i përket përbërjes dhe funksionimit të SIKTT-së, është lehtësisht i aksesueshëm nga larg ose përmes mjeteve elektronike. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që ky informacion të jetë i disponueshëm minimalisht në gjuhën e përdorur gjerësisht në sferën e financave ndërkombëtare, si dhe të jetë i qartë, jo të dykuptimtë dhe i përditësuar.

KAPITULLI III

DETYRIMET E SHOQËRIVE ADMINISTRUESE

SEKSIONI 1

Kushtet për nisjen e veprimtarisë tregtare

Neni 6

1. Aksesimi në veprimtarinë tregtare të shoqërive administruese është objekt i autorizimit paraprak, që jepet nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese. Autorizimi që i jepet shoqërisë administruese sipas kësaj direktive vlen për të gjitha shtetet anëtare.

2. Asnjë shoqëri administrimi nuk duhet të merret me asnjë veprimtari tjetër përveç administrimit të SIKTT-së të autorizuar sipas kësaj direktive, me përjashtim të administrimit shtesë të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive që nuk mbulohen nga kjo direktivë dhe për të cilën shoqëria administruese është objekt i mbikëqyrjes së kujdesshme, por kuotat e së cilës nuk mund të marketohen në shtete të tjera anëtare sipas kësaj direktive.

Për qëllime të kësaj direktive, veprimtaria e administrimit të SIKTT-së përfshin funksionet e përmendura në Shtojcën II.

3. Përveç administrimit të SIKTT-së, nëpërmjet derogimit nga paragrafi 2, shtetet anëtare mund t'i autorizojnë shoqëritë administruese që të ofrojnë shërbimet e mëposhtme:

(a) administrimin e portofolave të investimeve, duke përfshirë ata të zotëruar nga fondet e pensioneve, në përputhje me mandatet e dhëna nga investitorët mbi baza diskrecioni dhe sipas klientit, në rastet kur këta portofola përfshijnë një ose më shumë nga instrumentet e renditura në Shtojcën I, Seksioni C të Direktivës 2004/39/KE; dhe

(b) si shërbime dytësore:

(i) këshilla për investimet lidhur me një ose më shumë prej instrumenteve të renditur në Shtojcën I, Seksioni C të Direktivës 2004/39/KE;

(ii) ruajtja dhe administrimi i kuotave të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Sipas kësaj direktive, shoqëritë administruese nuk autorizohen vetëm për ofrimin e shërbimeve të përmendura në këtë paragraf ose për ofrimin e shërbimeve dytësore, pa qenë të autorizuar për shërbimet e përmendura në germën (a) të nënparagrafit të parë.

4. Shoqëritë administruese zbatojnë nenin 2, paragrafi 2 dhe nenet 12, 13 dhe 19 të Direktivës 2004/39/KE për ofrimin e shërbimeve të përmendura në paragrafin 3 të këtij neni.

Neni 7

1. Pa cenuar kushtet e tjera të përgjithshme të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, autoritetet kompetente nuk i japin autorizim shoqërisë administruese nëse nuk përmbush kushtet e mëposhtme:

(a) shoqëria administruese ka një kapital themeltar prej të paktën 125 000 euro, duke marrë në konsideratë pikat e mëposhtme:

(i) kur vlera e portofolave të shoqërisë administruese e tejkalon shumën 250 000 000 euro, shoqëria administruese duhet të ofrojë një shumë shtesë nga fondet e veta, e cila të jetë e barabartë me 0,02% të shumës me të cilën vlera e portofolave të shoqërisë administruese tejkalon 250 000 000 euro, por, sidoqoftë, totali i nevojshëm i kapitalit themeltar dhe shumës shtesë nuk duhet t'i kalojnë 10 000 000 euro;

(ii) për qëllime të këtij paragrafi, portofolat e mëposhtëm duhet të konsiderohen se janë portofola të shoqërisë administruese:

— fondet e përbashkëta të administruara nga shoqëria administruese, duke përfshirë portofolat për të cilët ajo ka deleguar funksionin e administrimit, por duke përjashtuar portofolat që po administron nën delegim,

— shoqëritë e investimit për të cilat shoqëria administruese është shoqëria

administruese e caktuar,

— sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive, të administruara nga shoqëria administruese, duke përfshirë portofolat për të cilët ajo ka deleguar funksionin e administrimit, por duke përjashtuar portofolat që po administrojnë nën delegim;

(iii) pavarësisht nga shuma e këtyre kërkesave, fondet e veta të shoqërisë administruese nuk duhet të jenë në asnjë moment më pak se sa shuma e përcaktuar në nenin 21 të Direktivës 2006/49/KE;

(b) personat, të cilët ushtrojnë plotësisht veprimtarinë tregtare të një shoqërie administruese kanë reputacion mjaftueshëm të mirë dhe kanë përvojë të mjaftueshme me llojin e SIKTT-së së administruar nga shoqëria administruese, emrat e këtyre personave dhe të çdo pasardhësi të tyre në detyrë i komunikohen menjëherë autoriteteve kompetente dhe ushtrimi i veprimtarisë së një shoqërie administruese vendoset nga të paktën dy persona që i përmbushin këto kushte;

(c) aplikimi për autorizim shoqërohet nga programi i veprimtarisë, në të cilin përcaktohet, minimalisht, struktura organizative e shoqërisë administruese; dhe

(d) zyra qendrore dhe adresa e regjistruar e shoqërisë administruese ndodhen në të njëjtin shtet anëtar.

Për qëllime të germës (a) të nënparagrafit të parë, shtetet anëtare mund t'i autorizojnë shoqëritë administruese të mos ofrojnë deri në 50% të shumës shtesë nga fondet e tyre, sipas parashikimit në pikën i të germës (a), nëse ato përfitojnë nga garancia me të njëjtën shumë që ka dhënë një institucion kreditimi ose një sipërmarrje sigurimesh, e cila e ka selinë të regjistruar në një shtet anëtar ose në një vend të tretë ku u nënshtrohet rregullave të mirëmbledhura, që autoritetet kompetente i konsiderojnë si të barasvlershme me ato të përcaktuara në legjislacionin e komunitetit.

2. Në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta ndërmjet shoqërisë administruese dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, autoritetet kompetente e japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet kompetente e refuzojnë autorizimin edhe nëse ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të tretë, të cilat rregullojnë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët shoqëria administruese ka lidhje të ngushta ose kur vështirësitë të cilat përfshihen në zbatimin e tyre, pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet kompetente u kërkojnë shoqërive administruese t'u japin atyre informacionin e nevojshëm për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme pajtueshmërinë me kushtet e përmendura në këtë paragraf.

3. Autoritetet kompetente e informojnë aplikantin brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse është dhënë ose jo autorizimi. Kur autorizimi refuzohet duhet të jepen edhe arsyet.
4. Shoqëria administruese mund ta fillojë veprimtarinë menjëherë pasi jepet autorizimi.
5. Autoritetet kompetente mund ta tërheqin autorizimin e dhënë për një shoqëri administruese që është objekt i kësaj direktive vetëm në rastet kur kjo shoqëri:
 - (a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht autorizimin ose nuk e ushtron më veprimtarinë e mbuluar nga kjo direktive për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës nuk ka parashikuar mbarimin e afatit të autorizimit në këto raste;
 - (b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklaratë të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;
 - (c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;
 - (d) nuk është më në përputhje me Direktivën 2006/49/KE nëse autorizimi i saj mbulon gjithashtu edhe shërbimin e administrimit me diskrecion të portofolit, të përmendur në nenin 6, paragrafi 3, germa (a) të kësaj direktive;
 - (e) ka kryer shkelje të rëndë ose të përsëritur të dispozitave të miratuara sipas kësaj direktive; ose
 - (f) është një prej atyre rasteve në të cilat legjisllacioni i brendshëm parashikon tërheqje.

Neni 8

1. Autoritetet kompetente nuk japin autorizim për nisjen e veprimtarisë së shoqërive administruese, derisa të informohen mbi identitetin e aksionarëve ose të anëtarëve, qoftë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të personave fizikë ose juridikë, që kanë pjesëmarrje influencuese, dhe për shumatat këtyre pjesëmarrjeve.

Autoritetet kompetente e refuzojnë autorizimin nëse, duke marrë në konsideratë nevojën për të garantuar administrim të shëndoshë dhe të kujdesshëm të një shoqërie administruese, ata nuk janë të kënaqur sa i përket përshtatshmërisë së aksionarëve ose të snëtarëve, të përmendur në nënparagrafin e parë.

2. Në rastin e degëve të shoqërive administruese që kanë adresë të regjistruara jashtë Komunitetit dhe po nisin apo ushtrojnë veprimtari tregtare, shtetet anëtarë nuk duhet të zbatojnë dispozitë që rezultojnë në trajtim më të favorshëm se sa ai që u bëhet degëve të shoqërive administruese që kanë adresë të regjistruara në shtetet anëtare.

3. Autoritetet kompetente të shtetit tjetër anëtar të përfshirë duhet të konsultohen paraprakisht lidhur me autorizimin e çdo shoqërie administruese, që mund të jetë një nga të mëposhtmet:

- (a) një filial i një shoqërie tjetër administruese, një firmë investimesh, një institucion kreditimi ose një sipërmarrje sigurimesh e autorizuar në një shtet tjetër anëtar;

- (b) një filial i një sipërmarrjeje mëmë të një shoqërie tjetër administruese, një firmë investimesh, një institucion kreditimi ose një sipërmarrje sigurimesh e autorizuar në një shtet tjetër anëtar; ose
- (c) një shoqëri e kontrolluar nga të njëjtët persona fizikë ose juridikë që kontrollojnë një tjetër shoqëri administruese, një firmë investimesh, një institucion kreditimi ose një sipërmarrje sigurimesh të autorizuar në një shtet tjetër anëtar.

SEKSIONI 2

Marrëdhëniet me vendet e treta

Neni 9

1. Marrëdhëniet me vendet e treta rregullohen në përputhje me rregullat përkatëse të përcaktuara në nenin 15 të Direktivës 2004/39/KE.

Për qëllime të kësaj direktive, termat "firmë investimesh" dhe "firma investimesh", të përmendura në nenin 15 të Direktivës 2004/39/KE janë përkatësisht, "shoqëria administruese" dhe "shoqëritë administruese"; termi "ofrimi i shërbimeve të investimit", i përmendur në nenin 15, paragrafi 1 i Direktivës 2004/39/KE, është "ofrimi i shërbimeve".

2. Shtetet anëtare e informojnë Komisionin për çdo vështirësi të përgjithshme që ndeshin SIKTT-të në marketimin e kuotave të tyre në një vend të tretë.

SEKSIONI 3

Kushtet e funksionimit

Neni 10

1. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese i kërkojnë shoqërisë administruese, që kanë autorizuar, të jetë në çdo moment në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 6 dhe nenin 7, paragrafi 1 dhe 2.

Fondet e veta të shoqërisë administruese nuk duhet të bien nën nivelin e specifikuar në nenin 7, paragrafi 1, germa (a). Por gjithsesi nëse kjo gjë ndodh, autoritetet kompetente, në rrethana të justifikuara, mund t'u lejojnë këtyre firmave një periudhë kohe të kufizuar gjatë së cilës të rregullojnë gjendjen e tyre ose të pushojnë veprimtaritë.

2. Mbikëqyrja e kujdesshme e një shoqërie administruese është përgjegjësi e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, pavarësisht nëse shoqëria administruese e krijon degën ose i ofron shërbimet në një shtet tjetër anëtar apo jo, pa cenuar ato dispozita të kësaj direktive që u japin përgjegjësi autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës së shoqërisë administruese.

Neni 11

1. Pjesëmarrjet influencuese në shoqëritë administruese janë objekt i të njëjtave rregulla si ato të përcaktuara në nenet 10, 10a dhe 10b të Direktivës 2004/39/KE.
2. Për qëllime të kësaj directive, termat "firmë investimi" dhe "firma investimesh" të përmendura në nenin 10 të Direktivës 2004/39/KE, janë përkatësisht, "shoqëria administruese" dhe "shoqëritë administruese".

Neni 12

1. Secili shtet anëtar harton rregulla të kujdeshme të cilat shoqëritë administruese të autorizuara në atë shtet anëtar, duhet t'i respektojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së administrimit të SIKTT-së së autorizuar në përputhje me këtë direktivë.

Konkretisht, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, duke marrë në konsideratë edhe natyrën e SIKTT-së së administruar nga shoqëria administruese, i kërkojnë çdo shoqërie të tillë që:

- (a) të ketë procedura të forta administrative dhe kontabiliteti, masa kontrolli dhe mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave elektronike dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm duke përfshirë, sidomos, rregullat për transaksionet personale nga punonjësit e saj ose për zotërimin ose administrimin e investimeve në instrumente financiare me qëllim investimin në llogaritë e saj dhe garantimin, që të paktën, çdo transaksion që përfshin SIKTT-në të mund të rindërtohet sipas origjinës së tij, palëve në të, natyrës, kohës dhe vendit ku është kryer dhe se asetet e SIKTT-së së administruar nga shoqëria administruese të jenë investuar në përputhje me rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit dhe dispozitat ligjore në fuqi;
- (b) të jetë e strukturuar dhe organizuar në mënyrë të atillë që të minimizojë rrezikun që interesat e SIKTT-së ose të klientëve të mund të cenohen nga konfliktet e interesit ndërmjet shoqërisë dhe klientëve të saj, ndërmjet dy prej klientëve të saj, ndërmjet njërit prej klientëve të saj dhe një SIKTT-je, ose ndërmjet dy SIKTT-ve.

2. Çdo shoqëri administruese, autorizimi i së cilës mbulon edhe shërbimin e administrimit me diskrecion të portofolit, të përmendur në nenin 6, paragrafi 3 germa (a):

- (a) nuk lejohet të investojë të gjithë ose një pjesë të portofolit të investitorit në kuota të sipërmarrjes së investimeve kolektive që ka në administrim, me përjashtim të rasteve kur merr miratim paraprak të klientit;
- (b) për shërbimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 3, duhet t'i nënshtrohet dispozitave të përcaktuara në Direktivën 97/9/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 3 Marsit 1997 për skemat investitor-kompensim ⁽¹²⁾.

3. Pa cenuar nenin 116, deri më 1 Korrik 2010, Komisioni duhet të miratojë masat zbatuese që specifikojnë procedurat dhe masat, e përmendura në germën (a) të nënparagrafit të dytë të paragrafit 1, si dhe strukturat dhe kërkesat organizative për të minimizuar konfliktet e interesit, të përmendura në germën (b) të nënparagrafit të dytë të paragrafit 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 13

1. Nëse legjislacioni i shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese i lejon shoqëritë administruese që të delegojnë kryerjen e një ose më shumë funksioneve te palë të treta, për qëllime të një ushtrimit më efikas të veprimtarisë së shoqërive, duhet të respektohen të gjitha kushtet paraprake të mëposhtme:

- (a) shoqëria administruese duhet të informojë në mënyrë të përshtatshme autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës; autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese duhet t'ua përcjellin menjëherë informacionet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së;
- (b) mandati nuk duhet të pengojë efikasitetin e mbikëqyrjes mbi shoqërinë administruese dhe, sidomos, nuk duhet ta pengojë shoqërinë administruese të veprojë, ose SIKTT-në të administrohet, në interesin më të mirë të investitorëve të saj;
- (c) në rastet kur delegimi përfshin administrimin e investimeve, mandati duhet t'u jepet vetëm sipërmarrjeve të cilat janë autorizuar ose regjistruar për qëllime të administrimit të aseteve dhe janë objekt i mbikëqyrjes së kujdesshme; delegimi duhet të jetë në përputhje me kriteret e alokimit të investimeve, të shqyrtuara në mënyrë periodike nga shoqëritë administruese;
- (d) në rastet kur mandati përfshin administrimin e investimeve dhe i jepet një sipërmarrjeje në një vend të tretë, duhet të garantohet bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të përfshira;
- (e) mandati për funksionin kryesor të administrimit të investimeve nuk duhet t'i jepet depozitarit ose çdo sipërmarrjeje tjetër, interesat e së cilës mund të jenë në konflikt me ato të shoqërisë administruese ose të mbajtësve të kuotave;
- (f) duhet të ekzistojnë masa të cilat u mundësojnë personave që ushtrojnë veprimtarinë e shoqërisë administruese, që të monitorojnë në mënyrë efikase, në çdo kohë, veprimtarinë e sipërmarrjes së cilës i është dhënë mandati;
- (g) mandati nuk duhet të pengojë personat që ushtrojnë veprimtarinë e shoqërive administruese që t'i japin instruksione të tjera, në çdo kohë, sipërmarrjes te e cila janë deleguar funksionet ose që të tërheqin mandatin me efekt të menjëhershëm, kur kjo është në interes të investitorëve;
- (h) duke pasur parasysh natyrën e funksioneve që do të delegohen, sipërmarrja së cilës do t'i delegohen funksionet duhet të jetë e kualifikuar dhe e aftë për të marrë përsipër funksionet në fjalë; dhe

(i) në prospektet e SIKTT-së duhet të renditen funksionet që shoqërisë administruese i lejohet të delegojë në përputhje me këtë nen.

2. Delegimi i funksioneve nga shoqëria administruese te palët e treta nuk duhet të cenohet përgjegjësinë e shoqërisë administruese ose të depozitarit. Shoqëria administruese nuk duhet t'i delegojë funksionet e saj deri në atë pikë sa të bëhet një subjekt i cili merret me korrespondencë letrash.

Neni 14

1. Çdo shtet anëtar harton rregullat për ushtrimin e veprimtarisë, të cilat duhet të respektohen gjatë gjithë kohës nga shoqëritë administruese të autorizuar në atë shtet anëtar. Këto rregulla duhet të zbatohen të paktën parimet e përcaktuara në këtë paragraf. Këto parime duhet të garantojnë se shoqëria administruese:

- (a) vepron me ndershmëri dhe drejtësi në ushtrimin e veprimtarive të saj tregtare, në interesin më të mirë të SIKTT-së që administron dhe në dobi të integritetit të tregut;
- (b) vepron me aftësitë dhe kujdesin e duhur, në interesin më të mirë të SIKTT-ve që administron dhe në dobi të integritetit të tregut;
- (c) ka dhe përdor në mënyrë efikase burimet dhe procedurat që janë të nevojshme për ecurinë sa më të mirë të veprimtarive të saj;
- (d) përpiqet që të shmangë konfliktet e interesit dhe, në rastet kur janë të pashmangshme, garanton që SIKTT-të që administron të trajtohen në mënyrë të paanshme; dhe
- (e) respekton të gjitha kërkesat rregullatore që zbatohen për ushtrimin e veprimtarive të saj me qëllim promovimin e interesave më të mira të investitorëve të saj dhe të integritetit të tregut.

2. Pa cënuar nenin 116, deri më 1 Korrik 2010, Komisioni duhet të miratojë masat zbatuese me synim që të garantojë se shoqëria administruese i respekton detyrimet e përcaktuara në paragrafin 1, veçanërisht:

- (a) vendosjen e kritereve të përshtatshme për të vepruar me ndershmëri dhe drejtësi dhe me aftësinë dhe kujdesin e duhur në interesin më të mirë të SIKTT-ve;
- (b) specifikimin e parimeve të nevojshme për të garantuar se shoqëritë administruese i përdorin me efikasitet burimet dhe procedurat që janë të nevojshme për ecurinë sa më të mirë të veprimtarive të tyre; dhe
- (c) përcaktimin e hapave që, në mënyrë të arsyeshme, pritet të ndërmarrin shoqëritë administruese për të identifikuar, parandaluar, menaxhuar dhe zbardhur konfliktet e interesit si edhe për të vendosur kriteret e duhura për përcaktimin e llojeve të konflikteve të interesit, ekzistenca e të cilave mund të dëmtojë interesat e SIKTT-ve.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 15

Shoqëritë administruese ose, sipas rastit, shoqëritë e investimit marrin masa në përputhje me nenin 92 dhe vendosin procedurat dhe masat e duhura për të garantuar se i trajtojnë siç duhet ankesat e investitorëve dhe se nuk ka kufizime për investitorin në ushtrimin e të drejtave të tij në rast se shoqëria administruese është autorizuar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së. Këto masa i lejojnë investitorët që të depozitojnë ankesa në gjuhën zyrtare ose në një prej gjuhëve zyrtare të shtetit të tyre anëtar.

Shoqëritë administruese duhet të vendosin edhe procedurat dhe masat e duhura për ta bërë informacionin të disponueshëm kur kërkohet nga publiku ose autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së.

SEKSIONI 4

Liria e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve

Neni 16

1. Shtetet anëtare garantojnë se shoqëria administruese, e autorizuar nga shteti i saj anëtar i origjinës, mund ta ndjekë veprimtarinë për të cilën është autorizuar brenda territoreve të tyre, qoftë nëpërmjet themelimit të një dege ose në kuadër të lirisë së ofrimit të shërbimeve.

Në rast se shoqëria administruese e autorizuar në këtë mënyrë propozon që t'i marketojë kuotat e SIKTT-së të cilën e administron pa themeluar një degë, siç parashikohet në Shtojcën II, në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së, pa propozuar ndjekjen e veprimtarive ose shërbimeve të tjera, ky marketim është objekt i kërkesave të Kapitullit XI.

2. Shtetet anëtare nuk e kushtëzojnë themelimin e një dege ose ofrimin e shërbimeve me detyrimin për t'u pajisur me autorizim për këtë qëllim, ose për të vërtetuar kapitalin e financimit apo me masa të tjera me të njëjtin efekt.

3. Sipas kushteve të përcaktuara në këtë nen, SIKTT-ja është e lirë të caktojë ose të administrohet nga një shoqëri administruese e autorizuar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj direktive, me kusht që kjo shoqëri administruese të respektojë dispozitat e:

- (a) Nenit 17 ose nenit 18; dhe
- (b) Nenit 19 dhe 20.

Neni 17

1. Përveç përmbushjes së kushteve të vendosura në nenet 6 dhe 7, shoqëria administruese e cila dëshiron të themelojë një degë brenda territorit të një shteti tjetër anëtar për të ndjekur veprimtaritë për të cilat është autorizuar, duhet të njoftojë për këtë qëllim autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës.

2. Shtetet anëtare i kërkojnë çdo shoqërie administruese që dëshiron të themelojë një degë brenda territorit të një shteti tjetër anëtar që të japë informacionet dhe dokumentet e mëposhtme, në rastet kur dërgohet njoftimi i parashikuar në paragrafin 1:

(a) shtetin anëtar brenda territorit të të cilit shoqëria administruese planifikon të themelojë degën;

(b) programin e operacioneve që përcakton veprimtaritë dhe shërbimet e parashikuara në përputhje me nenin 6, paragrafi 2 dhe 3 dhe strukturën organizative të degës, e cila përfshin përshkrimin e procesit të administrimit të riskut që ndjek shoqëria administruese. Gjithashtu duhet të përfshijë përshkrimin e procedurave dhe të marrëveshjeve të realizuara në përputhje me nenin 15;

(c) adresën në shtetin anëtar pritës të shoqërisë administruese nga e cila mund të merren dokumentet; dhe

(d) emrat e personave përgjegjës për administrimin e degës.

3. Me përjashtim të rasteve kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese kanë arsye të vënë në dyshim përshtatshmërinë e strukturës administrative ose situatën financiare të shoqërisë administruese, duke marrë parasysh veprimtaritë e parashikuara, brenda dy muajve nga marrja e të gjithë informacionit të përmendur në paragrafin 2, ato ia komunikojnë këtë informacion autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese dhe informojnë përkatësisht shoqërinë administruese. Ato japin edhe detaje për skema kompensimi me qëllim mbrojtjen e investitorëve.

Në rastet kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese refuzojnë t'ia komunikojnë informacionin e përmendur në paragrafin 2 autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, ato duhet t'i japin shoqërisë administruese në fjalë arsyet për këtë refuzim, brenda dy muajve nga marrja e të gjithë informacionit. Refuzimi ose çdo moskthim përgjigjeje lind të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave në shtetin anëtar të origjinës së shoqërisë administruese.

Në rastin kur shoqëria administruese dëshiron të ndjekë veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv të përmendur në Shtojcën II, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese do të përfshijnë në dokumentacionin e dërguar te autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, vërtetimin që shoqëria administruese është autorizuar në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, përshkrimin e qëllimit të autorizimit të shoqërisë administruese dhe detajet e çdo kufizimi për llojet e SIKTT-ve që shoqëria administruese është autorizuar të administrojë.

4. Shoqëria administruese, e cila i ndjek veprimtaritë nga një degë brenda territorit të shtetit anëtar pritës, duhet të respektojë rregullat e hartuara nga shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese, në përputhje me nenin 14.
5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me paragrafin 4.
6. Përpara se dega e shoqërisë administruese të fillojë veprimtarinë tregtare, brenda dy muajve nga marrja e informacionit të përmendur në paragrafin 2, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese përgatiten për të mbikëqyrur pajtueshmërinë e shoqërisë administruese me rregullat që janë përgjegjësi e tyre.
7. Dega mund të themelohet dhe të fillojë veprimtarinë tregtare, pasi kjo t'i komunikohet nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese ose pas përfundimit të periudhës të parashikuar në paragrafin 6, në rast se nuk i komunikohet gjë nga autoritetet.
8. Në rast ndryshimi të të dhënave të komunikuar në përputhje me paragrafin 2 germa (b), (c) dhe (d), shoqëria administruese njofton me shkrim, për këtë qëllim, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese dhe të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, të paktën një muaj përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit, me qëllim që autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese të marrin vendim mbi ndryshimin, sipas paragrafit 3, dhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, të bëjnë të njëjtën gjë, sipas paragrafit 6.
9. Në rast ndryshimi të të dhënave të komunikuar në përputhje me nënparagrafin e parë të paragrafit 3, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese duhet të informojnë përkatësisht autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese përditësojnë informacionin që përmban vërtetimi i përmendur në nënparagrafin e tretë të paragrafit 3 dhe informojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së shoqërisë administruese sa herë që ka një ndryshim në qëllimin e autorizimit të shoqërisë administruese ose në detajet e çdo kufizimi mbi llojet e SIKTT-ve që shoqëria administruese është autorizuar të administrojë.

Neni 18

1. Çdo shoqëri administruese e cila dëshiron të ushtrojë për herë të parë veprimtaritë për të cilat është autorizuar brenda territorit të një shteti tjetër anëtar, në kuadrin e lirisë për të ofruar shërbime, i komunikon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese, informacionet e mëposhtme:
 - (a) shtetin anëtar brenda territorit të të cilit shoqëria administruese synon të veprojë; dhe
 - (b) programin e operacioneve ku jepen veprimtaritë dhe shërbimet e parashikuara, të përmendura në nenin 6, paragrafi 2 dhe 3, dhe përshkrimi i procesit të administrimit të riskut që ndjek shoqëria administruese. Gjithashtu duhet të përfshijë përshkrimin e procedurave dhe të

masave të realizuara, në përputhje me nenin 15.

2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, brenda një muaji nga marrja e informacionit të përmendur në paragrafin 1, ia përcjellin atë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese japin edhe detaje për skema kompensimi me qëllim mbrojtjen e investitorëve.

Në rastin kur shoqëria administruese dëshiron të ndjekë veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv, siç përmendet në Shtojcën II, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese duhet t'i bashkëngjisin dokumentacionit të dërguar te autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së shoqërisë administruese, vërtetimin që shoqëria administruese është autorizuar në përputhje me dispozitat e kësaj direktive, përshkrimin e qëllimit të autorizimit të shoqërisë administruese dhe detajet e çdo kufizimi për llojet e SIKTT-ve që shoqëria administruese është e autorizuar të administrojë.

Pavarësisht nga nenet 20 dhe 93, shoqëria administruese më pas mund të nisë veprimtarinë tregtare në shtetin anëtar pritës të shoqërisë administruese.

3. Shoqëria administruese, e cila e ushtron veprimtarinë, në kuadrin e lirisë së ofrimit të shërbimeve, duhet të respektojë rregullat e hartuara nga shteti anëtar i origjinës së shoqërisë administruese, në përputhje me nenin 14.

4. Kur ndryshohet përmbajtja e informacionit të komunikuar në përputhje me paragrafin 1, germa (b), shoqëria administruese njofton me shkrim për këtë ndryshim autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese dhe të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, përpara hyrjes në fuqi të ndryshimit. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese e përditësojnë informacionin që përmban vërtetimi i përmendur në paragrafin 2 dhe njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së shoqërisë administruese sa herë që ka një ndryshim në qëllimin e autorizimit të shoqërisë administruese ose në detajet e çdo kufizimi në llojet e SIKTT-së që shoqëria administruese është e autorizuar të administrojë.

Neni 19

1. Shoqëria administruese e cila ushtron veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv, përtej kufijve, nëpërmjet themelimit të një dege ose në kuadrin e lirisë për të ofruar shërbime, duhet të respektojë rregullat e shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese të cilat lidhen me organizimin e shoqërisë administruese, duke përfshirë masat për delegim, procedurat e administrimit të riskut, rregullat dhe mbikëqyrjen e kujdesshme, procedurat e përmendura në nenin 12 dhe kërkesat e raportimit të shoqërisë administruese. Këto rregulla nuk duhet të jenë më strikte se sa ato që zbatohen për shoqëritë administruese që i ushtrojnë veprimtaritë e tyre vetëm në shtetin anëtar të origjinës.

2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me paragrafin 1.

3. Shoqëria administruese e cila ushtron veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv, përtej kufijve, nëpërmjet themelimit të një dege ose në kuadër të lirisë për ofrimin e shërbimeve, duhet të respektojë rregullat e shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së, lidhur me përbërjen dhe funksionimin e SIKTT-së, konkretisht rregullat e zbatueshme për:

- (a) krijimin dhe autorizimin e SIKTT-së;
- (b) emetimin dhe shlyerjen e kuotave dhe të aksioneve;
- (c) kufijtë dhe politikat e investimit, duke përfshirë përlllogaritjen e ekspozimit të përgjithshëm dhe të efektit të levës financiare;
- (d) kufizimet për huamarrjen, huadhënien dhe shitjet e pambuluara;
- (e) vlerësimin e aseteve dhe kontabilizimin e SIKTT-ve;
- (f) përlllogaritjen e çmimit të emetimit ose shlyerjes dhe gabimet në përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve dhe të kompensimit të investitorit që lidhet me të;
- (g) shpërndarjen ose riinvestimin e të ardhurave;
- (h) kërkesat për dhënien e informacionit dhe raportimin nga SIKTT-të, duke përfshirë prospektet, informacionin kryesor për investitorët dhe raportet periodike;
- (i) masat e vendosura për marketimin;
- (j) marrëdhënien me mbajtësit e kuotave;
- (k) bashkimin dhe ristrukturimin e SIKTT-ve;
- (l) mbylljen dhe likuidimin e SIKTT-ve;
- (m) sipas rastit, përmbajtjen e regjistrit të mbajtësit të kuotave;
- (n) tarifatat e mbikëqyrjes dhe të licencimit për SIKTT-të; dhe
- (o) ushtrimin e të drejtave të votës të mbajtësve të kuotave dhe të të drejtave të tjera të mbajtësve të kuotave, lidhur me gërmat (a) deri në (m).

4. Shoqëria administruese duhet të respektojë detyrimet e përcaktuara në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit dhe detyrimet e përcaktuara në prospekt, të cilat duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm, të përmendur në paragrafët 1 dhe 3.

5. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë me paragrafët 3 dhe 4.

6. Shoqëria administruese vendos dhe është përgjegjëse për miratimin dhe zbatimin e të gjitha masave dhe vendimeve organizative të cilat janë të nevojshme për të garantuar pajtueshmërinë

me rregullat që kanë të bëjnë me përbërjen dhe funksionimin e SIKTT-së dhe me detyrimet e përcaktuara në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit, si dhe me detyrimet e përcaktuara në prospekt.

7. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e përshtatshmërisë së masave dhe organizimit të shoqërisë administruese, në mënyrë që shoqëria administruese të jetë në gjendje të respektojë detyrimet dhe rregullat të cilat lidhen me përbërjen dhe funksionimin e të gjitha SIKTT-ve që menaxhon.

8. Shtetet anëtare sigurohen që shoqëritë administruese të autorizuar në një shtet anëtar të mos u nënshtrohen kërkesave shtesë të vendosura në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së, lidhur me objektin e kësaj direktive, me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në këtë direktivë.

Neni 20

1. Pa çënuar nenin 5, shoqëria administruese e cila aplikon për të administruar një SIKTT të themeluar në një tjetër shtet anëtar, i paraqet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së dokumentacionin e mëposhtëm:

- (a) marrëveshjen me shkrim me depozitarin, të përmendur në nenet 23 dhe 33; dhe
- (b) informacione mbi masat për delegimin e funksioneve të administrimit dhe të menaxhimit të investimeve, të përmendura në Shtojcën II.

Nëse shoqëria administruese ka në administrim SIKTT të tjera të të njëjtit lloj, në shtetin anëtar të origjinës së SIKTT-së, referimi në dokumentacionin e depozituar fillimisht është i mjaftueshëm.

2. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, për aq kohë sa është e nevojshme që të garantohet pajtueshmëria me rregullat për të cilat ato janë përgjegjëse, mund t'i kërkojnë shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese, sqarime dhe informacione lidhur me dokumentacionin e përmendur në paragrafin 1 dhe, mbështetur në vërtetimin e përmendur në nenet 17 dhe 18, nëse lloji i SIKTT-së për të cilën kërkohet autorizim përfshihet brenda qëllimit të autorizimit të shoqërisë administruese. Sipas rastit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese japin opinionin e tyre brenda 10 ditëve pune nga kërkesa fillestare.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së mund të refuzojnë aplikimin e shoqërisë administruese vetëm nëse:

- (a) shoqëria administruese nuk respekton rregullat që janë përgjegjësi e tyre, sipas nenit 19;
- (b) shoqëria administruese nuk është e autorizuar nga autoritetet kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës për të administruar llojin e SIKTT-së për të cilën është kërkuar autorizimi; ose
- (c) shoqëria administruese nuk ka dorëzuar dokumentacionin e përmendur në paragrafin 1.

Përpara se të refuzojnë një aplikim, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së duhet të konsultohen me autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese.

4. Shoqëria administruese i njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së, për çdo ndryshim të mëvonshëm, të konsiderueshëm, të dokumentacionit të përmendur në paragrafin 1.

Neni 21

1. Për qëllime statistikore, shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese, mund t'i kërkojë të gjitha shoqërive administruese me degë brenda territorit të tij, të raportojnë në mënyrë periodike te autoritetet kompetente të atij shteti anëtar pritës mbi veprimtaritë e tyre të ushtruara në atë shtet anëtar.

2. Shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese mund t'i kërkojë shoqërive administruese që ushtrojnë veprimtarinë tregtare brenda territorit të tij, qoftë nëpërmjet themelimit të një dege ose në kuadër të lirisë për të ofruar shërbime, të japin informacionin e nevojshëm për monitorimin e pajtueshmërisë së tyre me rregullat e zbatueshme, nën përgjegjësinë e shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

Këto kërkesa nuk duhet të jenë më të rrepta se sa ato që po ky shtet anëtar vendos për shoqëritë administruese të autorizuar prej tij, lidhur me monitorimin e pajtueshmërisë së tyre me të njëjtat standarde.

Shoqëritë administruese sigurohen që procedurat dhe masat e përmendura në nenin 15, t'u mundësojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së marrjen e informacionit të përmendur në këtë paragraf, direkt nga shoqëria administruese.

3. Në rastin kur autoritetet kompetente të një shteti anëtar të origjinës të shoqërisë administruese, vërtetojnë se shoqëria administruese, e cila ka një degë ose i ofron shërbimet brenda territorit të tij, është në shkelje të një prej rregullave nën përgjegjësinë e tyre, atëherë ato i kërkojnë shoqërisë administruese në fjalë që t'i japë fund shkeljes dhe vënë në dijeni autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese në lidhje me këtë.

4. Nëse shoqëria administruese në fjalë refuzon t'i japë shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, informacionet që janë nën përgjegjësinë e tij, ose nuk arrin të marrë hapat e nevojshme për t'i dhënë fund shkeljes së përmendur në paragrafin 3, atëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese duhet të njoftojnë përkatësisht autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme, sa më shpejt të jetë e mundur, për të bërë të mundur që shoqëria administruese në fjalë të japë informacionin e kërkuar nga shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese, sipas paragrafit 2, ose t'i japë fund shkeljes. Natyra e këtyre masave i komunikohet autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

5. Nëse, pavarësisht masave të marra nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese ose për shkak se këto masa rezultojnë të jenë të papërshtatshme ose nuk janë të disponueshme në shtetin anëtar në fjalë, shoqëria administruese vijon të refuzojë dhënien e informacionit të kërkuar nga shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese, sipas paragrafit 2, ose vazhdon të shkelë dispozitat ligjore ose rregullatore të përmendura në të njëjtin paragraf, të cilat janë në fuqi në shtetin anëtar pritës së shoqërisë administruese, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës së shoqërisë administruese, pasi vënë në dijeni autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, marrin masat e nevojshme, edhe sipas neneve 98 dhe 99, për të parandaluar ose ndëshkuar parregullsitë e mëtejshme dhe, nëse është e nevojshme, për të privuar këtë shoqëri administruese nga kryerja e transaksioneve të mëtejshme brenda territorit të tij. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që brenda territoreve të tyre, të ekzistojnë dokumentet ligjore të nevojshme për këto masa ndaj shoqërive administruese. Në rastin kur shërbimi që ofrohet brenda shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese, ka të bëjë me administrimin e një SIKTT-je, shteti anëtar pritës i shoqërisë administruese mund t'i kërkojë shoqërisë administruese të pushojë së administruari atë SIKTT.

6. Çdo masë e miratuar në përputhje me paragrafët 4 ose 5, duke përfshirë masat ose penalitetet, duhet t'i justifikohet dhe komunikohet shoqërisë administruese në fjalë. Çdo masë e tillë lind të drejtën për t'iu drejtuar gjykatave në shtetin anëtar që e ka miratuar atë.

7. Përpara se të ndjekin procedurën e përcaktuar në paragrafët 3, 4 ose 5, në raste emergjence, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese mund të marrin çdo masë paraprake të nevojshme për të mbrojtur interesat e investitorëve dhe personave të tjerë, për të cilët ofrohen shërbimet. Komisioni dhe autoritetet kompetente të shteteve të tjera anëtare në fjalë do të informohen sa më shpejt të jetë e mundur për këto masa.

Pasi të konsultohet me autoritetet kompetente të shtetit anëtar në fjalë, Komisioni mund të vendosë që ky shtet anëtar t'i ndryshojë ose shfuqizojë këto masa.

8. Përpara se të tërheqin autorizimin e shoqërisë administruese autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese duhet të konsultohen me autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së. Në këto raste, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së duhet të marrin masat e nevojshme për të mbrojtur interesat e investitorëve. Këto masa mund të përfshijnë vendime për privimin e shoqërisë administruese përkatëse nga kryerja e transaksioneve të mëtejshme, brenda territorit të tij.

Për këto raste Komisioni lëshon një raport çdo dy vjet.

9. Shtetet anëtare e informojnë Komisionin për numrin dhe llojin e rasteve në të cilat ato refuzojnë autorizimin, sipas nenit 17, ose aplikimin, sipas nenit 20, dhe për çdo masë të marrë në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni.

Për këto raste Komisioni lëshon një raport çdo dy vjet.

KAPITULLI IV

DETYRIMET PËR DEPOZITUESIN

Neni 22

1. Asetet e një fondi të përbashkët i besohen një depozituesi për ruajtje.
2. Depozituesi mbetet po njësoj përgjegjës, siç përmendet në nenin 24, edhe nëse ia beson një pale të tretë të gjitha ose një pjesë të aseteve që ka në ruajtje.
3. Depozituesi:
 - (a) garanton që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave për llogari të një fondi të përbashkët ose nga një shoqëri administruese, të kryhet në përputhje me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe rregullat e fondit;
 - (b) garanton që vlera e kuotave të përllorarit në përputhje me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe rregullat e fondit;
 - (c) zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese, me përjashtim të rasteve kur ato bien në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm ose me rregullat e fondit;
 - (d) garanton që në transaksionet që përfshijnë asetet e fondit të përbashkët çdo kërkesë t'i përcillet atij brenda afateve kohore të zakonshme;
 - (e) garanton që të ardhurat e fondit të përbashkët të përdoren në përputhje me legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm dhe rregullat e fondit.

Neni 23

1. Depozituesi duhet ose të ketë adresën e regjistruar ose të jetë i themeluar në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së.
2. Depozituesi është një institucion, i cili është objekt i rregullores së kujdesshme dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme. Gjithashtu ai duhet të japë garanci të mjaftueshme financiare dhe profesionale, që është i aftë të ushtrojë veprimtarinë e tij si depozituese dhe të përmbushë angazhimet që përfshin ai funksion.
3. Shtetet anëtare vendosin se cilat prej kategorive të institucioneve, të përmendura në paragrafin 2, janë të përshtatshme për të qenë depozituese.
4. Depozituesi u mundëson autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së të marrin, me kërkesë të tyre, të gjithë informacionin që depozituesi ka përfutur gjatë realizimit të detyrave të tij dhe që i nevojitet autoriteteve kompetente për të mbikëqyruar pajtueshmërinë e SIKTT-së me këtë direktivë.
5. Në rastin kur shteti anëtar i origjinës së shoqërisë administruese nuk është shteti anëtar i origjinës i SIKTT-së, depozituesi nënshkruan një marrëveshje me shkrim me shoqërinë administruese, për të rregulluar qarkullimin e informacionit që gjykohet si i nevojshëm për t'i mundësuar atij kryerjen e funksioneve të përcaktuara në nenin 22 dhe në ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të zbatueshme për depozituesit në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së.

6. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese lidhur me masat që duhen ndërmarrë nga depozituesi me qëllim përmbushjen e detyrave të tij në lidhje me SIKTT-në që administrohet nga një shoqëri administruese në një tjetër shtet anëtar, duke përfshirë të dhënat që duhet të përfshihen në marrëveshjen standarde që do të përdoret nga depozituesi dhe shoqëria administruese, në përputhje me paragrafin 5.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 24

Në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, depozituesi është përgjegjës kundrejt shoqërisë administruese dhe mbajtësve të kuotave për çdo humbje të pësuar prej tyre si rezultat i mospërmbushjes së pajustificueshme të detyrimeve nga ana e tij ose i realizimit jo të mirë të tyre.

Përgjegjësia kundrejt mbajtësve të kuotave mund të kryhet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nëpërmjet shoqërisë administruese, në varësi të natyrës ligjore të marrëdhënies ndërmjet depozitarit, shoqërisë administruese dhe mbajtësve të kuotave.

Neni 25

1. Asnjë shoqëri nuk mund të veprojë njëkohësisht si shoqëri administruese dhe si depozitues.
2. Në kontekstin e roleve të tyre përkatëse, shoqëria administruese dhe depozituesi veprojnë në mënyrë të pavarur dhe vetëm në interes të mbajtësve të kuotave.

Neni 26

Ligji ose rregullat e fondit përcaktojnë kushtet për zëvendësimin e shoqërisë administruese dhe të depozituesit dhe rregullat për të garantuar mbrojtjen e mbajtësve të kuotave në rast të një zëvendësimi të tillë.

KAPITULLI V DETYRIMET E SHOQËRIVE TË INVESTIMIT

SEKSIONI 1

Kushtet për nisjen e veprimtarisë tregtare

Neni 27

Aksesi në veprimtarinë e shoqërive të investimit është objekt i autorizimit paraprak që jepet nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit.

Shtetet anëtare përcaktojnë formën ligjore që duhet të marrë një shoqëri investimi.

Adresa e regjistruar e shoqërisë së investimit duhet të jetë në shtetin anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit.

Neni 28

Asnjë shoqëri investimi nuk mund të përfshihet në veprimtari të tjera përveç atyre të përmendura në Nenin 1, paragrafi 2.

Neni 29

1. Pa cenuar kushtet e tjera me zbatim të përgjithshëm të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit nuk i japin autorizim shoqërisë së investimit që nuk ka caktuar një shoqëri administruese, me përjashtim të rasteve kur shoqëria e investimit ka një kapital themeltar të mjaftueshëm prej të paktën 300 000 euro.

Gjithashtu, kur shoqëria e investimit nuk ka caktuar një shoqëri administruese të autorizuar sipas kësaj direktive, zbatohen kushtet e mëposhtme:

- (a) autorizimi jepet vetëm në rastet kur aplikimi për autorizim shoqërohet nga programi i operacioneve, ku jepet, minimalisht, struktura organizative e shoqërisë së investimit;
- (b) drejtorët e shoqërisë së investimit duhet të kenë reputacion mjaftueshëm të mirë dhe të kenë përvojë të mjaftueshme lidhur me llojin e veprimtarisë që ushtrohet nga shoqëria e investimit dhe për këtë arsye: emrat e drejtorëve dhe të çdo pasardhësi të tyre në detyrë duhet t'i komunikohet menjëherë autoriteteve kompetente; ushtrimi i veprimtarisë së një shoqërie investimi duhet të vendoset nga të paktën dy persona që përmbushin këto kushte; dhe "drejtorë" janë ato persona të cilët, sipas ligjit ose dokumenteve të themelimit, përfaqësojnë shoqërinë e investimit, apo që përcaktojnë plotësisht politikën e shoqërisë; dhe
- (c) në rastet kur ekzistojnë lidhje të ngushta ndërmjet shoqërisë së investimit dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, autoritetet kompetente duhet ta japin autorizimin vetëm nëse këto lidhje të ngushta nuk pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit e refuzojnë autorizimin edhe nëse ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të një vendi të tretë, të cilat rregullojnë një ose më shumë persona fizikë ose juridikë me të cilët shoqëria e investimit ka lidhje të ngushta ose kur vështirësitë në zbatimin e tyre, pengojnë ushtrimin me efikasitet të funksioneve të tyre mbikëqyrëse.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit i kërkojnë shoqërive të investimit që t'u japin informacionin që u nevojitet.

2. Në rastin kur shoqëria e investimit nuk ka caktuar një shoqëri administruese, ajo duhet të njoftohet brenda gjashtë muajve nga dorëzimi i aplikimit të plotë, nëse i është dhënë ose jo autorizimi. Në çdo rast të refuzimit të autorizimit, duhet të jepen edhe arsyet.

3. Shoqëria e investimit mund ta fillojë veprimtarinë menjëherë pasi jepet autorizimi.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë së investimit mund ta tërheqin autorizimin e dhënë për një shoqëri investimi që është objekt i kësaj direktive, vetëm në rastet kur kjo shoqëri:

- (a) nuk e përdor autorizimin brenda 12 muajve, e refuzon shprehimisht autorizimin ose nuk e ushtron më veprimtarinë e mbuluar nga kjo direktive për më shumë se gjashtë muaj, me përjashtim të rasteve kur shteti anëtar përkatës nuk ka parashikuar mbarimin e afatit të autorizimit në këto raste;
- (b) e ka marrë autorizimin duke bërë deklaratë të rreme ose nëpërmjet çdo mjeti tjetër të parregullt;
- (c) nuk i përmbush më kushtet në bazë të të cilave është dhënë autorizimi;
- (d) ka kryer shkelje të rëndë ose të përsëritur të dispozitave të miratuara sipas kësaj direktive; ose
- (e) është një prej atyre rasteve në të cilat legjislacioni i brendshëm parashikon tërheqje.

SEKSIONI 2

Kushtet e funksionimit

Neni 30

Nenet 13 dhe 14 zbatohen *mutatis mutandis* për shoqëritë e investimit që nuk kanë caktuar një shoqëri administrimi të autorizuar sipas kësaj direktive.

Për qëllime të neneve të përmendura në paragrafin e parë, "shoqëria administruese" është "shoqëria e investimit".

Shoqëritë e investimit administrojnë vetëm asetet e portofolit të tyre dhe në asnjë rrethanë nuk marrin mandat për të administruar asete për llogari të palëve të treta.

Neni 31

Shtetet anëtare të shoqërive të investimit duhet të hartojnë rregulla të kujdesshme, që duhet të respektohen në çdo kohë nga shoqëritë e investimit, që nuk kanë caktuar një shoqëri administrimi të autorizuar sipas kësaj direktive.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit, duke pasur parasysh natyrën e shoqërisë së investimit, kërkojnë që shoqëria të ketë procedura të forta administrative dhe kontabiliteti, masa kontrolli dhe mbrojtjeje për përpunimin e të dhënave elektronike dhe mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm duke përfshirë, sidomos, rregullat për transaksionet personale nga punonjësit e saj ose për zotërimin ose administrimin e investimeve në instrumente financiare me qëllim investimin e kapitalit të saj themeltar dhe garantimin, që të paktën, çdo transaksion që përfshin shoqërinë të mund të rindërtohet sipas origjinës së tij, palëve në të, natyrës, kohës dhe vendit ku është kryer dhe që asetet e shoqërisë së

investimit të jenë investuar në përputhje me dokumentet e themelimit dhe dispozitat ligjore në fuqi.

SEKSIONI 3

Detyrimet për Depozituesin

Neni 32

1. Asetet e një shoqërie investimi i besohen një depozituesi për ruajtje.
2. Depozituesi mbetet po njësoj përgjegjës, siç përmendet në nenin 34, edhe nëse ia beson një pale të tretë të gjitha ose një pjesë të aseteve që ka në ruajtje.
3. Depozituesi garanton si më poshtë:
 - (a) që shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave nga ose për llogari të një shoqërie investimi, të kryhet në përputhje me ligjin dhe me dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit;
 - (b) që në transaksionet që përfshijnë asetet e shoqërisë së investimit çdo kërkesë t'i përcillet atij brenda afateve kohore të zakonshme; dhe
 - (c) që të ardhurat e shoqërisë së investimit të përdoren në përputhje me ligjin dhe dokumentet e saj të themelimit.
4. Shteti anëtar i origjinës së shoqërisë së investimit mund të vendosë që shoqërive të investimit të themeluara në territorin e tij, të cilat i marketojnë kuotat e tyre nëpërmjet një ose më shumë bursave ku kuotat e tyre pranohen në listimin zyrtar, të mos jenë të detyruara të kenë depozitarë, brenda kuptimit të kësaj direktive.

Nenet 76, 84 dhe 85 nuk zbatohen për këto shoqëri investimit. Sidoqoftë, rregullat për vlerësimin e aseteve të këtyre shoqërive të investimit parashtrihen në legjislacionin e brendshëm të zbatueshëm ose në dokumentet e tyre të themelimit.

5. Shteti anëtar i origjinës së shoqërisë së investimit mund të vendosë që shoqërive të investimit të themeluara në territorin e tij, të cilat i marketojnë të paktën 80% të kuotave të tyre nëpërmjet një ose më shumë bursave të përcaktuara në dokumentet e tyre të themelimit, të mos jenë të detyruara të kenë depozitues, në kuptim të kësaj direktive, me kusht që kuotat e tyre të jenë pranuar në listimin zyrtar në bursën e atyre shteteve anëtare brenda territorit të të cilave marketohen kuotat dhe që çdo transaksion që mund të ekzekutohet nga shoqëria e investimit jashtë bursës të kryhet vetëm me çmimin e bursës.

Në dokumentet e themelimit të një shoqërie investimi duhet të specifikohen çmimet në bursë në vendin e marketimit, mbi të cilat do të përcaktohen çmimet me të cilat kjo shoqëri investimit do të kryejë çdo transaksion jashtë bursës në atë shtet.

Shteti anëtar e përdor derogimin e parashikuar në nënparagrafin e parë vetëm nëse gjykon se mbajtësit e kuotave kanë mbrojtje të barasvlershme me atë të mbajtësve të kuotave në SIKTT-të që kanë depozitues, në kuptim të kësaj direktive.

Shoqëritë e investimit të përmendura në këtë paragraf dhe në paragrafin 4, duhet që në veçanti:

- (a) të cilësojnë në dokumentet e tyre të themelimit metodat e përlllogaritjes së vlerës neto të aseteve të kuotave të tyre, në mungesë të legjislacionit të brendshëm për këtë qëllim;
- (b) të ndërhyjnë në treg për të shmangur që vlerat në bursë të kuotave të tyre të devijojnë me më shumë se sa 5% nga vlerat neto të aseteve të tyre;
- (c) të përcaktojnë vlerat neto të aseteve të kuotave të tyre, t'ua komunikojnë autoriteteve kompetente të paktën dy herë në javë dhe t'i publikojnë dy herë në muaj.

Të paktën dy herë në muaj një ekspert kontabël i jashtëm duhet të garantojë që përlllogaritja e vlerës së kuotave është kryer në përputhje me ligjin dhe dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit.

Në këto raste, eksperti kontabël garanton se asetet e shoqërisë së investimit janë investuar në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji dhe dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit.

6. Shtetet anëtare informojnë Komisionin mbi identitetet e shoqërive të investimit të cilat përfitojnë nga derogimet e parashikuara në paragrafët 4 dhe 5.

Neni 33

1. Depozituesi duhet ose të ketë adresën e regjistruar ose të jetë themeluar në të njëjtin shtet anëtar me shoqërinë e investimit.
2. Depozituesi është një institucion, i cili është objekt i rregullores së kujdesshme dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme.
3. Shtetet anëtare vendosin se cilat prej kategorive të institucioneve, të përmendura në paragrafin 2, janë të përshtatshme për të qenë depozitues.
4. Depozituesi u mundëson autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së të marrin, me kërkesë të tyre, të gjithë informacionin që depozituesi ka përfutur gjatë realizimit të detyrave të tij dhe që i nevojitet autoriteteve kompetente për të mbikëqyrur pajtueshmërinë e SIKTT-së me këtë direktivë.
5. Në rastin kur shteti anëtar i origjinës së shoqërisë administruese nuk është shteti anëtar i origjinës i SIKTT-së, depozituesi nënshkruan një marrëveshje me shkrim me shoqërinë administruese, për të rregulluar qarkullimin e informacionit që gjykohet si i nevojshëm për t'i mundësuar atij kryerjen e funksioneve të përcaktuara në nenin 32 dhe në ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të zbatueshme për depozituesit në shtetin anëtar të origjinës të SIKTT-së.

6. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese lidhur me masat që duhen ndërmarrë nga depozituesi me qëllim përmbushjen e detyrave të tij në lidhje me SIKTT-në që administrohet nga një shoqëri administruese në një tjetër shtet anëtar, duke përfshirë të dhënat që duhet të përfshihen në marrëveshjen standarde që do të përdoret nga depozituesi dhe shoqëria administruese, në përputhje me paragrafin 5.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 34

Në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë së investimit, depozituesi është përgjegjës kundrejt shoqërisë së investimit dhe mbajtësve të kuotave për çdo humbje të pësuar prej tyre si rezultat i mospërmbushjes së pajustificueshme të detyrimeve nga ana e tij ose i realizimit jo të mirë të tyre.

Neni 35

1. Asnjë shoqëri nuk mund të veprojë njëkohësisht si shoqëri investimit dhe si depozitar.
2. Gjatë ushtrimit të rolit të tij si depozitues, ky i fundit vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave.

Neni 36

Ligji ose dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit përcaktojnë rregullat për zëvendësimin e depozituesit dhe rregullat për të garantuar mbrojtjen e mbajtësve të kuotave në rast të një zëvendësimi të tillë.

KAPITULLI VI BASHKIMI I SIKTT-ve

SEKSIONI 1

Parimi, autorizimi dhe miratimi

Neni 37

Për qëllime të këtij Kapitulli, SIKTT-ja përfshin edhe divizionet e saj të investimit.

Neni 38

1. Në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Kapitull dhe pavarësisht mënyrës në të cilën krijohen SIKTT-të, sipas nenit 1, paragrafi 3, shtetet anëtare duhet të lejojnë bashkimet ndërkufitare dhe të brendshme, të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1, germa (q) dhe (r), në

përputhje me një ose më shumë nga teknikat e bashkimit, të parashikuara në nenin 2 paragrafi 1, germa (p).

2. Teknikat e bashkimit që janë përdorur për bashkimet ndërkufitare, të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1 germa (q) duhet të parashikohen në ligjet e shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese.

Teknikat e bashkimit që janë përdorur për bashkimet e brendshme, të përcaktuara në nenin 2, paragrafi 1, germa (r), duhet të parashikohen në ligjet e shtetit anëtar në të cilin janë themeluar SIKTT-të.

Neni 39

1. Bashkimet janë objekt i autorizimit paraprak nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së bashkuese.

2. SIKTT-ja bashkuese i jep autoriteteve kompetente të shtetit të saj anëtar të origjinës, informacionet e mëposhtme:

(a) draftin e përbashkët të kushteve të bashkimit të propozuar, të miratuar sipas rregullave, nga SIKTT-ja bashkuese dhe SIKTT-ja përfituese;

(b) një version të përditësuar të prospektit dhe informacionin kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78, të SIKTT-së përfituese, nëse është themeluar në një tjetër shtet anëtar;

(c) një deklaratë nga secili prej depozitarëve të SIKTT-së bashkuese dhe përfituese, që konfirmon se, në përputhje me nenin 41, ato e kanë verifikuar pajtueshmërinë e të dhënave, të parashtruara në gerrat (a), (f) dhe (g) të nenit 40, paragrafi 1, me kërkesat e kësaj direktive dhe rregullat e fondit, si dhe me dokumentet e themelimit të SIKTT-ve të tyre përkatëse; dhe

(d) informacionin mbi bashkimin e propozuar, që SIKTT-ja bashkuese dhe përfituese synojnë t'u japin përkatësisht mbajtësve të tyre të kuotave.

Ky informacion do të jepet në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese dhe përfituese të mund ta lexojnë në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të atij shteti anëtar ose të atyre shteteve anëtare, ose në gjuhën e miratuar nga ato autoritete kompetente.

3. Pasi të jetë plotësuar dosja, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së bashkuese ia përcjellin menjëherë kopjet e informacionit të përmendur në paragrafin 2, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së përfituese. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së bashkuese dhe përfituese, përkatësisht, duhet të marrin në konsideratë ndikimin e mundshëm të bashkimit të propozuar mbi mbajtësit e kuotave të SIKTT-së përfituese dhe bashkuese, për të vlerësuar nëse mbajtësve të kuotave po u jepet informacioni i duhur.

Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese e gjykojnë të nevojshme, ato mund të bëjnë kërkesë me shkrim, për sqarimin e informacionit që u jepet mbajtësve të kuotave të SIKTT-së bashkuese.

Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së e gjykojnë të nevojshme, ato mund t'i kërkojnë SIKTT-së përfituese me shkrim dhe jo më vonë se sa 15 ditë pune nga marrja e kopjeve të informacionit të plotë të përmendur në paragrafin 2, që të ndryshojnë informacionin që do t'u jepet mbajtësve të kuotave.

Në këtë rast, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së përfituese duhet t'i shprehin pakënaqësinë e tyre autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së bashkuese. Ato duhet të njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së bashkuese nëse janë apo jo të kënaqur me informacionin e ndryshuar që do t'u jepet mbajtësve të kuotave të SIKTT-së përfituese, brenda 20 ditëve pune pasi u është dhënë ky informacion.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese e autorizojnë bashkimin e propozuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

- (a) bashkimi i propozuar është në përputhje me të gjitha kërkesat e neneve 39 deri në 42;
- (b) SIKTT-ja përfituese është njoftuar, në përputhje me nenin 93, për t'i marketuar kuotat e saj në të gjitha shtetet anëtare ku SIKTT-ja bashkuese është e autorizuar ose është njoftuar që të marketojë kuotat e saj në përputhje me nenin 93; dhe
- (c) autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese dhe përfituese janë të kënaqura me informacionin që propozohet t'u jepet mbajtësve të kuotave ose autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së përfituese nuk kanë shprehur asnjë pakënaqësi, sipas nënparagrafit të katërt të paragrafit 3.

5. Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese e gjykojnë se dosja nuk është e plotë, ato kërkojnë informacione shtesë brenda 10 ditëve pune nga marrja e informacionit, të përmendur në paragrafin 2.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese njoftojnë SIKTT-në bashkuese brenda 20 ditëve pune nga dorëzimi i informacionit të plotë, në përputhje me paragrafin 2, nëse është autorizuar ose jo bashkimi.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese duhet të njoftojnë edhe autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së përfituese, lidhur me vendimin e tyre.

6. Shtetet anëtare, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit, 57 paragrafi 1, mund të parashikojnë një derogim nga nenet 52 deri në 55 për SIKTT-në përfituese.

Neni 40

1. Shtetet anëtare i kërkojnë SIKTT-së bashkuese dhe asaj përfituese të hartojnë një draft të përbashkët të kushteve të bashkimit.

Në draftin e përbashkët të kushteve të bashkimit përcaktohen elementet e mëposhtme:

- (a) identifikimi i llojit të bashkimit dhe i SIKTT-së së përfshirë;
- (b) informacione dhe argumente për bashkimin e propozuar;
- (c) ndikimi i pritshëm i bashkimit të propozuar te mbajtësit e kuotave të SIKTT-së bashkuese dhe asaj përfituese;
- (d) kriteret e miratuara për vlerësimin e aktiveve dhe të pasiveve, kur ka, në datën parashikuar për llogaritjen e normës së këmbimit, të përmendur në nenin 47 paragrafi 1;
- (e) metodën e llogaritjes së normës së këmbimit;
- (f) datën e planifikuar për hyrjen në fuqi të bashkimit;
- (g) rregullat e zbatueshme përkatëse për transferimin e aseteve dhe shkëmbimin e kuotave; dhe
- (h) në rastin e bashkimit sipas germës (p) pika (ii) të nenit 2, paragrafi 1 dhe, sipas rastit, germës (p) pikës (iii) të nenit 2, paragrafi 1, rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të SIKTT-së përfituese të sapokrijuar.

Autoritetet kompetente nuk kërkojnë përfshirjen e ndonjë informacioni shtesë në draftin e përbashkët të kushteve të bashkimit.

2. SIKTT-ja bashkuese dhe SIKTT-ja përfituese mund të vendosin që të përfshijnë elemente të tjera në draftin e përbashkët të kushteve të bashkimit.

SEKSIONI 2

Kontrolli nga palë të treta, informacioni i mbajtësve të kuotave dhe të drejta të tjera të mbajtësve të kuotave

Neni 41

Shtetet anëtare i kërkojnë depozitarëve të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese që të verifikojnë përputhshmërinë e elementeve të parashikuara në germet (a), (f) dhe (g) të nenit 40, paragrafi 1, me kërkesat e kësaj direktive, rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të SIKTT-ve përkatëse të tyre.

Neni 42

1. Legjislacioni i shteteve anëtare të origjinës të SIKTT-ve i beson një depozituesi ose një ekspertit kontabël të jashtëm, të miratuar në përputhje me Direktivën 2006/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 17 Majit 2006, për auditimet ligjore të llogarive vjetore dhe llogarive të konsoliduara⁽¹³⁾, që të verifikojë:

- (a) kriteret e miratuara për vlerësimin e aktiveve dhe të pasiveve, nëse ka, në datën parashikuar për llogaritjen e normës së këmbimit, të përmendur në nenin 47 paragrafi 1;

- (b) sipas rastit, pagesën në para për kuotë; dhe
 - (c) metodën e llogaritjes së normës së këmbimit, si dhe të normës aktuale të këmbimit, të përcaktuar në datën e parashikuar për llogaritjen së saj, siç përmendet në nenin 47, paragrafi 1.
2. Për qëllimet e paragrafit 1, eksperti kontabël i SIKTT-së bashkuese ose eksperti kontabël i SIKTT-së përfituese konsiderohen si ekspertë kontabël të jashtëm.
 3. Një kopje e raporteve të ekspertëve kontabël të jashtëm ose e depozituesit, sipas rastit, i vihet në dispozicion, sipas kërkesës dhe falas, mbajtësve të kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese dhe autoriteteve të tyre kompetente.

Neni 43

1. Shtetet anëtare i kërkojnë SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese që t'u japin mbajtësve të kuotave të tyre informacion të përshtatshëm e të saktë mbi bashkimin e propozuar, me qëllimin për t'u mundësuar atyre marrjen e një vendimi të informuara në lidhje me ndikimin e propozimit në investimin e tyre.

2. Ky informacion i jepet mbajtësve të kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese vetëm pas miratimit të bashkimit të propozuar, në zbatim të nenit 39, nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së bashkuese.

Ai jepet të paktën 30 ditë përpara datës së fundit për bërjen e kërkesës për riblerje ose shlyerje ose, sipas rastit, për shndërrimin pa kosto shtesë, sipas nenit 45, paragrafi 1.

3. Informacioni që duhet t'i jepet mbajtësve të kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese përfshin informacion të përshtatshëm e të saktë mbi bashkimin e propozuar, me qëllimin për t'u mundësuar atyre marrjen e një vendimi të informuar lidhur me ndikimin e mundshëm të tij në investimin e tyre dhe ushtrimin e të drejtave që gëzojnë, sipas neneve 44 dhe 45.

Ai përfshin sa më poshtë:

- (a) informacionet dhe argumentet për bashkimin e propozuar;
- (b) ndikimin e mundshëm të bashkimit të propozuar te mbajtësit e kuotave, duke përfshirë por pa u kufizuar me ndonjë ndryshim material në lidhje me politikën dhe strategjinë e investimit, kostot, rezultatin e pritshëm, raportimin periodik, reduktimin e mundshëm të performancës dhe, sipas rastit, një paralajmërim të qartë për investitorët mbi mundësinë e ndryshimit të trajtimit tatimor të tyre pas bashkimit;
- (c) çdo të drejtë specifike që kanë mbajtësit e kuotave në lidhje me bashkimin e propozuar, duke përfshirë por pa u kufizuar me të drejtën për të marrë informacion shtesë, të drejtën për të marrë, sipas kërkesës, një kopje të raportit të ekspertit kontabël të jashtëm dhe të drejtën për të kërkuar riblerjen ose shlyerjen ose, sipas rastit, shndërrimin e kuotave të tyre pa asnjë kosto, siç përcaktohet në nenin 45, paragrafi 1, si dhe datën e fundit për ushtrimin e kësaj të drejte;

- (d) aspektet procedurale përkatëse dhe datën kur është planifikuar të hyjë në fuqi bashkimi; dhe
- (e) një kopje të informacionit kryesor për investitorët të SIKTT-së përfituese, siç përmendet në nenin 78.

4. Nëse SIKTT-ja bashkuese ose përfituese është njoftuar në përputhje me nenin 93, informacioni i përmendur në paragrafin 3, duhet të jepet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së përkatëse ose në gjuhën e miratuar nga autoritet e tij kompetente. SIKTT-ja që duhet të japë informacionin, është përgjegjëse edhe për përkthimin e tij. Përkthimi duhet të pasqyrojë me përpikëri përmbajtjen e dokumentit origjinal.

5. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për të specifikuar në detaje përmbajtjen, formatin dhe mënyrën e dhënies së informacionit, të përmendur në paragrafët 1 dhe 3.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 44

Kur legjislacionet kombëtare të shteteve anëtare parashikojnë që bashkimet ndërmjet SIKTT-ve të miratohen nga mbajtësit e kuotave, shtetet anëtare në fjalë garantojnë që për këtë miratim të mos nevojiten më shumë se 75% të votave të hedhura nga mbajtësit e kuotave që janë të pranishëm, ose nga përfaqësuesit e tyre, në mbledhjen e përgjithshme të mbajtësve të kuotave.

Paragrafi i parë nuk cënon kuorumet, të parashikuara në legjislacionet kombëtare. Shtetet anëtare nuk duhet të vendosin kërkesa më rrepta për kuorumet për bashkimet ndërkufitare nga ato që kanë për kuorumet për bashkimet e brendshme, dhe as të vendosin kërkesa më të rrepta për kuorumet për SIKTT-të bashkuese nga ato që kanë për bashkimet e korporatave.

Neni 45

1. Legjislacionet e shteteve anëtare parashikojnë që mbajtësit e kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese të gëzojnë të drejtën për të kërkuar, pa asnjë tarifë tjetër përveç asaj që mbahet nga SIKTT-të për mbulimin e kostove të tërheqjes së investimit, riblerjen ose shlyerjen e kuotave të tyre ose, sipas rastit, shndërrimin e tyre në kuota në SIKTT të tjera me politika të njëjta investimi dhe të administruara nga e njëjta shoqëri administruese ose nga ndonjë shoqëri tjetër e lidhur me shoqërinë administruese, nëpërmjet administrimit ose kontrollit të përbashkët, ose nga një pjesëmarrje e konsiderueshme, e drejtpërdrejtë ose e tërthortë. Kjo e drejtë hyn në fuqi nga momenti që mbajtësit e kuotave të SIKTT-ve bashkuese dhe përfituese, njoftohen për bashkimin e propozuar, në përputhje me nenin 43, dhe pushon së ekzistuari pesë ditë pune përpara datës së parashikuar për llogaritjen e normës së këmbimit, të përmendur në nenin 47, paragrafi 1.

2. Pa cënuar paragrafin 1, për bashkimet ndërmjet SIKTT-ve bashkuese dhe duke deroguar nga neni 84, paragrafi 1, shtetet anëtare mund t'i lejojnë autoritetet kompetente që të kërkojnë ose të

lejojnë pezullimin e përkohshëm të nënshkrimit, riblerjes ose shlyerjes së kuotave, me kusht që ky pezullim të justifikohet për arsye të mbajtësve të kuotave.

SEKSIONI 3

Kostot dhe hyrja në fuqi

Neni 46

Përveç rasteve kur SIKTT-të nuk kanë caktuar një shoqëri administruese, shtetet anëtare garantojnë që të gjitha kostot ligjore, të këshillimit ose ato administrative që lidhen me përgatitjen dhe realizimin e bashkimit, të mos i ngarkohen SIKTT-së bashkuese, SIKTT-së përfituese apo ndonjërit prej mbajtësve të kuotave të saj.

Neni 47

1. Për sa u përket bashkimeve të brendshme, legjislacionet e shteteve anëtare përcaktojnë datën e hyrjes në fuqi të bashkimit, si dhe datën e parashikuar për llogaritjen e normës së këmbimit të kuotave të SIKTT-së bashkuese në kuota të SIKTT-së përfituese dhe, sipas rastit, për përcaktimin e vlerës neto të aseteve për pagesa në para.

Për sa u përket bashkimeve ndërkufitare, këto data përcaktohen nga legjislacionet e shteteve anëtare të origjinës të SIKTT-ve përfituese. Shtetet anëtare garantojnë që këto data, kur është e mundur, të përkojnë me periudhën pas miratimit të bashkimit nga mbajtësit e kuotave të SIKTT-së përfituese ose SIKTT-së bashkuese.

2. Hyrja në fuqi e bashkimit bëhet publike nëpërmjet të gjitha mjeteve të përshtatshme, në mënyrën e parashikuar në legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së përfituese, dhe i bëhet e ditur autoriteteve kompetente të shteteve anëtare të origjinës të SIKTT-ve përfituese dhe bashkuese.

3. Bashkimet që kanë hyrë në fuqi sipas parashikimit në paragrafin 1, nuk mund të shpallen të pavlefshme.

Neni 48

1. Bashkimet e kryera në përputhje me germën (p) pika (i) të nenit 2, paragrafi 1, kanë pasojat e mëposhtme:

- (a) të gjitha aktivet dhe pasivet e SIKTT-së bashkuese i transferohen SIKTT-së përfituese ose, sipas rastit, depozitarit të SIKTT-së përfituese;
- (b) mbajtësit e kuotave të SIKTT-së bashkuese bëhen mbajtës të kuotave të SIKTT-së përfituese dhe, sipas rastit, gëzojnë të drejtën e një pagese në para që nuk e kalon 10% të vlerës neto të aseteve të kuotave të tyre në SIKTT-në bashkuese; dhe
- (c) pas hyrjes në fuqi të bashkimit, SIKTT-ja bashkuese nuk ekziston më.

2. Bashkimet e kryera në përputhje me germën (p) pika (ii) të nenit 2, paragrafi 1, kanë pasojat e mëposhtme:

- (a) të gjitha aktivet dhe pasivet e SIKTT-së bashkuese i transferohen SIKTT-së përfituese të sapokrijuar ose, sipas rastit, depozitarit të kësaj të fundit;
- (b) mbajtësit e kuotave të SIKTT-së bashkuese bëhen mbajtës të kuotave të SIKTT-së përfituese të sapokrijuar dhe, sipas rastit, gëzojnë të drejtën e një pagese në para që nuk e kalon 10% të vlerës neto të aseteve të kuotave të tyre në SIKTT-në bashkuese; dhe
- (c) pas hyrjes në fuqi të bashkimit, SIKTT-ja bashkuese nuk ekziston më.

3. Bashkimet e kryera në përputhje me germën (p) pika (iii) të nenit 2 paragrafi 1, kanë pasojat e mëposhtme:

- (a) asetet neto të SIKTT-së bashkuese i transferohen SIKTT-së përfituese ose, sipas rastit, depozitarit të SIKTT-së përfituese;
- (b) mbajtësit e kuotave të SIKTT-së bashkuese bëhen mbajtës të kuotave të SIKTT-së përfituese; dhe
- (c) SIKTT-ja bashkuese vazhdon të ekzistojë deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve.

4. Shtetet anëtare parashikojnë krijimin e një procedure nëpërmjet të cilës shoqëria administruese e SIKTT-së përfituese i konfirmon depozitarit të kësaj SIKTT-je se është kryer transferimi i aktiveve dhe i pasiveve, sipas rastit. Kur SIKTT-ja përfituese nuk ka caktuar një shoqëri administruese, ajo ia dërgon konfirmimin në fjalë depozitarit të SIKTT-së përfituese.

KAPITULLI VII

DETYRIMET PËR POLITIKAT E INVESTIMIT TË SIKTT-VE

Neni 49

Kur SIKTT-të përfshijnë më shumë se një divizion investimi, për qëllimet e këtij Kapitulli, secili prej tyre konsiderohet si SIKTT e veçantë.

Neni 50

1. Investimet e një SIKTT-je përfshijnë një ose më shumë nga sa vijon:

- (a) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë, të pranuar ose të tregtuara në një treg të rregulluar, sipas përcaktimit në nenin 4, paragrafi 1 pika 14 të Direktivës 2004/39/KE;
- (b) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë të tregtuara në një treg tjetër të rregulluar të një shteti anëtar, i cili funksionon rregullisht dhe është i njohur e i hapur për publikun;
- (c) tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë të pranuar në listimet zyrtare në

bursën e një vendi të tretë ose të tregtuara në një treg tjetër të rregulluar të një vendi të tretë që funksion rregullisht dhe është i njohur e i hapur për publikun, me kusht që zgjedhja e bursës ose e tregut të jetë miratuar nga autoritetet kompetente ose të parashikohet në legjislacion, në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit;

(d) tituj të transferueshëm të emetuar së fundmi, me kusht që:

(i) kushtet e emetimit të përfshijnë garancinë se do të bëhet aplikimi për t'u pranuar në listimet zyrtare në bursë ose në një treg tjetër të rregulluar, i cili funksion rregullisht, është i njohur dhe i hapur për publikun, me kushtin që zgjedhja e bursës ose e tregut të jetë miratuar nga autoritetet kompetente ose të parashikohet në ligj ose në rregullat e fondit, apo në dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit; dhe

(ii) pranimi i përmendur në pikën (i) kryhet brenda vitit të emetimit;

(e) kuotat e SIKTT-ve të autorizuar sipas kësaj direktive ose sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive në kuptim të nenit 1, paragrafi 2, geramat (a) dhe (b), qofshin ato të themeluara ose jo në një shtet anëtar, me kusht që:

(i) këto sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive të autorizohen sipas ligjeve që parashikojnë se ato i nënshtrohen mbikëqyrjes që autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së e konsiderojnë si ekuivalente me mbikëqyrjen e parashikuar në legjislacionin e Komunitetit dhe që të garantohet nivel i mjaftueshëm bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve;

(ii) niveli i mbrojtjes për mbajtësit e kuotave në sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive të jetë i njëjtë me atë të parashikuar për mbajtësit e kuotave në një SIKTT dhe, në veçanti, që rregullat për ndarjen e aseteve, huamarrjen, huadhënien dhe shitjet e pambuluara të titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë të jenë të njëjta me kërkesat e kësaj direktive;

(iii) veprimtaria tregtare e sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të raportohet në raportin gjashtëmuor dhe në raportin vjetor, me qëllim që të mundësohet kryerja e vlerësimit të aktiveve dhe pasiveve, të të ardhurave dhe operacioneve gjatë periudhës së raportimit; dhe

(iv) sipas rregullave të fondit ose dokumenteve të themelimit, të mos jetë e mundur që në kuotat e SIKTT-ve ose sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të investohet më shumë se 10% (në total) e aseteve të SIKTT-ve apo sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të parashikuara për t'u blerë;

(f) depozita në institucione kreditimi, të cilat mund të shlyhen sipas kërkesës ose mund të tërhiqen dhe kanë afat maturimi jo më shumë se 12 muaj, me kusht që institucioni i kreditimit ta ketë selinë e tij në një shtet anëtar ose, nëse institucioni i kreditimit e ka selinë e tij në një vend të tretë, me kusht që t'i nënshtrohet rregullave të mirëmbenduara që autoritetet

kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-ve i konsiderojnë si ekuivalente me rregullat e parashikuara në legjislacionin e Komunitetit;

- (g) instrumente financiare derivative, duke përfshirë instrumentet ekuivalente të ofruara në të holla, që tregtohen në një treg të rregulluar të përmendur në pikat (a), (b) dhe (c) ose instrumentet financiare derivative që tregtohen në treg mbi banak, me kusht që:
- (i) në themel të derivativit të qëndrojnë instrumentet e mbuluara nga ky paragraf, indekset financiare, normat e interesit, kurset e këmbimit valutor ose valutat në të cilat mund të investojnë SIKTT-të, në përputhje me objektivat e tyre të investimit, të shprehura në rregullat e fondit ose në dokumentet e tyre të themelimit;
 - (ii) palët në transaksionet e derivativëve të tregtuar mbi banak, të jenë institucione që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe që i përkasin kategorive të miratuara nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së; dhe
 - (iii) derivativët e tregtuar mbi banak t'i nënshtrohen vlerësimit ditor të besueshëm dhe të verifikueshëm dhe të mund të shiten, likuidohen ose mbyllen në çdo kohë nga një transaksion kompensues në vlerën e tyre, me iniciativën e SIKTT-së; ose
- (h) instrumentet e tregut të parasë të ndryshme nga ato të tregtuara në një treg të rregulluar që përfshihen në nenin 2, paragrafi 1 germa (o), nëse emetimi apo emetuesi i këtyre instrumenteve është gjithashtu i rregulluar, me qëllim mbrojtjen e investitorëve dhe të kursimeve, me kushtin që:
- (i) të emetohen ose garantohen nga një autoritet qendror, rajonal ose vendor ose nga banka qendrore e një shteti anëtar, Banka Qendrore Evropiane, Komuniteti ose Banka Evropiane e Investimeve, nga një vend i tretë ose, në rastin e një shtetit federal, nga një prej anëtarëve që përbëjnë federatën ose nga një organizëm publik ndërkombëtar ku bëjnë pjesë një ose më shumë shtete anëtare;
 - (ii) të emetohen nga një sipërmarrje të gjithë titujt e të cilës tregtohen në tregjet e rregulluara të përmendura në pikat (a), (b) ose (c);
 - (iii) të emetohen ose garantohen nga një institucion duke iu nënshtuar mbikëqyrjes së kujdesshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga legjislacioni komunitar ose nga një institucion që i nënshtrohet dhe vepron në përputhje me rregullat e mirëmenduara që autoritetet kompetente i konsiderojnë se janë të paktën po aq shtrënguese sa ato të përcaktuara nga legjislacioni komunitar; ose

(iv) të emetohen nga organe të tjera të përfshira në kategoritë e miratuara nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, me kusht që investimet në instrumente të tilla t'i nënshtrohen të njëjtës mbrojtje për investitorët si ajo e parashikuar në pikat (i), (ii) ose (iii) dhe me kusht që emetuesi të jetë një shoqëri, kapitali dhe rezervat e së cilës arrijnë minimumi në 10 000 000 euro dhe e cila i paraqet dhe publikon llogaritë e saj vjetore në përputhje me Direktivën e Katërt të Këshillit 78/660/KEE të 25 Korrikut 1978, në bazë të nenit 54, paragrafi 3, germa (g) të Traktatit për llogaritë vjetore të disa lloje të caktuara shoqërisht (¹⁴), ose një subjekt i cili, brenda një grupi shoqërisht që përfshin një ose disa shoqëri të listuara, merret posaçërisht me financimin e grupit ose një subjekt që merret posaçërisht me financimin e mjeteve të vlerësimit që përfitojnë nga një linjë likuiditeti bankar.

2. Megjithatë, një SIKTT:

- (a) nuk investon më shumë se 10% të aseteve të saj në tituj të transferueshëm ose në instrumente të tregut të parasë, përveç atyre të përmendura në paragrafin 1; ose
- (b) nuk zotëron metale të çmuara ose certifikata që përfaqësojnë këto metale.

SIKTT-ja mund të zotërojë asete likuide për qëllime dytësore.

3. Një shoqëri investimi mund të blejë pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, të cilat janë thelbësore për ushtrimin e veprimtarisë së saj tregtare.

Neni 51

1. Një shoqëri administruese ose investimi përdor një proces menaxhimi për riskun që i mundëson asaj të monitorojë dhe vlerësojë në çdo kohë riskun e pozicioneve dhe kontributin e tyre në profilin e përgjithshëm të riskut të portofolit.

Ajo përdor një proces për vlerësimin e saktë dhe të pavarur të vlerës së derivativëve të tregtuar mbi banak.

Ajo komunikon rregullisht me autoritetet kompetente të vendit anëtar të origjinës mbi llojet e instrumenteve derivative, risqet përkatëse, kufijtë sasiore dhe metodat e zgjedhura për vlerësimin e risqeve të lidhura me transaksionet në instrumente derivative për secilën SIKTT të administruar.

2. Shtetet anëtare mund ta autorizojnë SIKTT-në që për titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të përdorë teknika dhe instrumente sipas kushteve dhe brenda kufijve të përcaktuar nga ato, me kusht që këto teknika dhe instrumente të përdoren për menaxhimin efikas të portofolit.

Në rastet kur këto operacione lidhen me përdorimin e instrumenteve derivative, kushtet dhe kufijtë duhet të jenë në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë direktivë.

Këto operacione nuk duhet të shkaktojnë në asnjë rrethanë shmangien nga ana e SIKTT-së, të objektivave të investimit të përcaktuara në rregullat e fondit, dokumentet e themelimin ose në prospekt.

3. Një SIKTT garanton që ekspozimi i saj global lidhur me instrumentet derivative të mos e kalojë vlerën totale neto të portofolit të saj.

Ekspozimi llogaritet duke marrë në konsideratë vlerën aktuale të asetëve përkatëse, riskun ndaj palës tjetër, lëvizjet e ardhshme në treg dhe kohën e disponueshme për likuidimin e pozicioneve. Kjo vlen edhe për nënparagrafin e tretë dhe të katërt.

Një SIKTT mund të investojë në instrumente financiare derivative, si pjesë të politikës së saj të investimit dhe brenda kufijve të përcaktuar në nenin 52, paragrafi 5, me kusht që totali i ekspozimit ndaj asetëve përkatëse të mos i kalojë kufijtë e investimit të përcaktuar në nenin 52. Në rastet kur një SIKTT investon në instrumente financiare derivative me bazë indeksi, shtetet anëtare mund të parashikojnë që të mos kërkohet kombinimi i këtyre investimeve për qëllime të kufijve të përcaktuar në nenin 52.

Kur titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parasë përfshijnë një derivativ, derivativi merret në konsideratë në përmbushjen e kërkesave të këtij neni.

4. Pa cenuar nenin 116, deri më 1 Korrik 2010, Komisioni do të miratojë masat zbatuese që specifikojnë:

- (a) kriteret e vlerësimit të përshtatshmërisë së procesit të menaxhimit të riskut të përdorur nga shoqëria administruese në përputhje me nënparagrafin e parë të paragrafit 1;
- (b) rregullat e hollësishme për vlerësimin e saktë dhe të pavarur të vlerës së derivativëve të tregtuar mbi bankë; dhe
- (c) rregullat e hollësishme për përmbajtjen dhe procedurën që duhet ndjekur për përcjelljen e informacionit, të përmendur në nënparagrafin e tretë të paragrafit 1, të autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të shoqërisë administruese.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 52

1. Një SIKTT nuk investon më shumë se:

- (a) 5% të asetëve të saj në titujt të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë të emetuara nga i njëjti organ; ose
- (b) 20% të asetëve të saj në depozita në të njëjtin institucion.

Ekspozimi ndaj rrezikut i një pale të SIKTT-së në një transaksion me instrumente derivative në një treg mbi bankë nuk duhet të tejkalojë:

(a) 10% të aseteve të saj, kur pala është një institucion kreditimi i përmendur në nenin 50, paragrafi 1, germa (f); ose

(b) 5% të aseteve të saj, në raste të tjera.

2. Shtetet anëtare mund ta rrisin kufirin prej 5%, të përcaktuar në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, maksimumi deri në 10%. Megjithatë, nëse e bëjnë diçka të tillë, vlera e përgjithshme e titujve të transferueshëm dhe instrumenteve të tregut të parasë që mban një SIKTT të disa emetues, ku për secilin ka investuar mbi 5% të aseteve të saj, nuk duhet ta kalojë 40% të vlerës së përgjithshme të aseteve. Ky kufizim nuk zbatohet për depozitat ose transaksionet derivative mbi banak të kryera me institucione financiare, që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme.

Pavarësisht kufijve të veçantë të përcaktuar në paragrafin 1, një SIKTT nuk duhet të kombinojë asnjë nga elementet e mëposhtme, në rast se një kombinim i tillë do të rezultonte në investimin e më shumë se 20% të aseteve të saj në një emetues të vetëm:

(a) investimet në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë të atij emetuesi;

(b) depozita me atë emetues; ose

(c) ekspozimet që lindin nga transaksionet derivative mbi banak të ndërmarra me atë emetues.

3. Shtetet anëtare mund të rrisin kufirin prej 5%, të parashikuar në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, maksimumi deri në 35%, në rastin e titujve të transferueshëm ose instrumenteve të tregut të parasë, të emetuara ose të garantuara nga autoritetet vendore të një shteti anëtar, vendeve të treta ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtete anëtare.

4. Shtetet anëtare mund të rrisin kufirin prej 5%, të parashikuar në nënparagrafin e parë të paragrafit 1, maksimumi deri në 25%, në rastin e obligacioneve të emetuara nga një institucion kreditimi, i cili e ka adresën e regjistruar në një shtet anëtar dhe, sipas ligjit, i nënshtrohet mbikëqyrjes së veçantë publike, të planifikuar enkas për mbrojtjen e mbajtësve të obligacioneve. Në përputhje me legjislacionin, shumat që rrjedhin nga emetimi i këtyre obligacioneve duhet të investohen veçanërisht në asete, të cilat mund të mbulojnë pretendimet në lidhje me obligacionet gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së këtyre të fundit dhe të cilat, në rastin e mospërbushjes së detyrimit nga emetuesi, mund të përdoren për rimbursimin e principalit dhe shlyerjen e interesit të llogaritur.

Kur një SIKTT investon më shumë se 5% të aseteve të saj në obligacionet e përmendura në nënparagrafin e parë, të emetuara nga një emetues i vetëm, atëherë vlera totale e këtij investimi nuk tejkalon 80% të vlerës totale të aseteve të kësaj SIKTT-je.

Shtetet anëtare i dërgojnë Komisionit listën e kategorive të obligacioneve të përmendura në nënparagrafin e parë dhe të kategorive të emetuesve të autorizuar, në përputhje me ligjet dhe masat mbikëqyrëse, të përmendura në këtë nënparagraf, për të emetuar obligacione në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë nen. Këtyre listave u bashkëngjitet njoftimi që specifikon

statusin e garancive të ofruara. Komisioni u përcjell menjëherë shteteve të tjera anëtare, këtë informacion dhe çdo koment që e gjykon si të përshtatshëm dhe i bën ato të disponueshme edhe për publikut. Këto komunikime mund të jenë objekt diskutimi, për ndarjen e këndvështrimeve të ndryshme, në Komitetin Evropian të Letrave me Vlerë, të përmendur në nenin 112, paragrafi 1.

5. Për titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë, të parashikuar në paragrafët 3 dhe 4, nuk zbatohet kufirit prej 40%, i përmendur në paragrafin 2.

Kufijtë e parashikuar në paragrafët 1 deri në 4 nuk mund të kombinohen, ndaj investimet në tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë të emetuara nga i njëjti emetues ose në depozita apo instrumente derivative të kryera në të njëjtin institucion (emetuesi), në përputhje me paragrafët 1 deri në 4, nuk kalojnë 35% të vlerës totale të aseteve të SIKTT-së.

Për të llogaritur kufijtë e parashikuar në këtë nen, shoqëritë e përfshira në të njëjtin grup për qëllime të llogarive të konsoliduara, sipas përcaktimit në Direktivën 83/349/KEE ose në përputhje me rregullat e kontabilitetit të njohura ndërkombëtarisht, konsiderohen si një emetues i vetëm.

Shtetet anëtare mund të lejojnë investime kumulative në tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut të parasë deri në një kufi 20%, brenda të njëjtit grup.

Neni 53

1. Pa cenuar kufijtë e parashtruar në enin 56, shtetet anëtare mund t'i rrisin deri në 20% kufijtë, e përcaktuar në nenin 52, për investimet në aksione ose instrumente borxhi të emetuara nga i njëjti emetues kur, sipas rregullave të fondit ose dokumenteve të themelimit, objektivi i politikës së investimit të SIKTT-së është replikimi i një indeksi aksionesh ose indeksi instrumentesh borxhi, i cili njihet nga autoritetet kompetente, në bazë të sa vijon:

- (a) përbërja e tij është mjaft e larmishme;
- (b) indeksi përfaqëson një pikë të përshtatshme referimi për tregun të cilit i referohet; dhe
- (c) është publikuar siç duhet.

2. Shtetet anëtare mund ta rrisin kufirin e përcaktuar në paragrafin 1 maksimumi deri në 35%, në rastet kur ky veprim justifikohet nga kushte të veçanta tregtare, në veçanti në tregje të rregulluara ku dominojnë ndjeshëm disa tituj të transferueshëm apo instrumente të tregut të parasë. Investimi deri në këtë kufi lejohet vetëm për një emetues të vetëm.

Neni 54

1. Duke deroguar nga neni 52, shtetet anëtare mund t'i autorizojnë SIKTT-të që të investojnë, në përputhje me parimin e shpërndarjes së riskut, deri në 100% të aseteve të tyre në instrumente të tregut të parasë dhe tituj të transferueshëm, të emetuara ose të garantuara nga autoritetet vendore të një shteti anëtar, vendeve të treta ose nga organizma publikë ndërkombëtarë, në të cilët bëjnë pjesë një ose më shumë shtetet anëtare.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së e lejojnë këtë derogim vetëm nëse gjykojnë se mbajtësit e kuotave në SIKTT kanë mbrojtje të njëjtë me atë të mbajtësve të kuotave në SIKTT-të që zbatojnë kufijtë e përcaktuar në nenin 52.

Këto SIKTT mbajnë tituj nga të paktën gjashtë emetues të ndryshëm, por titujt nga një emetues i vetëm nuk duhet të përbëjnë më shumë se 30% të totalit të aseteve.

2. SIKTT-ja, e parashikuar në paragrafin 1, duhet të përmend shprehimisht në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit, shtetet anëtare, autoritetet vendore ose organizmat publikë ndërkombëtarë që emetojnë ose garantojnë tituj në të cilët ato synojnë të investojnë më shumë se 35% të aseteve të tyre.

Rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit miratohen nga autoritetet kompetente.

3. Çdo SIKTT e përmendur në paragrafin 1 përfshin në prospektin e saj dhe në komunikimet e marketimit, një deklaratë të qartë, ku trajtohet autorizimi në fjalë dhe përmenden shtetet anëtare, autoritetet vendore ose organizmat publikë ndërkombëtarë në titujt e të cilëve SIKTT-ja synon të investojë ose ka investuar më shumë se 35% të aseteve të saj.

Neni 55

1. Një SIKTT mund t'i blejë kuotat e SIKTT-ve ose të sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive, të përmendura në nenin 50, paragrafi 1, germa (e), me kusht që në kuotat e një SIKTT-je apo një sipërmarrjeje investimesh kolektive të mos jenë investuar më shumë se 10% e totalit të aseteve të saj. Shtetet anëtare mund ta rrisin këtë kufi maksimumi deri në 20%.

2. Totali i investimeve të kryera në kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive, të ndryshme nga SIKTT-të, nuk duhet të kalojë 30% të aseteve të SIKTT-ve.

Në rastet kur një SIKTT ka blerë kuota nga një tjetër SIKTT ose sipërmarrje investimesh kolektive, shtetet anëtare mund të parashikojnë heqjen e detyrimit për kombinimin e aseteve të SIKTT-së ose sipërmarrjes së investimeve kolektive në fjalë, për qëllime të kufijve të përcaktuar në nenin 52.

3. Kur një SIKTT investon në kuotat e SIKTT-ve ose sipërmarrjeve të tjera të investimeve kolektive të administruara, drejtpërdrejt ose me delegim, nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një shoqëri tjetër e lidhur me shoqërinë administruese nëpërmjet administrimit ose kontrollit të përbashkët apo pjesëmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shoqëria administruese apo shoqëria tjetër në fjalë nuk caktojnë tarifa nënshkrimi ose shlyerjeje për investimet e SIKTT-së në kuotat e këtyre SIKTT-ve të tjera apo të sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Një USIKTT që investon një përqindje të konsiderueshme të aseteve të saj në SIKTT apo sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive, tregon në prospektin e saj nivelin maksimal të tarifave të administrimit, që mund t'i faturohen vetë asaj, si dhe SIKTT-ve ose sipërmarrjeve të investimeve kolektive të tjera ku ajo synon të investojë. Ajo paraqet në raportin e saj vjetor

vlerën maksimale të tarifave të administrimit të vendosura për vetë SIKTT-në, si dhe për SIKTT-të ose sipërmarrjet e tjera të investimeve kolektive ku ajo investon.

Neni 56

1. Një shoqëri investimi apo administruese që vepron për të gjitha fondet e përbashkëta që administrojnë dhe që përfshihen në fushën e zbatimit të kësaj direktive, nuk mund të blejë aksione duke zotëruar të drejta votimi që mund t'i mundësojnë asaj ushtrimin e një ndikimi kontrollues mbi administrimin e një emetuesi.

Në pritje të koordinimit të mëtejshëm, shtetet anëtare marrin në konsideratë rregullat ekzistuese në legjislacionet e shteteve të tjera anëtare ku përcaktohet parimi i dhënë në nënparagrafin e parë.

2. Një SIKTT nuk mund të blejë më shumë se:

- (a) 10% të aksioneve pa të drejtë vote të një emetuesi të vetëm;
- (b) 10% të instrumenteve të borxhit të një emetuesi të vetëm;
- (c) 25% të kuotave të një SIKTT-je të vetme ose të një sipërmarrjeje tjetër investimesh kolektive, në kuptim të nenit 1, paragrafi 2, gjerat (a) dhe (b); ose
- (d) 10% të instrumenteve të tregut të parasë të një emetuesi të vetëm.

Nëse në kohën e blerjes është e pamundur të llogaritet vlera bruto e instrumenteve të borxhit ose e instrumenteve të tregut të parasë apo vlera neto e titujve në emetim, kufijtë e përcaktuar në gjerat (b), (c) dhe (d) mund të mos merren parasysh.

3. Një shtet anëtar mund të mos i zbatojë paragrafët 1 dhe 2 për:

- (a) titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të emetuara ose të garantuara nga një shtet anëtar ose autoritetet e tij vendore;
- (b) titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të emetuara ose të garantuara nga një vend i tretë;
- (c) titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut të parasë të emetuara nga një organizëm publik ndërkombëtar ku bëjnë pjesë një ose më shumë shtete anëtare;
- (d) aksionet e mbajtura nga një SIKTT në kapitalin e një shoqërie të themeluar në një vend të tretë, e cila investon asetet e saj kryesisht në titujt e emetuesve me adresë të regjistruar në këtë vend kur, sipas legjislacionit të këtij vendi, mbajtja e tyre përbën mënyrën e vetme në të cilën SIKTT-ja mund të investojë në titujt e emetuesve të këtij vendi; ose
- (e) aksionet e mbajtura nga një ose më shumë shoqëri investimesh në kapitalin e filialeve, të cilat në vendin ku janë themeluar ushtrojnë vetëm veprimtarinë e administrimit, këshillimit ose marketimit në lidhje me riblerjen e kuotave me kërkesë të vetë mbajtësve të tyre dhe vetëm për llogari të tyre.

Derogimi i përmendur në germën (d) të nënparagrafit të parë të këtij paragrafi zbatohet vetëm nëse shoqëria nga vendi i tretë, në politikën e saj të investimit, respekton kufijtë e përcaktuar në nenet 52 dhe 55 dhe në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni. Kur tejkalohe kufijtë e përcaktuar në nenet 52 dhe 55, zbatohet *mutatis mutandis* neni 57.

Neni 57

1. Kur SIKTT-të ushtrojnë të drejta nënshkrimi për titujt e transferueshëm ose instrumentet e tregut të parasë që janë pjesë përbërëse e aseteve të tyre, atyre nuk u kërkohet që të respektojnë kufijtë e përcaktuar në këtë Kapitull.

Pasi sigurohen për respektimin e parimit të shpërndarjes së riskut, shtetet anëtare mund t'i lejojnë SIKTT-të e autorizuara së fundmi që të derogojnë nga nenet 52 deri në 55 për një periudhë gjashtëmujore, duke filluar nga data e autorizimit të tyre.

2. Nëse kufijtë e përmendur në paragrafin 1 tejkalohe për arsye jashtë kontrollit të SIKTT-së ose për shkak të ushtrimit të të drejtave të nënshkrimit, atëherë kjo SIKTT vendos objektiv prioritar për transaksionet e shitjeve, zgjidhjen e kësaj situatë duke marrë parasysh interesat e mbajtësve të kuotave.

KAPITULLI VIII

STRUKTURAT KRYESORE-FURNIZUESE

SEKSIONI 1

Fusha e zbatimit dhe miratimi

Neni 58

1. SIKTT-ja furnizuese është SIKTT-ja, ose divizioni i saj i investimit, që është e/i autorizuar për të investuar, duke deroguar nga neni 1, paragrafi 2, germa (a), nenet 50, 52 dhe 55 dhe neni 56, paragrafi 2 ,germa (c), të paktën 85% të aseteve të saj/tij në kuotat e një SIKTT-je tjetër, ose të divizionit të investimit të kësaj SIKTT-je tjetër (SIKTT-ja kryesore).

2. Një SIKTT furnizuese mund të zotërojë deri në 15% të aseteve të saj në një ose më shumë nga sa vijon:

- (a) asete likuide për qëllime dytësore, në përputhje me nënparagrafin e dytë të nenit 50, paragrafi 2;
- (b) instrumente financiare derivative, të cilat mund të përdoren vetëm për qëllime mbrojtjeje, në përputhje me nenin 50, paragrafi 1, germa (g) dhe neni 51 paragrafi 2 dhe 3;
- (c) pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat janë thelbësore për ushtrimin e veprimtarisë tregtare, në rastin kur SIKTT-ja furnizuese është shoqëri investimi.

Për të siguruar përputhshmërinë me nenin 51, paragrafi 3, SIKTT-ja furnizuese e llogarit ekspozimin e saj global në lidhje me instrumentet financiare derivative, duke kombinuar ekspozimin e saj të drejtpërdrejtë, sipas germës (b) të nënparagrafit të parë, me një nga elementet e mëposhtme:

(a) ekspozimin aktual të SIKTT-së kryesore ndaj instrumenteve financiare derivative në raport me investimin e SIKTT-së furnizuese në SIKTT-në kryesore; ose

(b) ekspozimin maksimal global të mundshëm të SIKTT-së kryesore në instrumentet financiare derivative, të parashikuara në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit të SIKTT-së kryesore në raport me investimin e SIKTT-së furnizuese në SIKTT-të kryesore.

3. SIKTT-ja kryesore është SIKTT-ja ose divizioni i saj i investimit, që:

(a) ka të paktën një SIKTT furnizuese, nga radhët e mbajtësve të kuotave të saj;

(b) nuk është vet SIKTT furnizuese; dhe

(c) nuk mban kuota të një SIKTT-je furnizuese.

4. Derogimet e mëposhtme për SIKTT-të kryesore zbatohen:

(a) nëse SIKTT-ja kryesore ka të paktën dy SIKTT furnizuese, si mbajtëse të kuotave, neni 1, paragrafi 2, germa (a) dhe neni 3, paragrafi (b) nuk zbatohen, duke i ofruar SIKTT-së kryesore mundësinë e zgjedhjes lidhur me krijimin apo moskrijimin e kapitalit nga investues të tjerë;

(b) Nëse një SIKTT kryesore nuk krijon kapital nga publiku i një shteti anëtar të ndryshëm nga shteti i saj i themelimit, por ka në këtë shtet vetëm një ose më shumë SIKTT furnizuese, Kapitulli XI dhe nënparagrafi i dytë i nenit 108, paragrafi 1 nuk zbatohen.

Neni 59

1. Shtetet anëtare garantojnë që investimi i një SIKTT-je furnizuese në një SIKTT kryesor të caktuar që tejkalon kufirin e zbatueshëm sipas nenit 55, paragrafi 1 për investimet në SIKTT të tjera, t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga autoritetet kompetente të shtetit të origjinës të SIKTT-së furnizuese.

2. SIKTT-ja furnizuese njoftohet për miratimin ose mosmiratimin e investimit të saj në SIKTT-në kryesore, brenda 15 ditësh pune pas dorëzimit të dosjes së plotë.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së furnizuese e japin miratimin vetëm nëse SIKTT-ja furnizuese, depozitari dhe eksperti kontabël i saj, si dhe SIKTT-ja kryesore përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara në këtë Kapitull. Për këto qëllime, SIKTT-ja furnizuese i jep autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj, dokumentet e mëposhtme:

(a) rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të SIKTT-së furnizuese dhe të SIKTT-së kryesore;

- (b) prospektin dhe informacionin kryesor për investitorët e SIKTT-së furnizuese dhe SIKTT-së kryesore, sipas nenit 78;
- (c) marrëveshjen ndërmjet SIKTT-së furnizuese dhe SIKTT-së kryesore ose rregulloren e brendshme të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, të përmendur në nenin 60, paragrafi 1;
- (d) sipas rastit, informacionin që duhet t'i jepet mbajtësve të kuotave, të përmendur në nenin 64, paragrafi 1;
- (e) nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese kanë depozitarë të ndryshëm, marrëveshjen për shkëmbimin e informacionit, të përmendur në nenin 61 paragrafi 1, ndërmjet depozitarëve përkatës të tyre; dhe
- (f) nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese kanë ekspertë kontabël të ndryshëm, marrëveshjen për shkëmbimin e informacionit, të përmendur në nenin 62, paragrafi 1, ndërmjet ekspertëve kontabël përkatës të tyre.

Kur SIKTT-ja furnizuese është themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së kryesore, ajo jep edhe vërtetimin e lëshuar nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së kryesore, ku deklarohet se kjo e fundit është një SIKTT ose një divizion investimi që përmbush kushtet e përcaktuara në nenin 58, paragrafi 3, geramat (b) dhe (c). SIKTT-ja furnizuese i depoziton dokumentet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar të origjinës së saj ose në gjuhën e miratuar nga autoritetet kompetente të saj.

SEKSIONI 2

Dispozita të përbashkëta për SIKTT-të furnizuese dhe ato kryesore

Neni 60

1. Shtetet anëtare u kërkojnë SIKTT-ve kryesore që t'u japin SIKTT-ve furnizuese të gjitha dokumentet dhe informacionet që mund t'u nevojiten këtyre të fundit për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë direktivë. Për këtë qëllim, SIKTT-të furnizuese lidhin marrëveshje me SIKTT-të kryesore.

Deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjes së përmendur në nënparagrafin e parë, investimi i SIKTT-së furnizuese në kuotat e SIKTT-së kryesore në fjalë nuk duhet të tejkalojë kufirin e zbatueshëm, sipas nenit 55, paragrafi 1. Marrëveshja u vihet në dispozicion të gjithë mbajtësve të kuotave, falas dhe sipas kërkesës.

Në rast se të dyja SIKTT-të, pra SIKTT-ja kryesore dhe ajo furnizuese, administrohen nga e njëjta shoqëri administruese, marrëveshja mund të zëvendësohet me rregulloren e brendshme të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përmbushje të kërkesave të përcaktuara në këtë paragraf.

2. SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese marrin masat e duhura për koordinimin e kohës së llogaritjes dhe publikimit të vlerës neto të aseteve të tyre, me qëllim shmangien e parashikimit të ecurisë së tregut për kuotat e tyre, duke parandaluar mundësitë e arbitrazhit.

3. Pa cenuar nenin 84, nëse një SIKTT kryesore pezullon përkohësisht riblerjen, shlyerjen ose nënshkrimin e kuotave të saj, me iniciativën e vet apo me kërkesë të autoriteteve të saj kompetente, secila nga SIKTT-të e saj furnizuese gëzon të drejtën që të pezullojë riblerjen, shlyerjen apo nënshkrimin e kuotave të saj, pavarësisht kushteve të përcaktuara në nenin 84, paragrafi 2, në të njëjtën periudhë kohore me SIKTT-në kryesore.

4. Nëse një SIKTT kryesore likuidohet, likuidohet edhe SIKTT-ja furnizuese, me përjashtim të rastit kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj miratojnë:

(a) investimin e të paktën 85% të aseteve të SIKTT-së furnizuese në kuotat e një SIKTT-je kryesore tjetër; ose

(b) ndryshimin e rregullave të fondit ose të dokumenteve të saj të themelimit, me qëllimin për të mundësuar shndërrimin e SIKTT-së furnizuese në një SIKTT jofurnizuese.

Pa cenuar dispozitat kombëtare specifike për likuidimin e detyrueshëm, likuidimi i një SIKTT-je kryesore mund të kryhet vetëm tre muaj pasi kjo e fundit ka njoftuar të gjithë mbajtësit e kuotave të saj dhe autoritetet kompetente të SIKTT-së furnizuese, lidhur me vendimin detyrues për likuidim.

5. Nëse një SIKTT kryesore bashkohet me një SIKTT tjetër ose ndahet në dy ose më shumë SIKTT, SIKTT-të furnizuese likuidohen, me përjashtim të rastit kur autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së furnizuese i japin kësaj të fundit miratimin për të:

(a) vazhduar si SIKTT furnizuese e SIKTT-së kryesore ose e një SIKTT-je tjetër të krijuar nga bashkimi ose ndarja e SIKTT-së kryesore;

(b) investuar të paktën 85% të aseteve të saj në kuotat e një SIKTT-je kryesore tjetër, që nuk rezulton nga bashkimi ose ndarja; ose

(c) ndryshuar rregullat e fondit ose dokumentet e saj të themelimit, me qëllimin për t'u shndërruar në një SIKTT që nuk është SIKTT furnizuese.

Asnjë bashkim apo ndarje e një SIKTT-je kryesore nuk hyn në fuqi nëse kjo SIKTT nuk u ka dhënë të gjithë mbajtësve të kuotave të saj dhe autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së së saj furnizuese, informacionin e përmendur në nenin 43, ose të njëjtë me të, minimumi 60 ditë përpara datës së propozuar të hyrjes në fuqi.

Nëse autoritetet kompetente të shtetit anëtar të SIKTT-së furnizuese nuk kanë dhënë miratimin sipas pikës (a) të nënparagrafit të parë, SIKTT-ja kryesore i jep SIKTT-së furnizuese mundësinë e riblerjes ose rimbursimit të të gjitha kuotave në SIKTT-në kryesore, përpara hyrjes në fuqi të bashkimit ose ndarjes së kësaj të fundit.

6. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese, ku specifikohet:

- (a) përmbajtja e marrëveshjes ose e rregullores së brendshme të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, përmendur në paragrafin 1;
- (b) se cilat masa, nga ato të përmendura në paragrafin 2, konsiderohen si të përshtatshme; dhe
- (c) procedura për miratimet e kërkuara sipas paragrafëve 4 dhe 5 në rast likuidimi, bashkimi ose ndarja e një SIKTT-je kryesore.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

SEKSIONI 3

Depozitarët dhe ekspertët kontabël

Neni 61

1. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe ajo furnizuese kanë depozitarë të ndryshëm, shtetet anëtare mund të kërkojnë që këta depozitarë të lidhin një marrëveshje për shkëmbimin e informacionit, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve të të dy depozitarëve në fjalë.

SIKTT-ja furnizuese nuk investon në kuotat e SIKTT-së kryesore, deri në hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

Në rastin kur ato përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë Kapitull, as depozitari i SIKTT-së kryesore dhe as ai i asaj furnizuese nuk duhet të rezultojnë në shkelje të rregullave që kufizojnë nxjerrjen e informacionit ose që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, në rastin kur këto rregulla parashikohen në një kontratë apo në një ligj, rregullore ose dispozitë administrative. Kjo përputhshmëri nuk duhet të shkaktojë ndonjë detyrim për depozitarin përkatës apo çdo person tjetër që vepron në emër të tij.

Shtetet anëtare i ngarkojnë SIKTT-së furnizuese ose, sipas rastit, shoqërisë së saj administruese, përgjegjësinë për t'i përcjellë depozitarit të SIKTT-së furnizuese çdo informacion rreth SIKTT-së kryesore, që mund t'i nevojitet atij për përmbushjen e detyrave të tij.

2. Depozitari i SIKTT-së kryesore njofton menjëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së kryesore, SIKTT-në furnizuese ose, sipas rastit, shoqërinë administruese dhe depozitarin e SIKTT-së furnizuese, për çdo parregullsi që zbulon lidhur me SIKTT-në kryesore e që konsiderohet se ka ndikim negativ në SIKTT-në furnizuese.

3. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për specifikimin e mëtejshëm të:

- (a) detajeve që duhet të përfshihen në marrëveshjen e përmendur në paragrafin 1; dhe
- (b) llojeve të parregullsive, të përmendura në paragrafin 2, që konsiderohen se kanë ndikim negativ në SIKTT-në furnizuese.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në Nenin 112, paragrafi 2.

Neni 62

1. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe ajo furnizuese kanë ekspertë kontabël të ndryshëm, shtetet anëtare u kërkojnë këtyre ekspertëve kontabël të lidhin një marrëveshje për shkëmbimin e informacionit, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga të dy këta ekspertë kontabël, përfshirë edhe masat e marra për përputhshmërinë me kërkesat e paragrafit 2.

SIKTT-ja furnizuese nuk investon në kuotat e SIKTT-së kryesore, deri në hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshjeje.

2. Eksperti kontabël i SIKTT-së furnizuese, në raportin e tij të auditimit, merr në konsideratë raportin e auditimit të SIKTT-së kryesore. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese kanë vite kontabël të ndryshëm, eksperti kontabël i SIKTT-së kryesore harton një raport të posaçëm në datën e mbylljes së SIKTT-së furnizuese.

Eksperti kontabël i SIKTT-së furnizuese raporton veçanërisht rreth çdo parregullsie të paraqitur në raportin e auditimit të SIKTT-së kryesore, si dhe rreth ndikimit që kanë ato në SIKTT-në furnizuese.

3. Kur përmbushin kërkesat e përcaktuara në këtë Kapitull, as eksperti kontabël i SIKTT-së kryesore dhe as ai i SIKTT-së furnizuese nuk duhet të rezultojnë në shkelje të rregullave që kufizojnë nxjerrjen e informacionit ose që lidhet me mbrojtjen e të dhënave, kur këto rregulla parashikohen në një kontratë ose në një ligj, rregullore apo dispozitë administrative. Kjo përputhshmëri nuk duhet të shkaktojë ndonjë detyrim për ekspertin kontabël përkatës apo çdo person tjetër që vepron në emër të tij.

4. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për specifikimin e përmbajtjes së marrëveshjes së përmendur në nënparagrafin e parë të paragrafit 1.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

SEKSIONI 4

Informacioni i detyrueshëm dhe komunikimet e marketimit nga SIKTT-ja furnizuese

Neni 63

1. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që prospekti i SIKTT-së furnizuese, përveç informacionit të parashikuar në tabelën A të Shtojcës I, të përmbajë edhe informacionin e mëposhtëm:

(a) deklaratën që SIKTT-ja furnizuese është furnizuesja e një SIKTT-je kryesore të caktuar dhe si e tillë investon, në mënyrë të përhershme, 85%, ose më shumë, të aseteve të saj në kuotat e

kësaj SIKTT-je kryesore;

- (b) objektivin dhe politikat e investimit, duke përfshirë riskun e profilit dhe cilësimin nëse SIKTT-ja furnizuese dhe ajo kryesore kanë të njëjtën performancë, ose në çmasë ndryshojnë ato dhe cilat janë shkaqet e këtij ndryshimi, duke përfshirë përshkrimin e investimit të kryer në përputhje me nenin 58, paragrafi 2;
- (c) një përshkrim të shkurtër të SIKTT-së kryesore, organizimit të saj dhe të objektivit dhe politikës së investimit, duke përfshirë profilin e riskut dhe cilësimin e mënyrës në të cilën mund të merret prospekti i SIKTT-së kryesore;
- (d) një përmbledhje të marrëveshjes së lidhur ndërmjet SIKTT-së furnizuese dhe asaj kryesore ose të rregullores së brendshme të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, sipas nenit 60, paragrafi 1;
- (e) mënyrën se si mbajtësit e kuotave mund të marrin informacion të mëtejshëm rreth SIKTT-së kryesore dhe marrëveshjes së lidhur ndërmjet SIKTT-së furnizuese dhe asaj kryesore, sipas nenit 60, paragrafi 1;
- (f) përshkrimin e të gjithë kompensimit ose rimbursimit të kostove, që duhen paguar nga SIKTT-ja furnizuese nëpërmjet investimeve në kuotat e SIKTT-së kryesore, si dhe kostot totale të SIKTT-së furnizuese dhe SIKTT-së kryesore; dhe
- (g) përshkrimin e implikimeve tatimore për SIKTT-në furnizuese që investon në SIKTT-në kryesore.

2. Përveç informacionit të parashikuar në tabelën B të Shtojcës I, raporti vjetor i SIKTT-së furnizuese përfshin pasqyrën e kostove totale të SIKTT-së furnizuese dhe SIKTT-së kryesore.

Në raportin vjetor dhe në raportin gjashtëmujor të SIKTT-së furnizuese tregohet mënyra se si mund të merren raporti vjetor dhe ai gjashtëmujor i SIKTT-së kryesore.

3. Përveç kërkesave të përcaktuara në nenet 74 dhe 82, SIKTT-ja furnizuese i dërgon autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj prospektin, informacionin kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78, së bashku me çdo ndryshim përkatës të tij, si dhe raportin vjetor dhe raportin gjashtëmujor të SIKTT-së kryesore.

4. SIKTT-ja furnizuese e shpall përmes komunikimeve të marketimit, faktin që po investon, në mënyrë të përhershme, 85%, ose më shumë, të asetet e saj në SIKTT-në kryesore.

5. SIKTT-ja furnizuese u dërgon investitorëve, me kërkesë të tyre dhe pa pagesë, një kopje fizike të prospektit, së bashku me raportin vjetor dhe raportin gjashtëmujor të SIKTT-së kryesore.

SEKSIONI 5

Shndërrimi i SIKTT-ve ekzistuese në SIKTT furnizuese dhe ndryshimi i SIKTT-ve kryesore

Neni 64

1. Shtetet anëtare u kërkojnë SIKTT-ve furnizuese që e ushtrojnë veprimtarinë e SIKTT-së, duke përfshirë edhe veprimtarinë e SIKTT-së furnizuese të një SIKTT-je kryesore tjetër, që t'i japin mbajtësve të kuotave informacionin e mëposhtëm:

- (a) deklaratën se autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së furnizuese, e kanë miratuar investimin e SIKTT-së furnizuese në kuotat e kësaj SIKTT-je kryesore;
- (b) informacionin kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78, për SIKTT-në furnizuese dhe atë kryesore;
- (c) datën e fillimit të investimit të SIKTT-së furnizuese në SIKTT-në kryesore ose, nëse ajo ka investuar tashmë tek kjo e fundit, datën në të cilën investimi i saj do të tejkalojë kufirin e zbatueshëm sipas nenit 55, paragrafi 1; dhe
- (d) deklaratën se mbajtësit e kuotave gëzojnë të drejtën për të kërkuar riblerjen ose shlyerjen e kuotave të tyre, brenda 30 ditëve, pa asnjë tarifë tjetër përveç atyre të mbajtura nga SIKTT-ja për mbulimin e kostove të tërheqjes së investimeve; kjo e drejtë hyn në fuqi nga momenti kur SIKTT-ja furnizuese jep informacionin e përmendur në këtë paragraf.

Ky informacion jepet të paktën 30 ditë përpara datës së përmendur në germën (c) të nënparagrafit të parë.

2. Në rastin e njoftimit të SIKTT-së furnizuese në përputhje me nenin 93, informacioni i përmendur në paragrafin 1 jepet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së furnizuese ose në gjuhën e miratuar nga autoritetet kompetente të tij. SIKTT-së furnizuese është përgjegjëse për të paraqitur përkthimin. Përkthimi duhet të pasqyrojë me përpikëri përmbajtjen e dokumentit origjinal.

3. Shtetet anëtare garantojnë që, përpara përfundimit të periudhës 30-ditore, të përmendur në nënparagrafin e dytë të paragrafit 1, SIKTT-ja furnizuese të mos investojë në kuotat e SIKTT-së kryesore përkatëse, më shumë se sa kufiri i zbatueshëm sipas nenit 55, paragrafi 1.

4. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese, ku specifikohet:

- (a) formati dhe mënyra në të cilën do të jepet informacioni, i përmendur në paragrafin 1; ose
- (b) procedura e vlerësimit dhe auditimit të kontributit në natyrë dhe të rolit të depozitarit të SIKTT-së furnizuese në këtë proces, në rastin kur SIKTT-ja furnizuese i transferon SIKTT-së kryesore të gjitha ose një pjesë të aseteve të saj në këmbim të kuotave.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

SEKSIONI 6

Detyrimet dhe autoritetet kompetente

Neni 65

1. SIKTT-ja furnizuese monitoron me efikasitet veprimtarinë e SIKTT-së kryesore. Në përmbushjen e këtij detyrimi, SIKTT-ja furnizuese mund të mbështetet në informacionin dhe dokumentet e marra nga SIKTT-ja kryesore ose, sipas rastit, nga shoqëria administruese, depozitari dhe eksperti kontabël, me përjashtim të rasteve kur ka arsye për të dyshuar në saktësinë e tyre.
2. Në rastin kur, për një investim në kuotat e SIKTT-së kryesore, SIKTT-ja furnizuese, shoqëria e saj administruese ose ndonjë person tjetër që vepron për llogari të SIKTT-së furnizuese apo shoqërisë administruese, merr një tarifë për shpërndarjen, komision ose ndonjë përfitim tjetër monetar, atëherë tarifa, komisioni ose përfitimi tjetër monetar derdhet në asetet e SIKTT-së furnizuese.

Neni 66

1. SIKTT-ja furnizuese njofton menjëherë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj për identitetin e çdo SIKTT-je furnizuese, që investon në kuotat e saj. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese janë themeluar në shtete anëtare të ndryshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së kryesore njoftojnë menjëherë autoritetet e shtetit Anëtar të origjinës së SIKTT-së furnizuese, për investimin në fjalë.
2. SIKTT-ja kryesore nuk vendos tarifa nënshkrimi ose shlyerjeje për investimin e SIKTT-së furnizuese në kuotat e saj apo për tërheqjen nga ky investim.
3. SIKTT-ja kryesore garanton që i gjithë informacioni i kërkuar në përputhje me këtë direktivë, ndonjë ligj tjetër të Komunitetit, legjislacionin e zbatueshëm kombëtar, rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit, t'i vihet në dispozicion në kohë SIKTT-së furnizuese ose, sipas rastit, shoqërisë së saj administruese, si dhe autoriteteve kompetente, depozitarit dhe ekspertit kontabël të SIKTT-së furnizuese.

Neni 67

1. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese janë themeluar në të njëjtin shtet anëtar, autoritetet kompetente i njoftojnë menjëherë SIKTT-së furnizuese çdo vendim, masë, konstatim mospërputhshmërie me kushtet e këtij Kapitulli ose çdo informacion të raportuar sipas nenit 106, paragrafi 1, në lidhje me SIKTT-në kryesore ose, sipas rastit, depozitarin, ekspertin kontabël ose shoqërinë e saj administruese.
2. Nëse SIKTT-ja kryesore dhe SIKTT-ja furnizuese janë themeluar në shtete anëtare të ndryshme, autoritetet kompetente të shtetit anëtar origjinës së SIKTT-së kryesore i komunikojnë menjëherë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së furnizuese çdo vendim, masë, konstatim mospërputhshmërie me kushtet e këtij Kapitulli ose informacion të raportuar sipas nenit 106, paragrafi 1, në lidhje me SIKTT-në kryesore ose, sipas rastit, në lidhje me depozitarin, ekspertin kontabël ose shoqërinë e saj administruese. Më pas, autoritetet

kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së furnizuese informojnë menjëherë këtë të fundit.

KAPITULLI IX
DETYRIMET LIDHUR ME INFORMACIONIN QË DUHET T'U JEPET
INVESTITORËVE

SEKSIONI 1

Publikimi i prospektit dhe i raporteve periodike

Neni 68

1. Shoqëria e investimit dhe shoqëria e administrimit, për secilin nga fondet e përbashkëta që ka në administrim, publikojnë:

- (a) prospektin;
- (b) raportin vjetor për çdo vit financiar; dhe
- (c) raportin gjashtëmuajor, që mbulon gjashtë muajt e parë të vitit financiar.

2. Raporti vjetor dhe ai gjashtëmuajor botohen brenda kufijve kohorë të mëposhtëm, duke filluar nga fundi i periudhës me të cilën lidhen:

- (a) katër muaj për raportin vjetor; ose
- (b) dy muaj për raportin gjashtëmuajor.

Neni 69

1. Prospekti përfshin informacionin e nevojshëm që u mundëson investitorëve të marrin vendim të informuar për investimin e propozuar dhe, në veçanti, për rreziqet që shoqërojnë investimin në fjalë.

Pavarësisht instrumenteve të investuara, prospekti përfshin një shpjegim të qartë dhe lehtësisht të kuptueshëm të profilit të riskut të fondit.

2. Prospekti përmban minimalisht informacionin e parashikuar në tabelën A të Shtojcës I, nëse ky informacion nuk është paraqitur në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit që i bashkëngjiten prospektit, në përputhje me nenin 71, paragrafi 1.

3. Raporti vjetor përfshin bilancin ose pasqyrën e aktiveve dhe pasiveve, përmbledhjen e detajuar të të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin financiar, raportin mbi veprimtaritë e vitit financiar dhe informacionet e tjera të parashikuara në tabelën B të Shtojcës I, si dhe çdo informacion të rëndësishëm që do t'i mundësojë investitorëve marrjen e një vendimi të informuar lidhur me zhvillimin e veprimtarive të SIKTT-së dhe rezultatet e saj.

4. Raporti gjashtëmujor përfshin të paktën informacionin e parashikuar në Seksionet I deri në IV të tabelës B të Shtojcës I. Kur SIKTT-ja ka paguar ose propozon të paguajë një dividend të ndërmjetëm, duhet të tregohen në shifra rezultatet pas tatimit, për gjashtëmujorin në fjalë, si dhe dividendi i ndërmjetëm i paguar ose i propozuar.

Neni 70

1. Në prospekt tregohet se në cilat kategori asetesh është e autorizuar të investojë një SIKTT. Në të përmendet nëse janë autorizuar transaksione në instrumente financiare derivative, rast në të cilin ai duhet të përfshijë një deklaratë të qartë që cilëson nëse këto operacione mund të kryhen për qëllime mbrojtjeje ose për arritjen e objektivave të investimit, si dhe rezultatet e mundshme të përdorimit të instrumenteve financiare derivative në profilin e rrezikut.

2. Kur një SIKTT investon kryesisht në ndonjë nga kategoritë e asetëve të përcaktuara në nenin 50, e jo në titujt e transferueshëm ose instrumente të tregut të parasë, ose kur një SIKTT replikon një indeks aksionesh ose një indeks instrumentesh borxhi, në përputhje me nenin 53, prospekti dhe, sipas rastit, komunikimet e marketimit përfshijnë një deklaratë të qartë që vë theksin në politikën e investimit.

3. Kur vlera neto e asetëve të një SIKTT-je ka gjasa të ketë paqëndrueshmëri të lartë për shkak të përbërjes së portofolit të saj ose teknikave të menaxhimit të portofolit që mund të përdoren, prospekti dhe, sipas rastit, komunikimet e marketimit përfshijnë një deklaratë të qartë që vë theksin në këtë karakteristikë.

4. Pas kërkesës nga investitori, shoqëria administruese jep edhe informacion plotësues për kufijtë sasiorë të zbatueshëm në menaxhimin e riskut të SIKTT-së, metodat e zgjedhura për këtë qëllim, si dhe për zhvillimet më të fundit të risqeve kryesore dhe yield-it sipas kategorive të instrumenteve.

Neni 71

1. Rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të një shoqërie investimi janë pjesë përbërëse e prospektit dhe i bashkëngjiten atij.

2. Gjithsesi, dokumentet e përmendura në paragrafin 1 mund të mos i bashkëngjiten prospektit, me kusht që investitori të informohet se këto dokumente do t'i dërgohen atij, sipas kërkesës, ose të informohet se ku mund t'i gjejë ato në secilin prej shteteve anëtare ku marketohen kuotat.

Neni 72

Elementet thelbësore të prospektit mbahen të përditësuara.

Neni 73

Informacioni kontabël i dhënë në raportin vjetor auditohet nga një ose më shumë persona të autorizuar me ligj për auditimin e llogarive, në përputhje me Direktivën 2006/43/KE. I gjithë raporti i ekspertit kontabël, përfshirë çdo kualifikim, paraqitet në raportin vjetor.

Neni 74

SIKTT-të u dërgojnë autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, prospektin dhe çdo ndryshim të tij, së bashku me raportin vjetor dhe raportin gjashtëmujor. SIKTT-të ia japin këto dokumente autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, me kërkesë të tyre.

Neni 75

1. Prospekti dhe botimi më i fundit i raporti vjetor dhe raportit gjashtëmujor, u jepen investitorëve, me kërkesë të tyre dhe pa pagesë.
2. Prospekti mund të ofrohet përmes mediumit të qëndrueshëm ose nëpërmjet faqeve të internetit. Investitorëve u dërgohet një kopje fizike e tij, me kërkesë të tyre dhe pa pagesë.
3. Raporti vjetor dhe raporti gjashtëmujor u vihen në dispozicion investitorëve, në mënyrën e specifikuar në prospekt dhe në informacionin kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78. Një kopje fizike e raportit vjetor dhe raportit gjashtëmujor u dërgohet investitorëve, me kërkesë të tyre dhe pa pagesë.
4. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese që përcaktojnë kushtet specifike që duhen përmbushur kur prospekti ofrohet përmes mediumit të qëndrueshëm, pra jo në kopje fizike, ose nëpërmjet një faqeje interneti, e cila nuk përbën medium të qëndrueshëm.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

SEKSIONI 2

Publikimi i informacioneve të tjera

Neni 76

SIKTT-të publikojnë në mënyrën e duhur çmimin e emetimit, shitjes, riblerjes ose shlyerjes të kuotave të saj, për çdo emetim, shitje, riblerje ose rimbursim të tyre dhe të paktën dy herë në muaj.

Megjithatë, autoritetet kompetente mund ta lejojnë një SIKTT që të reduktojë këtë frekuencë deri në një herë në muaj, me kusht që ky derogim të mos cenojë interesat e mbajtësve të kuotave.

Neni 77

Të gjitha komunikimet e marketimit që u bëhen investitorëve, mbahen qartësisht të identifikueshme si të tilla. Ato duhet të jenë të drejta, të qarta dhe joçorientuese. Në mënyrë të veçantë, komunikimet e marketimit që përfshijnë një ftesë për blerjen e kuotave të SIKTT-së, e cila përmban të dhëna specifike rreth një SIKTT-je, nuk përmbajnë pohime që janë në kundërshtim ose zbehin rëndësinë e informacionit të dhënë në prospekt dhe të informacionit

kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78. Ato duhet të tregojnë se ekziston një prospekt dhe se disponohet informacioni kryesor për investitorët i përmendur në nenin 78. Ato duhet të specifikojnë vendin dhe gjuhën në të cilën investitorët ose investitorët e mundshëm mund t'i marrin këto informacione apo dokumente, si dhe mënyrën e aksesimit të tyre.

SEKSIONI 3

Informacioni kryesor për investitorët

Neni 78

1. Shtetet anëtare mund të kërkojnë që shoqëritë e investimit dhe shoqëritë e administruese, për çdo fond të përbashkët që administrojnë, të hartojnë një dokument të shkurtër me informacionin kryesor për investitorët. Ky dokument referohet si "informacioni kryesor për investitorët" në këtë direktivë. Fjalët "informacioni kryesor për investitorët" duhet të shkruhen qartë në këtë dokument, në një nga gjuhët e përmendura në nenin 94, paragrafi 1, germa (b).

2. Informacioni kryesor për investitorët përfshin informacionin e duhur rreth karakteristikave thelbësore të SIKTT-së në fjalë, i cili duhet t'i jepet investitorëve që ata të kenë mundësi të kuptojnë natyrën dhe risqet e produktit të investimit që u ofrohet dhe, si rrjedhim, të marrin vendime të informuara për investime.

3. Informacioni kryesor për investitorët jep informacion rreth elementeve thelbësore të mëposhtme të SIKTT-së në fjalë:

- (a) identifikimi i SIKTT-së;
- (b) një përshkrim të shkurtër të objektivave të saj të investimit dhe të politikës së investimit;
- (c) performanca në të shkuarën ose, sipas rastit, skenarët e performancës;
- (d) kostot dhe tarifat përkatëse; dhe
- (e) profili i riskut/përfitimeve të investimit, duke përfshirë udhëzimet dhe paralajmërimet e duhura për rreziqet që shoqërojnë investimet në SIKTT-në përkatëse.

Këto elemente thelbësore duhet të jenë të kuptueshme për investitorin, pa referime në dokumente të tjera.

4. Informacioni kryesor për investitorët duhet të specifikohet qartë se ku dhe në ç'mënyrë mund të merret informacion shtesë për investimin e propozuar, duke përfshirë por pa u kufizuar me vendin dhe mënyrën në të cilën prospekti, raporti vjetor dhe raporti gjashtëmuor mund të merret në çdo kohë, me kërkesë dhe falas, si dhe gjuhën në të cilën ky informacion është i disponueshëm për investitorët.

5. Informacioni kryesor për investitorët shkruhet në gjuhë koncize dhe joteknike. Ai hartohet në një format të përbashkët, i cili bën të mundur krahasimin e tij, dhe paraqitet në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme nga investitorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë.

6. Informacioni kryesor për investitorët përdoret pa ndryshime apo shtesa, me përjashtim të përkthimit, në të gjitha shtetet anëtare ku SIKTT-ja njoftohet të tregtojë kuotat e saj në përputhje me nenin 93.

7. Komisioni miraton masa zbatuese që përcaktojnë:

(a) përmbajtjen e detajuar dhe të plotë të informacionit kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve të përmendur në paragrafët 2, 3 dhe 4;

(b) përmbajtjen e detajuar dhe të plotë të informacionit kryesor për investitorët, i cili duhet t'u jepet këtyre të fundit në rastet specifike të mëposhtme:

(i) për SIKTT-të me divizione të ndryshme investimi, informacionin kryesor për investitorët që duhet t'u jepet investitorëve që nënshkruajnë në një divizion specifik investimesh, duke përfshirë mënyrën e kalimit nga një divizion investimi te një tjetër dhe kostot përkatëse;

(ii) për SIKTT-të që ofrojnë kategori të ndryshme aksionesh, informacionin kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve që nënshkruajnë një kategori të caktuar aksionesh;

(iii) për fondin e strukturave të fondeve, informacionin kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve që nënshkruajnë në një SIKTT, e cila investon vetë në një SIKTT tjetër ose në sipërmarrje të tjera të investimeve kolektive, të përmendura në nenin 50 paragrafi 1, germa (e);

(iv) për strukturat kryesore-furnizuese, informacionin kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve, që nënshkruajnë një SIKTT furnizuese; dhe

(v) për SIKTT-të e strukturuar, me kapital të mbrojtur dhe SIKTT të tjera të ngjashme, informacionin kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve për karakteristikat e veçanta të këtyre SIKTT-ve; dhe

(c) detajet specifike të formatit dhe paraqitjes së informacionit kryesor për investitorët, që duhet t'u jepet investitorëve të përmendur në paragrafin 5.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 79

1. Informacioni kryesor për investitorët përbën informacionin parakontraktor. Ai duhet të jetë i drejtë, i qartë dhe joçorientues. Ai duhet të jetë në përputhje me pjesët përkatëse të prospektit.

2. Shtetet anëtare garantojnë që një person të mos mbajë përgjegjësi civile për informacionin kryesor për investitorët, duke përfshirë çdo përkthim të tij, me përjashtim të rasteve kur ai është

çorientues, i pasaktë ose jokonsistent me pjesët përkatëse të prospektit. Informacioni kryesor për investitorët duhet të përmbajë një paralajmërim të qartë për këtë.

Neni 80

1. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë së investimit, dhe shoqërisë administruese për çdo fond të përbashkët që administron, që shet SIKTT drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi tjetër fizik ose juridik që vepron për llogari të dhe nën përgjegjësinë e plotë dhe të pakushtëzuar të saj, që t'u japë investitorëve, në kohën e duhur përpara nënshkrimit të propozuar të kuotave në këto SIKTT, informacionin kryesor për investitorët lidhur me SIKTT-të në fjalë.
2. Shtetet anëtare i kërkojnë shoqërisë së investimit, dhe shoqërisë administruese për çdo fond të përbashkët që menaxhon, që nuk shet SIKTT drejtpërdrejt ose nëpërmjet një personi tjetër fizik ose juridik që vepron për llogari të saj dhe nën përgjegjësinë e tij të plotë dhe të pakushtëzuar ndaj investitorëve, që t'u japë prodhuesve të produktit dhe ndërmjetësuesve që shesin ose këshillojnë investitorët mbi investimet e mundshme në këto SIKTT ose mbi produkte që ofrojnë ekspozim në këto SIKTT, informacionin kryesor për investitorët, me kërkesë të tyre. Shtetet anëtare u kërkojnë ndërmjetësuesve që shesin ose këshillojnë investitorët mbi investimet e mundshme në SIKTT, që t'u japin klientëve të tyre të mundshëm, informacionin kryesor për investitorët.
3. Investitorët e marrin falas informacionin kryesor për investitorët.

Neni 81

1. Shtetet anëtare i lejojnë shoqëritë e investimit, dhe shoqëritë administruese për çdo fond të përbashkët që administrojnë, që ta japin informacionin kryesor për investitorët përmes një mediumi të qëndrueshëm ose nëpërmjet faqes së internetit. Një kopje fizike e këtij informacioni i dërgohet investitorit, me kërkesë të këtij të fundit dhe pa pagesë.

Gjithashtu, një variant i përditësuar i informacionit kryesor për investitorët bëhet i disponueshëm në faqen e internetit të shoqërisë së investimit ose shoqërisë administruese.

2. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për përcaktimin e kushteve specifike që duhen përbushur kur informacioni kryesor për investitorët nuk jepet në kopje fizike por përmes një mediumi të qëndrueshëm ose nëpërmjet një faqeje interneti, e cila nuk përbën medium të qëndrueshëm.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 82

1. SIKTT-të ia dërgojnë informacionin e tyre kryesor për investitorët, si dhe çdo ndryshim të tij, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së tyre.
2. Elementet thelbësore të informacionit kryesor për investitorët mbahen të përditësuara.

KAPITULLI X
DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË SIKTT-VE

Neni 83

1. Nuk marrin hua subjektet e mëposhtme:

- (a) shoqëria e investimit;
- (b) shoqëria administruese ose depozitari që vepron për llogari të një fondi të përbashkët.

Megjithatë, SIKTT-të mund të blejnë valutë të huaj nëpërmjet një huaje ndërmjet personash të lidhur.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1, një shtet anëtar mund ta autorizojë një SIKTT që të marrë hua, me kusht që kjo hua:

(a) të jetë e përkohshme dhe të përfaqësojë:

- në rastin e shoqërisë së investimit, jo më shumë se 10% të aseteve të saj, ose
- në rastin e një fondi të përbashkët, jo më shumë se 10% të vlerës së fondit; ose

(b) të mundësojë blerjen e pasurive të paluajtshme që janë thelbësore drejtpërsëdrejti për ushtrimin e veprimtarisë së saj tregtare dhe, në rastin e shoqërisë së investimit, të përfaqësojë jo më shumë se 10% të aseteve të saj.

Kur një SIKTT autorizohet të marrë hua sipas pikave (a) dhe (b), kjo hua nuk duhet të tejkalojë 15% të totalit të aseteve të saj.

Neni 84

1. SIKTT-ja i riblen ose shlyen kuotat e saj me kërkesën e mbajtësit të kuotave.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1:

- (a) një SIKTT mund ta pezullojë përkohësisht riblerjen ose shlyerjen e kuotave të saj, në përputhje me ligjin e zbatueshëm, rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit;
- (b) shteti anëtar i origjinës së një SIKTT-je mund t'i lejojë autoritetet e tij kompetente që të kërkojnë pezullimin e riblerjes ose shlyerjes së kuotave në interes të mbajtësve të kuotave ose të publikut.

Pezullimi i përkohshëm i përmendur në germën (a) të nënparagrafit të parë parashikohet vetëm për raste të veçanta, kur rrethanat e kërkojnë diçka të tillë, dhe kur justifikohet me faktin që është në interes të mbajtësve të kuotave.

3. Në rastin e pezullimit të përkohshëm sipas paragrafit 2, germa (a), SIKTT-ja ia komunikon menjëherë vendimin e saj autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së saj dhe autoriteteve kompetente të të gjitha shteteve anëtare ku tregton kuotat e saj.

Neni 85

Rregullat për vlerësimin e asetëve dhe rregullat për llogaritjen e çmimit të shitjes ose emetimit dhe të çmimit të riblerjes ose shlyerjes së kuotave të një SIKTT-je, përcaktohen në ligjin e zbatueshëm kombëtar, në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit.

Neni 86

Shpërndarja ose riinvestimi i të ardhurave të një SIKTT-je kryhet në përputhje me legjislacionin dhe me rregullat e fondit ose dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit.

Neni 87

Nëse vlera ekuivalente e çmimit neto të emetimit nuk është derdhur në asetet e SIKTT-së brenda kufijve kohorë normalë, kuotat e SIKTT-së nuk emetohen. Kjo nuk cenon shpërndarjen e kuotave të shpërblimit.

Neni 88

1. Pa cenuar zbatimin e neneve 50 dhe 51, subjektet e mëposhtme nuk japin hua dhe nuk veprojnë si dorëzanës për llogari të palëve të treta:

- (a) shoqëria e investimit;
- (b) shoqëria administruese ose depozitari që vepron për llogari të një fondi të përbashkët.

2. Paragrafi 1 nuk i pengon sipërmarrjet e përmendura aty që të blejnë tituj të transferueshëm, instrumente të tregut të parasë ose instrumente të tjera financiare të përmendura në germet (e), (g) dhe (h) të nenit 50, paragrafi 1, të cilat nuk janë paguar plotësisht.

Neni 89

Nuk kryejnë shitje të pambuluara të titujve të transferueshëm, instrumenteve të tregut të parasë ose instrumenteve të tjera financiare, të përmendura në germet (e), (g) dhe (h) të Nenit 50 paragrafi 1, këto subjekte:

- (a) shoqëria e investimit;
- (b) shoqëria administruese ose depozitari që vepron për llogari të një fondi të përbashkët.

Neni 90

Shpërblimi dhe shpenzimet që shoqëria administruese mund t'i ngarkojë një fondi të përbashkët, si dhe mënyra e llogaritjes së këtij shpërblimi, parashikohen në legjislacionin e shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së ose në rregullat e fondit.

Natyra e kostove që do të mbulohen nga shoqëria e investimit, parashikohet në legjislacion ose në dokumentet e themelimit të kësaj shoqërie.

KAPITULLI XI
DISPOZITA TË VEÇANTA TË ZBATUESHME PËR SIKTT-TË QË MARKETOJNË
KUOTAT E TYRE NË SHTETE ANËTARE, PËRVEÇ SHTETIT KU JANË
THEMELUAR

Neni 91

1. Shtetet anëtare pritëse të SIKTT-ve u garantojnë këtyre të fundit mundësinë e tregtimit të kuotave të tyre brenda territorit të këtyre shteteve, pas njoftimit në përputhje me nenin 93.
2. Për fushën që rregullohet nga kjo direktivë, shteti anëtar pritës i SIKTT-ve nuk vendos kërkesa ose procedura administrative shtesë për to, siç përmendet në paragrafin 1.
3. Shtetet anëtare garantojnë që i gjithë informacioni për ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative që nuk përfshihet në fushën që rregullohet nga kjo direktivë dhe që lidhet specifikisht me marrëveshjet e bëra për marketimin e kuotave të SIKTT-ve, të themeluara në territorin e një shteti tjetër anëtar, të mund të aksesohet lehtësisht nga distanca dhe në rrugë elektronike. Shtetet anëtare garantojnë që informacioni të jetë i disponueshëm në gjuhën e përdorur gjerësisht në sferën e financave ndërkombëtare, të jepet në një mënyrë të qartë dhe jo të dykuptimtë dhe të mbahet i përditësuar.
4. Për qëllime të këtij Kapitulli, SIKTT-ja përfshin edhe divizionet e saj të investimit.

Neni 92

SIKTT-të marrin masat e nevojshme, në përputhje me ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi në shtetin anëtar ku marketohen kuotat e saj, për të garantuar disponueshmërinë e lehtësirave për kryerjen e pagesave ndaj mbajtësve të kuotave, riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe vënien në dispozicion të informacionit që SIKTT-ve u kërkohet të ofrojnë.

Neni 93

1. Nëse SIKTT-ja propozon që t'i marketojë kuotat e saj në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së saj, ajo duhet të njoftojë fillimisht me shkrim autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës.
Njoftimi duhet të përmbajë informacion për marrëveshjet e bëra për marketimin e kuotave të SIKTT-së në shtetin anëtar pritës, duke përfshirë, sipas rastit, edhe informacion për kategoritë e aksioneve. Në kontekstin e nenit 16, paragrafi 1, njoftimi duhet të përmbajë cilësimin që SIKTT-ja po marketohet nga shoqëria administruese e saj.
2. Së bashku me njoftimin e përmendur në paragrafin 1, SIKTT-ja duhet të dërgojë edhe versionin më të fundit të:
 - (a) rregullave të fondit ose dokumenteve të themelimit, prospektit të saj dhe, sipas rastit, raportin vjetor më të fundit dhe çdo raport gjashtëmujor vijues, të përkthyer në përputhje me

dispozitat e nenit 94, paragrafi 1, germa (c) dhe (d); dhe

(b) informacionit kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78, të përkthyer në përputhje me nenin 94 paragrafi 1 germa (b) dhe (d).

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së verifikojnë nëse dokumentacioni i dorëzuar nga SIKTT-ja, në përputhje me paragrafët 1 dhe 2, është i plotë.

Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së ia përcjellin të gjithë dokumentacionin e përmendur në paragrafët 1 dhe 2, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar ku SIKTT-ja propozon të marketojë kuotat e saj, brenda 10 ditësh pune nga data e marrjes së njoftimit, së bashku me të gjithë dokumentacionin e parashikuar në paragrafin 2. Ato i bashkëngjisin dokumentacionit që dërgojnë, edhe vërtetimin se SIKTT-ja përmbush kushtet e parashikuara nga kjo direktivë.

Pas përcjelljes së dokumentacionit, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, e njoftojnë menjëherë këtë të fundit për përcjelljen e tyre. SIKTT-ja mund të hyjë në tregun e shtetit anëtar pritës së saj, duke filluar nga data e dërgimit të këtij njoftimi.

4. Shtetet anëtare sigurohen që njoftimi i përmendur në paragrafin 1 dhe vërtetimi i përmendur në paragrafin 3, të jenë në gjuhën e përdorur gjerësisht në sferën e financave ndërkombëtare, me përjashtim të rastit kur shteti anëtar i origjinës dhe shteti anëtar pritës i SIKTT-së bien dakord për dhënien e tyre në një gjuhë zyrtare të të dyja shteteve.

5. Shtetet anëtare sigurohen që autoritetet e tyre kompetente të pranojnë përcjelljen dhe dërgimin elektronik të dokumenteve të përmendura në paragrafin 3.

6. Për qëllime të procedurës së njoftimit, të përcaktuar në këtë nen, autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku SIKTT-ja propozon të marketojë kuotat e saj nuk duhet të kërkojnë dokumente, certifikata apo të dhëna tjera përveç atyre të parashikuara në këtë nen.

7. Shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së garanton aksesin, nëpërmjet rrugëve elektronike, të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së, në dokumentet e përmendura në paragrafin 2 dhe, sipas rastit, në çdo përkthim të tyre. Ai garanton përditësimin e këtyre dokumenteve dhe përkthimeve nga SIKTT-ja. SIKTT-ja njofton autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të saj për çdo ndryshim të bërë në dokumentet e përmendura në paragrafin 2 dhe tregon se ku mund të merren elektronikisht këto dokumente.

8. Në rast ndryshimi në informacionin lidhur me masat e marra për marketimin e bërë të ditur në njoftimin, sipas paragrafit 1, ose të ndonjë ndryshimi në kategoritë e aksioneve që do të marketohen, atëherë SIKTT-ja duhet t'u dërgojë njoftim me shkrim autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës, përpara se të bëjë ndryshimin.

Neni 94

1. Kur një SIKTT i tregon kuotat e saj në një shtet anëtar pritës, ajo u jep investitorëve në territorin e këtij shteti anëtar, të gjithë informacionin dhe dokumentet që duhet t'u japë investitorëve në shtetin anëtar të origjinës, sipas Kapitullit IX.

Informacioni dhe dokumentet në fjalë u jepen investitorëve, në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

- (a) pa cenuar dispozitat e Kapitullit IX, këto informacione ose dokumente u jepen investitorëve në mënyrën e parashikuar nga ligjet, rregulloret ose dispozitat administrative të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së;
 - (b) informacioni kryesor për investitorët, i përmendur në nenin 78 përkthehet në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së, ose në gjuhën e miratuar nga autoritetet kompetente të këtij shteti anëtar;
 - (c) informacioni ose dokumentet e tjera, të ndryshme nga informacioni kryesor për investitorët, përmendur në nenin 78, përkthehet, sipas zgjedhjes së SIKTT-së, në gjuhën zyrtare ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së, në një gjuhë të miratuar nga autoritetet kompetente të këtij shteti anëtar, ose në gjuhën e përdorur gjerësisht në sferën e financave ndërkombëtare; dhe
 - (d) përkthimet e informacionit ose dokumenteve sipas germave (b) dhe (c) bëhen nën përgjegjësinë e SIKTT-së dhe pasqyrojnë me përpikëri përmbajtjen e informacionit origjinal.
2. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 zbatohen edhe për çdo ndryshim në informacionin dhe dokumentet e përmendura në të.
3. Shpeshtësia e publikimit të çmimit të emetimit, shitjes, riblerjes ose shlyerjes së kuotave të SIKTT-së, sipas nenit 76, i nënshtrohet ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative të shtetit anëtar të origjinës të SIKTT-së.

Neni 95

1. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese, ku specifikohet:

- (a) fusha e zbatimit të informacionit, të përmendur në nenin 91, paragrafi 3;
- (b) lehtësirat e aksesit të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së, në informacionin ose dokumentet e përmendura në nenin 93 paragrafi 1, 2 dhe 3, në përputhje me nenin 93, paragrafi 7.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive duke e plotësuar atë, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

2. Komisioni mund të miratojë edhe masa zbatuese për specifikimin e:

- (a) formës dhe përmbajtjes së modelit standard të njoftimit me shkrim, që do të përdorë SIKTT-ja për të bërë njoftimin e përmendur në nenin 93, paragrafi 1, duke përfshirë edhe të dhëna se cilave dokumente u referohen përkthimet;
- (b) formës dhe përmbajtjes së modelit standard të vërtetimit që do të përdoret nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, të përmendura në nenin 93, paragrafi 3;

(c) procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin e komunikimit elektronik ndërmjet autoriteteve kompetente, për të bërë njoftimet sipas dispozitave të nenit 93.

Këto masa miratohen në përputhje me procedurën e rregullatore, të përmendur në nenin 112, paragrafi 3.

Neni 96

Për qëllimet e kryerjes së veprimtarive të saj, një SIKTT mund të përdorë në emërtimin e saj në shtetin anëtar pritës, të njëjtën referencë për formën e saj ligjore (si p.sh., shoqëri investimi ose fond i përbashkët) që përdor edhe në shtetin anëtar të origjinës.

KAPITULLI XII

DISPOZITA PËR AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR AUTORIZIMIN DHE MBIKËQYRJEN

Neni 97

1. Shtetet anëtare caktojnë autoritetet kompetente për kryerjen e detyrave të parashikuara në këtë direktivë. Ata informojnë Komisionin për këtë, duke cilësuar çdo ndarje të detyrave.
2. Autoritetet kompetente duhet të jenë autoritete publike ose organe të caktuara nga autoritetet publike.
3. Autoritetet e shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së kanë kompetencën e mbikëqyrjes së SIKTT-së në fjalë, sipas rastit, në përputhje me nenin 19. Megjithatë, autoritetet e shtetit anëtar pritës të SIKTT-së kanë kompetencën për të mbikëqyrur përputhshmërinë me dispozitat që nuk përfshihen në fushën që rregullohet nga kjo direktivë dhe kërkesat e përcaktuara nga nenet 92 dhe 94.

Neni 98

1. Autoriteteve kompetente u jepen të gjitha kompetencat mbikëqyrëse dhe investiguese, që janë të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tyre. Këto kompetenca ushtrohen:
 - (a) në mënyrë të drejtpërdrejtë;
 - (b) në bashkëpunim me autoritete të tjera;
 - (c) nën përgjegjësinë e autoriteteve kompetente, nëpërmjet delegimit të subjektet, të cilave u janë deleguar detyrat; ose
 - (d) duke aplikuar tek autoritetet kompetente gjyqësore.
2. Sipas paragrafit 1, autoritetet kompetente kanë minimalisht këto kompetenca:
 - (a) të aksesojnë të gjitha dokumentet e çfarëdolloj dhe të marrin një kopje të tyre;

- (b) të kërkojnë informacion nga cilido person, nëse është e nevojshme, të thërrasin persona dhe t'i marrin në pyetje për qëllime të marrjes së informacioneve;
- (c) të kryejnë inspektime në terren;
- (d) të kërkojnë informacione për telefonatat ekzistuese dhe trafikun ekzistues të të dhënave;
- (e) të kërkojnë pushimin e çdo praktike që është në kundërshtim me dispozitat e miratuara, në zbatim të kësaj direktive;
- (f) të kërkojnë bllokimin ose sekuestrimin e aseteve;
- (g) të kërkojnë ndalimin e përkohshëm të veprimtarisë profesionale;
- (h) të kërkojnë informacion nga shoqëritë e autorizuar të investimit, shoqëritë administruese ose depozitarët;
- (i) të miratojnë çdo lloj mase për të garantuar që shoqëritë e investimit, shoqëritë administruese ose depozitari të vazhdojnë të veprojnë në përputhje me kërkesat e kësaj direktive;
- (j) të kërkojnë pezullimin e emetimit, riblerjes ose shlyerjes së kuotave në interes të mbajtësve të kuotave ose të publikut;
- (k) të tërheqin autorizimin që i është dhënë një SIKTT-je, një shoqërie administruese apo një depozitari;
- (l) të paraqesin çështje për ndjekje penale; dhe
- (m) të lejojnë kryerjen e verifikimeve ose investigimeve nga ekspertë kontabël ose vlerësues.

Neni 99

1. Shtetet anëtare përcaktojnë rregullat për masat dhe sanksionet e zbatueshme për shkeljen e dispozitave kombëtare, të miratuara në përputhje me këtë direktivë, dhe marrin të gjitha masat e nevojshme për të garantuar zbatimin e këtyre rregullave. Pa cenuar procedurat për tërheqjen e autorizimit ose të drejtën e shteteve anëtare për të vendosur sanksione penale, këto të fundit garantojnë veçanërisht, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, mundësinë e marrjes së masave të duhura administrative ose të vendosjes së sanksioneve administrative për personat përgjegjës në rastet kur nuk veprohet në përputhje me dispozitat e miratuara në zbatim të kësaj direktive.

Masat dhe sanksionet e parashikuara duhet të jenë efikase, proporcionale dhe shtrënguese.

2. Pa përjashtuar rregullat për masat dhe sanksionet e zbatueshme për shkeljet e dispozitave të tjera kombëtare të miratuara sipas kësaj direktive, shtetet anëtare, në veçanti, përcaktojnë masa dhe sanksione efikase, proporcionale dhe shtrënguese lidhur me detyrimin e paraqitjes së informacionit kryesor për investitorët në një mënyrë të kuptueshme për investitorët në tregun me pakicë të letrave me vlerë, në përputhje me nenin 78, paragrafi 5.

3. Shtetet anëtare i lejojnë autoritetet kompetente që të bëjnë publike çdo masë ose sanksion që do të vendoset për shkeljen e dispozitave të miratuara në zbatimin e kësaj direktive, me përjashtim të rasteve kur bërja publike e tyre mund të rrezikojë seriozisht tregjet financiare, mund të dëmtojë interesat e investitorëve ose mund të shkaktojë dëm joproportional ndaj palëve të përfshira.

Neni 100

1. Shtetet anëtare garantojnë zhvillimin e procedurave efikase dhe efektive të ankimit dhe rishqyrtimit për zgjidhjen jashtë gjykatës të mosmarrëveshjeve me konsumatorëve lidhur me veprimtarinë e SIKTT-ve, duke përdorur organet ekzistues, kur është e mundur.

2. Shtetet anëtare garantojnë se nuk do të ketë dispozita ligjore ose rregullatore që pengojnë bashkëpunimin efikas të organeve të përmendura në paragrafin 1, në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkufitare.

Neni 101

1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare bashkëpunojnë me njëri-tjetrin sa herë që lind nevoja për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive ose për ushtrimin e kompetencave të tyre sipas kësaj direktive apo legjislacionit kombëtar.

Shtetet anëtare marrin masat e nevojshme administrative dhe organizative për të lehtësuar bashkëpunimin e parashikuar në këtë paragraf.

Autoritetet kompetente i përdorin kompetencat e tyre për qëllime të bashkëpunimit edhe në rastet kur vepra nën hetim nuk përbën shkelje të ndonjë rregulloreje në fuqi në shtetin anëtar të tyre.

2. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare i japin menjëherë njëri-tjetrit informacionin e kërkuar për kryerjen e detyrave të tyre sipas kësaj direktive.

3. Kur një autoritet kompetent i një shteti Anëtar ka arsye të forta për të dyshuar se në territorin e një tjetër shteti anëtar, po kryhen ose janë kryer vepra në kundërshtim me dispozitat e kësaj direktive, nga subjekte që nuk i nënshtrohen mbikëqyrjes së këtij autoriteti kompetent, atëherë ai duhet të njoftojë autoritetet kompetente të shtetit anëtar tjetër, në mënyrën më specifike të mundshme. Autoritetet marrëse të njoftimit marrin masat e duhura, informojnë autoritetin kompetent njoftues për rezultatin e këtyre masave dhe, për sa është e mundur, për zhvillime të rëndësishme të përkohshme. Ky paragraf nuk cenon kompetencat e autoritetit kompetent njoftues.

4. Në kuadër të kompetencave sipas kësaj direktive, autoritetet kompetente të një Shteti anëtar mund të kërkojnë bashkëpunimin e autoriteteve kompetente të një tjetër shteti anëtar në një veprimtari mbikëqyrëse ose për një verifikim në terren, ose në një hetim të kryer në territorin e këtij të fundit. Kur një autoritet kompetent merr kërkesë për verifikim apo hetim në terren, ai:

(a) kryen vetë verifikimin ose hetimin;

(b) lejon kryerjen e verifikimit apo hetimit nga autoriteti kërkues; ose

(c) lejon kryerjen e verifikimit ose hetimit nga ekspertë kontabël ose vlerësues.

5. Nëse verifikimi apo hetimi kryhet në territorin e një shteti anëtar nga një autoritet kompetent i këtij shteti, autoriteti kompetent i shtetit anëtar që ka kërkuar bashkëpunimin mund të kërkojë që zyrtarët që kryejnë verifikimin apo hetimin të shoqërohen nga zyrtarë të vetë shtetit kërkues. Megjithatë, verifikimi ose hetimi i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm të shtetit anëtar në territorin e të cilit kryhet.

Nëse verifikimi apo hetimi kryhet në territorin e një shteti anëtar nga një autoritet kompetent i një tjetër shteti anëtar, atëherë autoriteti kompetent i shtetit anëtar në territorin e të cilit kryhet verifikimi apo hetimi mund të kërkojë që zyrtarët që kryejnë verifikimin apo hetimin të shoqërohen nga zyrtarë të vetë këtij shteti.

6. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar ku kryhet verifikimi ose hetimi mund ta refuzojnë shkëmbimin e informacionit të parashikuar në paragrafin 2 ose kryerjen e hetimit apo verifikimit në terren, në bazë të një kërkesë për bashkëpunim, siç parashikohet në paragrafin 4, vetëm kur:

(a) ky hetim, verifikim në terren ose shkëmbim informacioni mund të ndikojë negativisht në sovranitetin, sigurinë ose politikat publike të këtij shteti anëtar;

(b) është nisur tashmë një proces gjyqësor përpara autoriteteve të këtij shteti anëtar për të njëjtët persona dhe të njëjtat vepra;

(c) në shtetin anëtar në fjalë është dhënë tashmë një vendim i formës së prerë për të njëjtët persona dhe për të njëjtat vepra.

7. Autoritetet kompetente njoftojnë autoritetet kompetente kërkuese për çdo vendim të marrë sipas paragrafit 6. Ky njoftim përmban informacion rreth arsyeve të vendimit të tyre.

8. Autoritetet kompetente mund t'i paraqesin Komitetit Evropian të Rregullatorëve të Letrave me Vlerë, të krijuar nga Vendimi i Komisionit 2009/77/KE ⁽¹⁵⁾, situatat kur:

(a) është refuzuar ose nuk është reaguar brenda një kohe të arsyeshme, në lidhje me një kërkesë për shkëmbimin e informacionit të parashikuar në nenin 109;

(b) është refuzuar ose nuk është reaguar, brenda një kohe të arsyeshme, në lidhje me kërkesën për kryerje hetimi ose verifikimi në terren, sipas nenit 110; ose

(c) është refuzuar ose nuk është reaguar, brenda një kohe të arsyeshme, në lidhje me kërkesën për autorizimin e zyrtarëve të tij që të shoqërojnë zyrtarët e autoritetit kompetent të shtetit anëtar tjetër.

9. Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për procedurat e verifikimeve dhe hetimeve në terren.

Këto masa miratohen në përputhje me procedurën e rregullatore, të përmendur në nenin 112, paragrafi 3.

1. Shtetet anëtare parashikojnë që të gjithë personat që punojnë ose kanë punuar për autoritetet kompetente, si dhe ekspertët kontabël dhe vlerësuesit e udhëzuar nga këto autoritete, të respektojnë detyrimin e ruajtjes së sekretit profesional. Pa cenuar rastet që mbulohen nga e drejta penale, ky detyrim nënkupton që asnjë informacion konfidencial i marrë nga këta persona gjatë kryerjes së detyrave të tyre nuk duhet t'i jepet ndonjë personi apo autoriteti tjetër çfarëdo, përveçse në formë të përmbledhur ose të agreguar ku SIKTT-të, shoqëritë administruese dhe depozitarët (sipërmarrjet që kontribuojnë në veprimtarinë e biznesit të SIKTT-ve) nuk mund të identifikohen individualisht.

Megjithatë, kur është deklaruar se një SIKTT ose sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare ka falimentuar ose është në likuidim të detyrueshëm, gjatë procedimit civil ose tregtar mund të jepet informacion konfidencial që nuk lidhet me palët e treta të përfshira në përpjekjet e shpëtimit.

2. Paragrafi 1 nuk i ndalon autoritetet kompetente të shteteve anëtare që të shkëmbejnë informacion në përputhje me këtë direktivë ose ndonjë ligj tjetër komunitar, të zbatueshëm për SIKTT-të ose sipërmarrjet që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare. Ky informacion u nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, të parashikuara në paragrafin 1.

Autoritetet kompetente që shkëmbejnë informacion me autoritete të tjera kompetente sipas kësaj direktive, mund të bëjnë të ditur në kohën e komunikimit që ky informacion nuk duhet të nxirret pa miratimin e shprehur të tyre, rast në të cilin ai mund të jepet vetëm për qëllimet e miratuara nga autoritetet.

3. Shtetet anëtare mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi, ku parashikohet shkëmbimi i informacionit me autoritetet kompetente të vendeve të treta ose me autoritete ose organe të vendeve të treta të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe në nenin 103, paragrafi 1, vetëm nëse informacioni i dhënë i nënshtrohet garancive për ruajtjen e sekretit profesional, të barasvlershme të paktën me ato të përmendura në këtë nen. Shkëmbimi i këtij informacioni kryhet me qëllim që këto autoritete apo organe të kryejnë detyrën e mbikëqyrjes.

Kur informacioni vjen nga një tjetër shtet anëtar, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente dhënëse dhe në rast se nxirret, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara prej këtyre të fundit.

4. Autoritetet kompetente marrëse të informacionit konfidencial, sipas paragrafëve 1 dhe 2, mund ta përdorin këtë informacion vetëm gjatë ushtrimit të detyrave të tyre, për këto qëllime:

(a) verifikimin nëse janë përmbushur kushtet që rregullojnë nisjen e veprimtarisë tregtare të SIKTT-së, ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare, dhe lehtësimin e monitorimit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, të procedurave administrative dhe të kontabilitetit, si dhe të mekanizmave të kontrollit të brendshëm;

(b) vendosjen e sanksioneve;

(c) kryerjen e apelineve administrative kundër vendimeve të marra nga autoritetet kompetente; dhe

(d) ndjekjen e proceseve gjyqësore të nisura sipas nenit 107, paragrafi 2.

5. Paragrafët 1 dhe 4 nuk pengojnë shkëmbimin e informacionit brenda një shteti anëtar ose ndërmjet shteteve anëtare, në rastet kur ky shkëmbim do të kryhet ndërmjet një autoriteti kompetent dhe:

- (a) autoriteteve me përgjegjësi publike për mbikëqyrjen e institucioneve të kreditimit, sipërmarrjeve të investimeve, sipërmarrjeve të sigurimit ose organizatave të tjera financiare, ose autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregjeve financiare;
- (b) organeve të përfshira në likuidimin ose falimentimin e SIKTT-së, ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare, ose organeve të përfshira në procedura të ngjashme;
- (c) personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të sipërmarrjeve të sigurimit, institucioneve të kreditimit, sipërmarrjeve të investimit ose institucioneve të tjera financiare.

Në veçanti, paragrafët 1 dhe 4 nuk pengojnë ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse nga autoritetet kompetente të renditura më lart apo dhëniën organeve menaxhuese të skemave të kompensimit, të informacionit të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të tyre.

Informacioni i shkëmbyer sipas nënparagrafit të parë, i nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, të parashikuar në paragrafin 1.

Neni 103

1. Pavarësisht nenit 102, paragrafët 1 deri në 4, shtetet anëtare mund të autorizojnë shkëmbime të informacionit ndërmjet një autoriteti kompetent dhe:

- (a) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e organeve të përfshira në likuidimin dhe falimentimin e SIKTT-ve ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare, ose organeve të përfshira në procedura të ngjashme;
- (b) autoriteteve përgjegjëse për mbikëqyrjen e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të sipërmarrjeve të sigurimit, institucioneve të kreditimit, firmave të investimit ose institucioneve të tjera financiare.

2. Shtetet anëtare që mbështesin derogimin e parashikuar në paragrafin 1, duhet të kërkojnë që të përmbushen të paktën kushtet e mëposhtme:

- (a) informacioni përdoret për qëllime të kryerjes së detyrës së mbikëqyrjes, sipas paragrafit 1;
- (b) informacioni i marrë, i nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, të përcaktuara në nenin 102, paragrafi 1; dhe
- (c) kur informacioni vjen nga një tjetër shtet anëtar, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente dhënëse dhe nëse nxirret, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara

prej këtyre autoriteteve.

3. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare, emrat e autoriteteve që mund të marrin informacion sipas paragrafit 1.

4. Pavarësisht nenit 102, paragrafi 1 deri në 4, për të përforcuar stabilitetin dhe integritetin e sistemit financiar, shtetet anëtare mund të autorizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente dhe autoriteteve ose organeve përgjegjëse në zbatim të ligjit, për zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit për shoqëritë tregtare.

5. Shtetet anëtare që mbështesin derogimin e parashikuar në paragrafin 4, duhet të kërkojnë që të përmbushen të paktën kushtet e mëposhtme:

(a) informacioni përdoret për qëllime të kryerjes së detyrës, sipas paragrafit 4;

(b) informacioni i marrë i nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, sipas nenit 102 paragrafi 1; dhe

(c) kur informacioni vjen nga një tjetër shtet anëtar, ai nuk nxirret pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente dhënëse dhe nëse nxirret, kjo bëhet vetëm për qëllimet e miratuara prej këtyre autoriteteve.

Për qëllimet e germës (c), autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin 4 u komunikojnë autoriteteve kompetente dhënëse të informacionit, emrat dhe përgjegjësitë precize të personave, të cilëve do t'u dërgohet ky informacion.

6. Nëse, në një shtet anëtar, autoritetet ose organet e përmendura në paragrafin 4 e kryejnë detyrën e zbulimit ose hetimit, në ushtrim të kompetencës së tyre specifike, me ndihmën e personave të caktuar për këtë qëllim dhe që nuk janë të punësuar në sektorin publik, mundësia e shkëmbimit të informacionit, sipas këtij paragrafi mund të shtrihet edhe te këta persona, sipas kushteve të përcaktuara në paragrafin 5.

7. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit dhe shteteve të tjera anëtare, emrat e autoriteteve ose organeve që mund të marrin informacion sipas paragrafit 4.

Neni 104

1. Nenet 102 dhe 103 nuk e pengojnë një autoritet kompetent që t'u përcjellë bankave qendrore dhe organeve të tjera me funksione të ngjashme, në cilësinë e tyre si autoritete monetare, informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre; po ashtu, këto nene nuk i pengojnë këto autoritete ose organe që t'u përcjellin autoriteteve kompetente informacionin që mund t'iu nevojitet për qëllimet e nenit 102, paragrafi 4. Informacioni i marrë në këtë kontekst i nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, të parashikuara në nenin 102, paragrafi 1.

2. Nenet 102 dhe 103 nuk i ndalojnë autoritetet kompetente që t'ia komunikojnë informacionin e përmendur në nenin 102, paragrafi 1 deri në 4 një zyre kleringu ose një organi tjetër të ngjashëm, të njohur nga legjislacioni kombëtar, për ofrimin e shërbimeve të kleringut ose të shlyerjes në një nga tregjet e shtetit të tyre anëtar, nëse gjykojnë se përcjellja e informacioni

është e nevojshme për të garantuar funksionimin e duhur të këtyre organeve në lidhje me mospërbushjet ose mospërbushjet e mundshme të detyrimeve nga pjesëmarrësit në treg.

Informacioni i marrë në këtë kontekst u nënshtrohet kushteve të ruajtjes së sekretit profesional, të përcaktuara në nenin 102, paragrafi 1.

Megjithatë, shtetet anëtare garantojnë që informacioni i marrë sipas nenit 102, paragrafi 2 të mos nxirret në rrethanat e përmendura në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, pa miratimin e shprehur të autoriteteve kompetente, që e kanë dhënë atë.

3. Pavarësisht nenit 102, paragrafi 1 dhe 4, shtetet anëtare mund të autorizojnë dhënien e informacioneve të caktuara departamenteve të tjera të administratave të tyre të qeverisjes qendrore, që janë përgjegjëse për legjislacionin mbi mbikëqyrjen e SIKTT-ve dhe sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e tyre tregtare, institucioneve të kreditimit, institucioneve financiare, sipërmarrjeve të investimit dhe sipërmarrjeve të sigurimit, si dhe inspektorëve të udhëzuar nga këto departamente.

Megjithatë, ky informacion mund të jepet vetëm kur nevojitet për arsye të kontrollit të kujdesshëm.

Megjithatë, shtetet anëtare parashikojnë që informacioni i marrë sipas nenit 102, paragrafi 2 dhe 5 të mos nxirret asnjëherë në rrethanat e përmendura në këtë paragraf, me përjashtim të rasteve kur merret miratimi i shprehur i autoriteteve kompetente dhënëse të informacionit.

Neni 105

Komisioni mund të miratojë masa zbatuese për procedurat e shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente.

Këto masa miratohen në përputhje me procedurën e rregullatore, të përmendur në nenin 112, paragrafi 3.

Neni 106

1. Shtetet anëtare minimalisht parashikojnë që çdo person i miratuar në përputhje me Direktivën 2006/43/KE, i cili kryen, në një SIKTT ose sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare, auditimin ligjor të përmendur në nenin 51 të Direktivës 78/660/KEE, nenin 37 të Direktivës 83/349/KEE ose nenin 73 të kësaj direktive apo ndonjë detyrë tjetër ligjore, ka detyrimin që t'i raportojë menjëherë autoriteteve kompetente çdo fakt apo vendim lidhur me sipërmarrjen në fjalë, për të cilin ka marrë dijeni gjatë kryerjes së kësaj detyre dhe që mund të rezultojë në:

- (a) shkelje të rëndë të ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative, që përcaktojnë kushtet për rregullimin e autorizimit ose që rregullojnë specifikisht ushtrimin e veprimtarive të SIKTT-ve ose të sipërmarrjeve që kontribuojnë në veprimtarinë e saj tregtare;
- (b) dëmtimin e funksionimit të vazhdueshëm të SIKTT-së ose një sipërmarrjeje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare; ose

(c) refuzim ose shprehje të rezervave për të vërtetuar llogaritë.

Ky person ka detyrimin që të raportojë të gjitha faktet dhe vendimet që mëson gjatë kryerjes së ndonjë prej detyrave të përshkruara në germën (a) në një sipërmarrje të lidhur ngushtë, si rezultat i ushtrimit të kontrollit, me SIKTT-në ose një sipërmarrje që kontribuon në veprimtarinë e saj tregtare, në kuadër të së cilës kryen këtë detyrë personi në fjalë.

2. Dhënia në mirëbesim e ndonjë fakti apo vendimi, të përmendur në paragrafin 1, autoriteteve kompetente, nga persona të miratuar në përputhje me Direktivën 2006/43/KE, nuk përbën shkelje të ndonjë kufizimi për dhënien e informacionit të përcaktuar në kontratë ose në ndonjë dispozitë ligjore, rregullatore ose administrative dhe nuk i ngarkon këta persona me asnjë lloj detyrimi.

Neni 107

1. Autoritetet përgjegjëse japin arsye me shkrim për çdo vendim për të refuzuar autorizimin ose për çdo vendim negativ të marrë në zbatim të masave të përgjithshme, të miratuara në zbatim të kësaj direktive, dhe ia komunikojnë ato aplikantëve.

2. Shtetet anëtare parashikojnë që çdo vendim i marrë sipas ligjeve, rregulloreve ose dispozitave administrative të miratuara në përputhje me këtë direktivë, të arsyetohet siç duhet dhe t'i nënshtrohet të drejtës për apelim në gjykatë, përfshirë edhe në rastet kur nuk merret asnjë vendim brenda gjashtë muajve nga dërgimi i aplikimit për autorizim, që përmban të gjithë informacionin e kërkuar.

3. Për të garantuar zbatimin e dispozitave kombëtare, në zbatim të kësaj direktive, shtetet anëtare parashikojnë mundësinë e ankimimit, në interes të konsumatorëve dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, në gjykata ose organe administrative kompetente, nga një ose më shumë prej organeve të mëposhtme të përcaktuara nga legjislacioni kombëtar:

(a) organet publike ose përfaqësues të tyre;

(b) organizatat e konsumatorëve me interesa legjitime në mbrojtjen e konsumatorëve; ose

(c) organizatat profesionale me interesa legjitime në mbrojtjen e anëtarëve të tyre.

Neni 108

1. Nëse SIKTT-ja shkel ndonjë ligj, rregullore apo dispozitë administrative të parashikuar në rregullat e fondit ose në dokumentet e themelimit të shoqërisë së investimit, kompetencën për të ngritur padi kundër kësaj SIKTT-je e kanë vetëm autoritetet e shtetit anëtar të origjinës së saj.

Megjithatë, nëse SIKTT-ja shkel ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative në fuqi në shtetin anëtar pritës, jashtë fushës së zbatimit të kësaj direktive ose kërkesat e përcaktuara në nenet 92 dhe 94, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës mund të ngrënë padi kundër saj.

2. Autoritetet e shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së i komunikojnë autoriteteve të shtetit anëtar pritës të saj dhe, nëse shoqëria e saj administruese është themeluar në një shtet tjetër anëtar, autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese, çdo

vendim për anulimin e autorizimit apo çdo masë tjetër serioze të marrë kundër SIKTT-së, ose çdo pezullim të emetimit, riblerjes apo shlyerjes së kuotave të saj që i ngarkohet SIKTT-së në fjalë.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese ose të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së mund të ngrënë padi kundër shoqërisë administruese në rast se kjo e fundit shkel rregullat nën përgjegjësinë përkatëse të tyre.

4. Në rast se autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së kanë arsye të qarta dhe të vërtetueshme për të besuar se një SIKTT, kuotat e të cilës tregtohen brenda territorit të atij shteti anëtar, ka shkelur detyrimet që lindin nga dispozitat e miratuara në përputhje me këtë direktivë, të cilat nuk u japin kompetenca autoriteteve kompetente të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së, ato ia dërgojnë këto të dhëna autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, i cili merr masat e duhura.

5. Nëse SIKTT-ja vazhdon të veprojë në një mënyrë që cenon dukshëm interesat e investitorëve të shtetit anëtar pritës të saj, pavarësisht masave të marra nga autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së ose për shkak se këto masa rezultojnë të jenë të papërshtatshme apo sepse shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së në fjalë nuk arrin të veprojë brenda një kuadri kohor të arsyeshëm, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të SIKTT-së mund të ndërmarrin ndonjë nga veprimet e mëposhtme:

(a) pas informimit të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së, marrin të gjitha masat e përshtatshme të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve, duke përfshirë mundësinë e ndalimit të SIKTT-së që të kryejë marketimin e mëtejshëm të kuotave të saj në territorin e shtetit anëtar të origjinës; ose

(b) nëse është e nevojshme, e paraqesin çështjen te Komiteti Evropian i Rregullatorëve të Letrave me Vlerë.

Komisioni njoftohet pa vonesë për çdo masë të marrë në përputhje me germën (a) të nënparagrafit të parë.

6. Shtetet anëtare garantojnë, që brenda territorit të tyre, të jetë ligjërisht i mundshëm ofrimi i dokumenteve ligjore të nevojshme, për masat që mund të marrë shteti anëtar pritës i SIKTT-së ndaj saj, sipas paragrafëve 2 deri në 5.

Neni 109

1. Në rastet kur një shoqëri administruese operon në një ose më shumë shtete anëtare pritëse të shoqërisë administruese në fjalë, kjo përmes ofrimit të shërbimeve ose krijimit të filialeve të saj, autoritetet kompetente të të gjitha shteteve anëtare në fjalë bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin.

Ato i japin njëra-tjetrës, sipas kërkesës, të gjithë informacionin rreth menaxhimit dhe pronësisë së këtyre shoqërive administruese, që mund të lehtësojë mbikëqyrjen e tyre, si dhe të gjithë informacionin që mund të lehtësojë monitorimin e tyre. Në veçanti, autoritetet e shtetit anëtar të

originës së shoqërisë administruese bashkëpunojnë për të garantuar që shteti anëtar pritës i saj të mbledhë të dhënat e përmendura në nenin 21, paragrafi 2.

2. Për aq sa është e nevojshme për qëllimin e ushtrimit të kompetencave të mbikëqyrjes së shtetit anëtar të origjinës, autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës saj për të gjitha masat e marra nga shteti anëtar pritës në përputhje me nenin 21, paragrafi 5, të cilat përfshijnë masa ose sanksione të vendosura për shoqërinë administruese ose kufizime për veprimtaritë e kësaj shoqërie.

3. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese njoftojnë pa vonesë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së për çdo problem të konstatuar në nivelin e shoqërisë administruese, që mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në aftësinë e kësaj të fundit për të kryer siç duhet detyrat e saj lidhur me SIKTT-së ose për çdo mospërbushje të kërkesave të përcaktuara në Kapitullin III.

4. Autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së njoftojnë pa vonesë autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese për çdo problem të konstatuar në nivelin e SIKTT-së, që mund të ndikojë ndjeshëm në aftësinë e shoqërisë administruese për të kryer siç duhet detyrat e saj ose për të përmbushur kërkesat e kësaj direktive, që përfshihen në përgjegjësinë e shtetit anëtar të origjinës së SIKTT-së.

Neni 110

1. Çdo shtet anëtar pritës i shoqërisë administruese garanton që, në rastet kur një shoqëri administruese e autorizuar në një shtet anëtar tjetër ushtron veprimtari tregtare brenda territorit të saj nëpërmjet një dege, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese të kryejnë, vetë ose nëpërmjet ndërmjetësit të udhëzuar nga ata për qëllimin në fjalë, verifikimin në terren të informacionit të përmendur në nenin 109, pasi të njoftojnë autoritetet kompetente të shtetit anëtar pritës të shoqërisë administruese.

2. Paragrafi 1 nuk cenon të drejtën e autoriteteve kompetente të shtetit anëtar të origjinës së shoqërisë administruese për të kryer verifikimet në terren të degëve të krijuara brenda territorit të atij shteti anëtar, në përmbushje të përgjegjësisë që kanë sipas kësaj direktive.

KAPITULLI XIII

KOMITETI EVROPIAN I LETRAVE ME VLERË

Neni 111

Komisioni mund të miratojë ndryshime teknike në fushat e mëposhtme të kësaj direktive:

- (a) qartësimi i përkufizimeve, për të garantuar zbatimin uniform të kësaj direktive në të gjithë Komunitetin; ose
- (b) bashkërendimi i terminologjisë dhe strukturimi i përkufizimeve në përputhje me aktet e vijuese për SIKTT-të dhe çështjet që lidhen me to.

Këto masa, të cilat janë hartuar për të ndryshuar elemente jothelbësore të kësaj direktive, miratohen në përputhje me procedurën rregullatore sipas shqyrtimit të përmendur në nenin 112, paragrafi 2.

Neni 112

1. Komisioni do të ndihmohet nga Komiteti Evropian i Letrave me Vlerë, i themeluar me Vendimin e Komisionit 2001/528/KE. ⁽¹⁶⁾.
 2. Aty ku përmendet ky paragraf, gjejnë zbatim neni 5a paragrafi 1 deri në 4 dhe neni 7 i Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
 3. Kur përmendet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij.
- Periodha, sipas nenit 5 paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE, caktohet të jetë tre muaj.

KAPITULLI XIV

DEROGIMET, DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

SEKSIONI 1

Derogimet

Neni 113

1. Vetëm në rastin e SIKTT-ve daneze, *pantebreve* të emetuara në Danimarkë, do të trajtohen si të barasvlershme me titujt e transferueshëm të përmendur në nenin 50, paragrafi 1, germa (b).
2. Duke deroguar nga neni 22, paragrafi 1 dhe neni 32, paragrafi 1, autoritetet kompetente mund t'i autorizojnë SIKTT-të të cilat më 20 Dhjetor 1985, kanë pasur dy ose më shumë depozitarë, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, që të mbajnë të njëjtin numër depozitarësh nëse autoritetet në fjalë garantohen për ushtrimin në praktikë të funksioneve, sipas nenit 22, paragrafi 3 dhe nenit 32, paragrafi 3.
3. Duke deroguar nga neni 16, shtetet anëtare mund t'i autorizojnë shoqëritë administruese, që të lëshojnë certifikata me pronarë të pidentifikueshëm, që përfaqësojnë titujt e regjistruar të shoqërive të tjera.

Neni 114

1. Kompanitë e investimit, të përcaktuara në nenin 4, paragrafi 1, pika 1 të Direktivës 2004/39/KE, të autorizuara për të kryer vetëm shërbimet e parashikuara në Seksionin A paragrafi 4 dhe 5 të Shtojcës së kësaj direktive, mund autorizohen sipas kësaj direktive që të administrojnë SIKTT-të si shoqëri administruese. Në këtë rast, këto firma investimi heqin dorë nga autorizimi i dhënë sipas Direktivës 2004/39/KE.

2. Shoqëritë administruese të autorizuar për administrimin e SIKTT-ve në shtetin anëtar të origjinës së tyre përpara datës 13 Shkurt 2004, sipas Direktivës 85/611/KEE, konsiderohen se janë autorizuar për qëllimet e këtij neni, nëse ligjet e atij shteti anëtar parashikojnë se për të nisur këtë veprimtari ato duhet të përmbushin të njëjtat kushte me ato të përcaktuara në nenet 7 dhe 8.

SEKSIONI 2

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 115

Komisioni, deri më 1 Korrik 2013, i paraqet një raport Parlamentit Evropian dhe Këshillit për zbatimin e kësaj Direktive.

Neni 116

1. Shtetet anëtare, deri më 30 Qershor 2011, miratojnë dhe botojnë ligjet, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me nënparagrafin e dytë të nenit 1 paragrafi 2, nenin 1 paragrafi 3 germa (b), pikat (e), (m), (p), (q) dhe (r) të nenit 2 paragrafi 1, nenin 2 paragrafi 5, nenin 4, nenin 5 paragrafët 1 deri në 4, 6 dhe 7, nenin 6 paragrafi 1, nenin 12 paragrafi 1, fjalinë hyrëse të nenit 13 paragrafi 1, nenin 13 paragrafi 1 germa (a) dhe (i), nenin 15, nenin 16 paragrafi 1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 17 paragrafi 1, nenin 17 paragrafi 2 germa (b), nënparagrafin e parë dhe të tretë të nenit 17 paragrafi 3, nenin 17 paragrafi 4 deri në 7, nënparagrafin e dytë të nenit 17 paragrafi 9, pjesën hyrëse të nenit 18 paragrafi 1, nenin 18 paragrafi 1 germa (b), nënparagrafin e tretë dhe të katërt të nenit 18 paragrafi 2, nenin 18 paragrafi 3 dhe 4, nenet 19 dhe 20, nenin 21 paragrafi 2 deri në 6, 8 dhe 9, nenin 22 paragrafi 1, pikat (a), (d) dhe (e) të nenit 22 paragrafi 3, nenin 23 paragrafi 1, 2, 4 dhe 5, paragrafin e tretë të nenit 27, nenin 29 paragrafi 2, nenin 33 paragrafi 2, 4 dhe 5, nenet 37 deri në 42, nenin 43 paragrafi 1 deri në 5, nenet 44 deri në 49, fjalinë hyrëse të nenit 50 paragrafi 1, nenin 50 paragrafi 3, nënparagrafin e tretë të nenit 51 paragrafi 1, nenin 54 paragrafi 3, nenin 56 paragrafi 1, fjalinë hyrëse të nënparagrafit të parë të nenit 56 paragrafi 2, nenet 58 dhe 59, nenin 60 paragrafi 1 deri në 5, nenin 61 paragrafi 1 dhe 2, nenin 62 paragrafi 1, 2 dhe 3, nenin 63, nenin 64 paragrafi 1, 2 dhe 3, nenet 65, 66 dhe 67, fjalinë hyrëse dhe nenin 68 paragrafi 1 germa (a), nenin 69 paragrafi 1 dhe 2, nenin 70 paragrafi 2 dhe 3, nenet 71, 72 dhe 74, nenin 75 paragrafi 1, 2 dhe 3, nenet 77 deri në 82, nenin 83 paragrafi 1 germa (b), ndarjen e dytë të nenit 83 paragrafi 2 germa (a), nenin 86, nenin 88 paragrafi 1 germa (b), nenin 89 germa (b), nenet 90 deri në 94, nenet 96 deri në 100, nenin 101 paragrafi 1 deri në 8, nënparagrafin e dytë të nenit 102 paragrafi 2, nenin 102 paragrafi 5, nenet 107 dhe 108, nenin 109 paragrafi 2, 3 dhe 4, nenin 110 dhe Shtojcën I. Ato njoftojnë menjëherë Komisionin për këtë.

Ato i zbatojnë këto masa duke filluar nga data 1 Korrik 2011.

Shtetet anëtare, në miratimin e këtyre masave, i referohen direktivës ose i shoqërojnë ato me një referencë në rastin e botimit zyrtar të tyre. Gjithashtu, ato përfshijnë një deklaratë se referencat në ligjet, rregulloret dhe aktet administrative ekzistuese ndaj Direktivës 85/611/KEE do të

interpretohen si referencë për këtë direktivë. Mënyra se si do të bëhet kjo referencë dhe formulimi i deklaratës përcaktohet nga vetë shtetet anëtare.

2. Shtetet anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit të brendshëm, që ato miratojnë në fushën që mbulon kjo direktivë.

Neni 117

Direktiva 85/611/KEE e ndryshuar nga direktivat e renditura në Shtojcën III, pjesa A, shfuqizohet duke filluar nga data 1 Korrik 2011, pa cenuar detyrimet e shteteve anëtare në lidhje me afatet kohore për transpozimin në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin e direktivave, të përcaktuara në Shtojcën III, pjesa B.

Referencat për direktivën e shfuqizuar interpretohen si referenca për këtë direktivë dhe shpjegohen në përputhje me tabelën e përputhshmërisë në Shtojcën IV.

Referencat për prospektet e thjeshtuara, interpretohen si referenca për informacionin kryesor për investitorët, të përmendur në nenin 78.

Neni 118

1. Kjo direktivë hyn në fuqi 20 ditë pas botimit të saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 1 paragrafi 1, nënparagrafi i parë i nenit 1 paragrafi 2, neni 1 paragrafi 3 germa (a), neni 1 paragrafi 4 deri në 7, pikat (a) deri në (d), (f) deri në (l), (n) dhe (o) të nenit 2 paragrafi 1, neni 2 paragrafi 2, 3 dhe 4, neni 2 paragrafi 6 dhe 7, neni 3, neni 5 paragrafi 5, neni 6 paragrafi 2, 3 dhe 4, nenet 7 deri në 11, neni 12 paragrafi 2, neni 13 paragrafi 1 germat (b) deri në (h), neni 13 paragrafi 2, neni 14 paragrafi 1, neni 16 paragrafi 2, pikat (a), (c) dhe (d) të nenit 17 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë i nenit 17 paragrafi 3, neni 17 paragrafi 8, nënparagrafi i parë i nenit 17 paragrafi 9, neni 18 paragrafi 1 përveç fjalisë hyrëse dhe pikës (a), nënparagrafi i parë dhe nënparagrafi i dytë i nenit 18 paragrafi 2, neni 21 paragrafët 1 dhe 7, neni 22 paragrafi 2, neni 22 paragrafi 3 germa (b) dhe (c), neni 23 paragrafi 3, neni 24, nenet 25 dhe 26, paragrafi i parë dhe i dytë i nenit 27, neni 28, neni 29 paragrafi 1, 3, dhe 4, nenet 30, 31 dhe 32, neni 33 paragrafi 1 dhe 3, nenet 34, 35 dhe 36, neni 50 paragrafi 1 germat (a) deri në (h), neni 50 paragrafi 2, nënparagrafi i parë dhe i dytë i nenit 51 paragrafi 1, neni 51 paragrafi 2 dhe 3, nenet 52 dhe 53, neni 54 paragrafi 1 dhe 2, neni 55, nënparagrafi i parë i nenit 56 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë i nenit 56 paragrafi 2, neni 56 paragrafi 3, neni 57, neni 68 paragrafi 2, neni 69 paragrafi 3 dhe 4, neni 70 paragrafi 1 dhe 4, nenet 73 dhe 76, neni 83 paragrafi 1 pa përfshirë pikën (b), neni 83 paragrafi 2 germa (a) pa përfshirë ndarjen e dytë, nenet 84, 85 dhe 87, neni 88 paragrafi 1 pa përfshirë pikën (b), neni 88 paragrafi 2, neni 89 pa përfshirë pikën (b), neni 102 paragrafi 1, nënparagrafi i parë i nenit 102 paragrafi 2, neni 102 paragrafi 3 dhe 4, nenet 103 deri në 106, neni 109 paragrafi 1, nenet 111, 112, 113 dhe 117, si dhe Shtojcat II, III dhe IV zbatohen duke filluar nga 1 Korriku 2011.

2. Shtetet anëtare garantojnë që SIKTT-të ta zëvendësojnë prospektin e thjeshtuar të tyre, të hartuar në përputhje me dispozitat e Direktivës 85/611/KEE, me informacionin kryesor për investitorët të hartuar në përputhje me nenin 78, sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 12 muaj nga përfundimi i afatit të implementimit në legjislacionin kombëtar, të të gjitha masave zbatuese të përmendura në nenin 78, paragrafi 7. Gjatë kësaj periudhe, autoritetet kompetente të shteteve anëtare pritëse të SIKTT-ve do të vazhdojnë të pranojnë prospektin e thjeshtuar për SIKTT-të e marketuara në territorin e këtyre shteteve.

Neni 119

Kjo direktivë u drejtohet shteteve anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 13 Korrik 2009.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

H.-G. PÖTTERING

Për Këshillin

Presidenti

E. ERLANDSSON

⁽¹⁾ Opinioni i Parlamentit Evropian i 13 Janarit 2009 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 22 Qershorit 2009.

⁽²⁾ Gazeta Zyrtare L 375, 31.12.1985, f. 3.

⁽³⁾ Shih Shtojcën III, pjesa A.

⁽⁴⁾ Gazeta Zyrtare L 145, 30.4.2004, f. 1.

⁽⁵⁾ Gazeta Zyrtare L 24, 29.1.2004, f. 1.

⁽⁶⁾ Gazeta Zyrtare L 177, 30.6.2006, f. 1.

⁽⁷⁾ Gazeta Zyrtare L 177, 30.6.2006, f. 201.

⁽⁸⁾ Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, f. 23.

⁽⁹⁾ Gazeta Zyrtare C 321, 31.12.2003, f. 1.

⁽¹⁰⁾ Gazeta Zyrtare L 193, 18.7.1983, f. 1.

⁽¹¹⁾ Gazeta Zyrtare L 390, 31.12.2004, f. 38.

⁽¹²⁾ Gazeta Zyrtare L 84, 26.3.1997, f. 22.

⁽¹³⁾ Gazeta Zyrtare L 157, 9.6.2006, f. 87.

⁽¹⁴⁾ Gazeta Zyrtare L 222, 14.8.1978, f. 11.

⁽¹⁵⁾ Gazeta Zyrtare L 25, 29.1.2009, f. 18.

⁽¹⁶⁾ Gazeta Zyrtare L 191, 13.7.2001, f. 45.

SHTOJCA I

TABELA A

1. Informacion për fondin e përbashkët	1. Informacion për shoqërinë administruese, duke përfshirë cilësimin	1. Informacion për shoqërinë e investimit
--	--	---

	nëse kjo shoqëri është themeluar në një shtet anëtar të ndryshëm nga shteti anëtar i origjinës së SIKTT-së	
1.1. Emri	1.1. Emri ose lloji, forma ligjore, adresa e regjistruar dhe zyra qendrore, nëse është e ndryshme nga adresa e regjistruar.	1.1. Emri ose lloji, forma ligjore, adresa e regjistruar dhe zyra qendrore, nëse është e ndryshme nga adresa e regjistruar.
1.2. Data e krijimit të fondit të përbashkët. Cilësimi i kohëzgjatjes, nëse është e kufizuar.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Cilësimi i kohëzgjatjes, nëse është e kufizuar.	1.2. Data e themelimit të shoqërisë. Cilësimi i kohëzgjatjes, nëse është e kufizuar.
	1.3. Nëse shoqëria administron fonde të përbashkëta tjera, cilësimi i këtyre fondeve.	1.3. Në rastin e shoqërive të investimit me divizione të ndryshme investimi, cilësimi i divizioneve.
1.4. Cilësimi i vendit ku mund të merren rregullat e fondit dhe raportet periodike, nëse nuk gjenden bashkëngjitur.		1.4. Cilësimi i vendit ku mund të merren dokumentet e themelimit dhe raportet periodike, nëse nuk gjenden bashkëngjitur.
1.5. Sqarim i shkurtër për mbajtësit e kuotave, rreth sistemit tatimor të zbatueshëm për fondin e përbashkët. Detaje nëse janë bërë zbritje në burim nga të ardhurat dhe shtimi i kapitalit, që u është paguar		1.5. Sqarim i shkurtër për mbajtësit e kuotave, rreth sistemit tatimor të zbatueshëm për shoqërinë. Detaje nëse janë bërë zbritje në burim nga të ardhurat dhe shtimi i kapitalit që u është paguar mbajtësve të kuotave

mbajtësve të kuotave nga fondi i përbashkët.		nga shoqëria.
1.6. Data e kontabilitetit dhe data e shpërndarjes		1.6. Data e kontabilitetit dhe data e shpërndarjes.
1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e informacionit kontabël, të përmendur në Nenin 73.		1.7. Emrat e personave përgjegjës për auditimin e informacionit kontabël, të përmendur në Nenin 73.
	1.8. Emrat dhe pozicionet që kanë Anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse në shoqëri. Detajet e veprimtarive të tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur këto veprimtari janë të rëndësishme për shoqërinë në fjalë.	1.8. Emrat dhe pozicionet që kanë Anëtarët e organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse në shoqëri. Detajet e veprimtarive të tyre kryesore jashtë shoqërisë, kur këto veprimtari janë të rëndësishme për shoqërinë në fjalë.
	1.9. Vlera e kapitalit të nënshkruar, duke cilësuar kapitalin e paguar	1.9. Kapitali
1.10. Detaje rreth llojeve dhe karakteristikave kryesore të kuotave dhe në veçanti: — natyra e të drejtës (reale, personale ose tjetër) së përfaqësuar nga kuota, — karakteristikat e kuotave: të regjistruara ose me pronarë të pidentifikueshëm.		1.10. Detaje rreth llojeve dhe karakteristikave kryesore të kuotave dhe në veçanti: — titujt me vlerë fillestare ose certifikatat përfaqësuese të tyre; regjistrimi në një regjistër ose llogari, — karakteristikat e kuotave: të regjistruara ose me pronarë të

<p>Cilësimi i prerjeve, që mund të parashikohen për,</p> <ul style="list-style-type: none"> — titujt me vlerë fillestare ose certifikatat përfaqësuese të tyre; regjistrimi në një regjistër ose llogari, — cilësimi i të drejtave të votës, të mbajtësve të kuotave, nëse ka të tilla; — rrethanat në të cilat mund të vendoset likuidimi i fondit të përbashkët dhe procedura e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat të mbajtësve të kuotave. 		<p>paidentifikueshëm. Cilësimi i prerjeve, që mund të parashikohen për,</p> <ul style="list-style-type: none"> — cilësimi i të drejtave të votës, të mbajtësve të kuotave; — rrethanat në të cilat mund të vendoset likuidimi i shoqërisë së investimit dhe procedura e likuidimit, në veçanti në lidhje me të drejtat e mbajtësve të kuotave.
<p>1.11. Sipas rastit, cilësimin e bursave ose tregjeve, ku janë listuar ose tregtuar kuotat.</p>		<p>1.11. Sipas rastit, cilësimin e bursave ose tregjeve, ku janë listuar ose tregtuar kuotat.</p>
<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së kuotave.</p>		<p>1.12. Procedurat dhe kushtet e emetimit dhe shitjes së kuotave.</p>
<p>1.13. Procedurat dhe kushtet për riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe rrethanat në të cilat riblerja ose shlyerja mund të pezullohet.</p>		<p>1.13. Procedurat dhe kushtet për riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe rrethanat në të cilat riblerja ose shlyerja mund të pezullohet. Në rastin e shoqërive të investimit me divizione të ndryshme investimi, informacion për mënyrën</p>

		sesi një mbajtës i kuotave mund të kalojë nga një divizion tek tjetri, si dhe tarifat e zbatueshme në këto raste.
1.14. Përshkrimi i rregullave për përcaktimin dhe përdorimin e të ardhurave.		1.14. Përshkrimi i rregullave për përcaktimin dhe përdorimin e të ardhurave.
1.15. Përshkrimi objektivave të investimit të fondit të përbashkët, duke përfshirë objektivat e tij financiarë (p.sh., rritja e kapitalit ose të ardhurat), politikën e investimit (p.sh., specializimin në sektorin gjeografik ose industrial), të gjitha kufizimet në këtë politikë investimi dhe cilësimin e të gjitha teknikave dhe instrumenteve ose kompetencave për huamarrje, që mund të përdoren në menaxhimin e fondit të përbashkët.		1.15. Përshkrimi i objektivave të investimit të shoqërisë, duke përfshirë objektivat financiarë (p.sh., rritja e kapitalit ose të ardhurat), politikën e investimit (p.sh., specializimin në sektorin gjeografik ose industrial), të gjitha kufizimet në këtë politikë investimi dhe cilësimin e të gjitha teknikave dhe instrumenteve ose kompetencave për huamarrje, që mund të përdoren në menaxhimin e shoqërisë.
1.16. Rregullat për vlerësimin e aseteve.		1.16. Rregullat për vlerësimin e aseteve.
1.17. Përcaktimi i çmimit të shitjes ose emetimit dhe i çmimit të riblerjes ose shlyerjes së kuotave, në veçanti: — mënyra dhe frekuenca e llogaritjes së këtyre çmimeve, — informacion për tarifat		1.17. Përcaktimi i çmimit të shitjes ose emetimit dhe i çmimit të riblerjes ose shlyerjes së kuotave, në veçanti: — mënyra dhe frekuenca e llogaritjes së këtyre çmimeve, — informacion për tarifat

<p>e shitjes ose emetimit, si dhe për tarifën e riblerjes ose shlyerjes së kuotave,</p> <p>— mjetet, vendet dhe frekuenca e publikimit të këtyre çmimeve.</p>		<p>e shitjes ose emetimit, si dhe për tarifën e riblerjes ose shlyerjes së kuotave,</p> <p>— mjetet, vendet dhe frekuenca e publikimit të këtyre çmimeve. ⁽¹⁾.</p>
<p>1.18. Informacion për mënyrën, vlerën dhe llogaritjen e shpërblimit që fondi i përbashkët duhet t'i paguajë shoqërisë administruese, depozitarit ose palëve të treta, si dhe për kostot që do t'u rimbursohen atyre nga ky fond.</p>		<p>1.18. Informacion për mënyrën, vlerën dhe llogaritjen e pagesës që duhet t'i paguajë shoqëria drejtorëve të saj dhe Anëtarëve të organeve administrative, menaxhuese dhe mbikëqyrëse, depozitarit ose palëve të treta, si dhe për kostot e drejtorëve, depozitarit ose palëve të treta që do të rimbursojë kjo shoqëri.</p>

Informacion për depozitarin:

2.1. Emri ose lloji, forma ligjore, adresa e regjistruar dhe zyra qendrore, nëse është e ndryshme nga adresa e regjistruar;

2.2. Veprimtaria kryesore.

Informacion për firmat e konsulencës ose konsulentët e jashtëm të investimit, që ofrojnë konsulencë në zbatim të kontratës së paguar nga asetet e SIKTT-së:

3.1. Emri ose lloji i firmës ose emri i konsulentit;

3.2. Dispozitat materiale të kontratës me shoqërinë administruese ose shoqërinë e investimit, që mund të kenë lidhje me mbajtësit e kuotave, përveç atyre që lidhen me shpërblimin;

3.3. Veprimtari të tjera të rëndësishme.

4. Informacion rreth masave për kryerjen e pagesave ndaj mbajtësve të kuotave, për riblerjen ose shlyerjen e kuotave dhe vënien në dispozicion të informacionit rreth SIKTT-ve. Në çdo rast, ky informacion duhet të jepet në Shtetin Anëtar ku është themeluar SIKTT-ja. Përveç kësaj, nëse kuotat marketohen në një tjetër Shtet Anëtar, ky informacion jepet për atë shtet, në prospektin e publikuar në atë shtet.

Informacione të tjera rreth investimeve:

5.1. Historikun e performancës së SIKTT-së (sipas rastit) - ky informacion mund të përfshihet në prospekt ose t'i bashkëngjitet atij;

5.2. Profili i investitorit tipik për të cilin është projektuar SIKTT-ja.

Informacioni ekonomik:

6.1. Shpenzimet ose tarifat e mundshme, përveç tarifave të përmendura në pikën 1.17, duke bërë dallimin ndërmjet tarifave që duhen paguar nga mbajtësi i kuotave dhe atyre që duhen paguar nga asetet e SIKTT-së.

TABELA B

Informacioni që duhet përfshirë në raportet periodike

I. Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve:

- titujt e transferueshëm,
- gjendja e llogarive bankare,
- asetet e tjera,
- totali i asetëve,
- pasivët,
- vlera neto e asetëve.

II. *Numri i kuotave në qarkullim*

III. *Vlera neto e asetëve për kuotë*

IV. Portofoli, duke bërë dallimin ndërmjet:

- (a) titujve të transferueshëm të pranuar në listimet zyrtare në bursë;
- (b) titujve të transferueshëm të tregtuar në një treg tjetër të rregulluar;
- (c) titujve të transferueshëm të llojit të përmendur në nenin 50, paragrafi 1, germa (d), të emetuar së fundmi;
- (d) titujve të transferueshëm të tjerë, të llojit të përmendur në nenin 50, paragrafi 2, germa (a); dhe të analizuar në përputhje me kriteret më të përshtatshme, në kuadër të politikës së investimit të SIKTT-së (p.sh., në përputhje me kriteret ekonomike, gjeografike ose monetare), si përqindje e asetëve neto; për secilin nga investimet e mësipërme, cilësimin e përqindjes që përfaqëson në raport me totalin e asetëve të SIKTT-së.

Deklaratën e ndryshimeve në përbërjen e portofolit, gjatë periudhës së parashikuar.

V. Deklarata e zhvillimeve në lidhje me asetet e SIKTT-së, gjatë periudhës së referencës, duke përfshirë elementet e mëposhtme:

- të ardhurat nga investimet,
- të ardhura të tjera,
- tarifatat e administrimit,
- tarifatat e depozitarit,
- tarifa dhe taksa të tjera,
- të ardhurat neto,
- të ardhurat e shpërndara dhe të riinvestuara,
- ndryshimet në llogarinë kapitale,
- rritjen e vlerës ose amortizimin e investimeve,
- çdo ndryshim tjetër që ndikon në aktivet dhe pasivet e SIKTT-së,
- kostot e transaksioneve, të cilat janë kostot që i shkaktohen një SIKTT-je në lidhje me transaksionet në portofolin e saj.

VI. Një tabelë krahasuese që mbulon tre vitet e fundit financiarë dhe e cila, për secilin vit financiar, në fund të vitit financiar, përfshin:

- vlerën e plotë neto të aseteve,
- vlerën neto të aseteve për kuotë.

VII. *Detajet e shumës që rezulton nga angazhimet, sipas kategorisë së transaksionit në kuptim të Nenit 51 të kryer nga SIKTT-ja gjatë periudhës së referencës.*

(¹) Shoqëritë e investimit, në kuptim të nenit 32, paragrafi 5 të kësaj direktive, bëjnë të ditur edhe:

- metodën dhe frekuencën e llogaritjes së vlerës neto të kuotave,
- mjetet, vendin dhe frekuencën e publikimit të kësaj vlere,
- bursën në vendin e marketimit, ku çmimet në të përcaktojnë çmimin e transaksioneve të kryera jashtë bursës së këtij vendi.

SHTOJCA II

Funksionet e përfshira në veprimtarinë e administrimit të portofolit kolektiv:

- Administrimi i investimit.

— Administrimi:

- (a) shërbimet ligjore dhe kontabël në lidhje me administrimin e fondeve;
- (b) përgjigje për pyetjet e klientëve;
- (c) vlerësimi dhe përcaktimi i çmimit (përfshirë deklaratat tatimore);
- (d) monitorimi i pajtueshmërisë me rregulloret;
- (e) mbajtja e regjistrit të mbajtësve të kuotave;
- (f) shpërndarja e të ardhurave;
- (g) emetimet dhe shlyerjet e kuotave;
- (h) zgjidhja e mosmarrëveshjeve kontraktuale (përfshirë edhe dërgimin e certifikatave);
- (i) mbajtja e të dhënave.

— Marketimi.

SHTOJCA III

PJESA A

Direktiva e shfuqizuar me listën e ndryshimeve vijuese

(përmendur në Nenin 117)

Direktiva e Këshillit 85/611/KEE (Gazeta Zyrtare L 375, 31.12.1985, f. 3).	
Direktiva e Këshillit 88/220/KEE (Gazeta Zyrtare L 100, 19.4.1988, f. 31).	
Direktiva 95/26/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 168, 18.7.1995, f. 7).	Neni 1, ndarja e katërt, Neni 4 paragrafi 7 dhe Neni 5, vetëm ndarja e pestë
Direktiva 2000/64/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 290, 17.11.2000, f. 27).	Vetëm Neni 1
Direktiva 2001/107/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 41, 13.2.2002, f. 20).	

Direktiva 2001/108/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 41, 13.2.2002, f. 35).	
Direktiva 2004/39/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 145, 30.4.2004, f. 1).	Vetëm Neni 66
Direktiva 2005/1/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 79, 24.3.2005, f. 9).	Vetëm Neni 9
Direktiva 2008/18/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (Gazeta Zyrtare L 76, 19.3.2008, f. 42).	

PJESA B

Lista e afateve kohore për transpozim në legjislacionin e brendshëm dhe zbatimin

(përmendur në Nenin 117)

Direktiva	Afati për transpozim	Data e zbatimit
85/611/KEE	1 Tetor 1989	—
88/220/KEE	1 Tetor 1989	—
95/26/KE	18 Korrik 1996	—
2000/64/KE	17 Nëntor 2002	—
2001/107/KE	13 Gusht 2003	13 Shkurt 2004
2001/108/KE	13 Gusht 2003	13 Shkurt 2004
2004/39/KE	—	30 Prill 2006
2005/1/KE	13 Maj 2005	—

SHTOJCA IV

Tabela e përputhshmërisë

Direktiva 85/611/KEE	Kjo Direktivë
Neni 1 paragrafi 1	Neni 1 paragrafi 1
Neni 1 paragrafi 2, fjalia hyrëse	Neni 1 paragrafi 2, fjalia hyrëse

Neni 1 paragrafi 2, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 1 paragrafi 2 germat (a) dhe (b)
—	Neni 1 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë
Neni 1 paragrafi 3, nënparagrafi i parë	Neni 1 paragrafi 3, nënparagrafi i parë
Neni 1 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë	Neni 1 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë, germa (a)
—	Neni 1 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë, germa (b)
Neni 1 paragrafët 4 deri në 7	Neni 1 paragrafët 4 deri në 7
Neni 1 paragrafi 8, fjalia hyrëse	Neni 2 paragrafi 1 germa (n), fjalia hyrëse
Neni 1 paragrafi 8, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 2 paragrafi 1 germa (n), pikat (i), (ii) dhe (iii)
Neni 1 paragrafi 8, fjalia e fundit	Neni 2 paragrafi 7
Neni 1 paragrafi 9	Neni 2 paragrafi 1 germa (o)
Neni 1a, fjalia hyrëse	Neni 2 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 1a pika 1	Neni 2 paragrafi 1 germa (a)
Neni 1a pika 2, pjesa e parë e fjalisë	Neni 2 paragrafi 1 germa (b)
Neni 1a pika 2, pjesa e dytë e fjalisë	Neni 2 paragrafi 2
Neni 1a, pikat 3 deri në 5	Neni 2 paragrafi 1 germa (c) deri në (e)
Neni 1a pika 6	Neni 2 paragrafi 1 germa (f)
Neni 1a pika 7, pjesa e parë e fjalisë	Neni 2 paragrafi 1 germa (g)
Neni 1a pika 7, pjesa e dytë e fjalisë	Neni 2 paragrafi 3
Neni 1a, pikat 8 deri në 9	Neni 2 paragrafi 1 germat (h) deri në (i)
Neni 1a, pika 10, nënparagrafi i parë	Neni 2 paragrafi 1 germa (j)
Neni 1a, pika 10, nënparagrafi i dytë	Neni 2 paragrafi 5
Neni 1a pika 11	—
Neni 1a, pikat 12 dhe 13, fjalia e parë	Neni 2 paragrafi 1 pikat (i) dhe (ii)
Neni 1a, pika 13, fjalia e dytë	Neni 2 paragrafi 4 germa (a)
Neni 1a, pikat 14 dhe 15, fjalia e parë	Neni 2 paragrafi 1 germat (k) dhe (l)
Neni 1a, pika 15, fjalia e dytë	Neni 2 paragrafi 6

—	Neni 2 paragrafi 1 germa (m)
Neni 2 paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 3, fjalia hyrëse
Neni 2 paragrafi 1, ndarja e parë, e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 3 germat (a), (b), (c) dhe (d)
Neni 2 paragrafi 2	—
Neni 3	Neni 4
Neni 4 paragrafi 1 dhe 2	Neni 5 paragrafi 1 dhe 2
—	Neni 5 paragrafi 3
Neni 4 paragrafi 3, nënparagrafi i parë	Neni 5 paragrafi 4, nënparagrafi i parë, germat (a) dhe (b)
—	Neni 5 paragrafi 4, nënparagrafi i dytë
Neni 4 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë	Neni 5 paragrafi 4, nënparagrafi i tretë
Neni 4 paragrafi 3, nënparagrafi i tretë	Neni 5 paragrafi 4, nënparagrafi i katërt
Neni 4 paragrafi 3a	Neni 5 paragrafi 5
Neni 4 paragrafi 4	Neni 5 paragrafi 6
—	Neni 5 paragrafi 7
Neni 5 paragrafi 1 dhe 2	Neni 6 paragrafi 1 dhe 2
Neni 5 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse	Neni 6 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 5 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (a)	Neni 6 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (a)
Neni 5 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (b), fjalia hyrëse	Neni 6 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (b), fjalia hyrëse
Neni 5 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (b), ndarja e parë dhe e dytë	Neni 6 paragrafi 3, nënparagrafi i parë, germa (b) pika (i) dhe (ii)
Neni 5 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë	Neni 6 paragrafi 3, nënparagrafi i dytë
Neni 5 paragrafi 4	Neni 6 paragrafi 4
Neni 5a paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 7 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 5a paragrafi 1 germa (a), fjalia hyrëse	Neni 7 paragrafi 1 germa (a), fjalia hyrëse
Neni 5a paragrafi 1 germa (a), ndarja e parë	Neni 7 paragrafi 1 germa (a) pika (i)

Neni 5a paragrafi 1 germa (a), ndarja e dytë, fjalia hyrëse	Neni 7 paragrafi 1 germa (a) pika (ii), fjalia hyrëse
Neni 5a paragrafi 1 germa (a), ndarja e dytë, pikat (i), (ii) dhe (iii)	Neni 7 paragrafi 1 germa (a) pika (ii), ndarja e parë, e dytë dhe e tretë
Neni 5a paragrafi 1 germa (a), ndarja e tretë dhe e katërt	Neni 7 paragrafi 1 germa (a) pika (iii)
Neni 5a paragrafi 1 germa (a), ndarja e pestë	—
Neni 5a paragrafi 1 germat (b) deri në (d)	Neni 7 paragrafi 1 germat (b) deri në (d)
Neni 5a paragrafët 2 deri në 5	Neni 7 paragrafët 2 deri në 5
Neni 5b	Neni 8
Neni 5c	Neni 9
Neni 5d	Neni 10
Neni 5e	Neni 11
Neni 5f paragrafi 1, nënparagrafi i parë	Neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi i parë
Neni 5f paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germa (a)	Neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germa (a)
Neni 5f paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germa (b), fjalia e parë	Neni 12 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germa (b)
Neni 5f paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germa (b), fjalia e fundit	—
Neni 5f paragrafi 2, fjalia hyrëse	Neni 12 paragrafi 2, fjalia hyrëse
Neni 5f paragrafi 2, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 12 paragrafi 2 germat (a) dhe (b)
—	Neni 12 paragrafi 3
Neni 5g	Neni 13
Neni 5h	Neni 14 paragrafi 1
—	Neni 14 paragrafi 2
—	Neni 15
Neni 6 paragrafi 1	Neni 16 paragrafi 1, nënparagrafi i parë
—	Neni 16 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë
Neni 6 paragrafi 2	Neni 16 paragrafi 2

—	Neni 16 paragrafi 3
Neni 6a paragrafi 1	Neni 17 paragrafi 1
Neni 6a paragrafi 2	Neni 17 paragrafi 2
Neni 6a paragrafi 3	Neni 17 paragrafi 3, nënparagrafi i parë dhe i dytë
—	Neni 17 paragrafi 3, nënparagrafi i tretë
—	Neni 17 paragrafët 4 deri në 5
Neni 6a paragrafët 4 deri në 6	Neni 17 paragrafët 6 deri në 8
Neni 6a paragrafi 7	Neni 17 paragrafi 9, nënparagrafi i parë
—	Neni 17 paragrafi 9, nënparagrafi i dytë
Neni 6b paragrafi 1	Neni 18 paragrafi 1
Neni 6b paragrafi 2	Neni 18 paragrafi 2, nënparagrafi i parë dhe i dytë
—	Neni 18 paragrafi 2, nënparagrafi i tretë
Neni 6b paragrafi 3, nënparagrafi i parë	Neni 18 paragrafi 2, nënparagrafi i katërt
Neni 6b paragrafi 3, nënparagrafi i dytë	—
—	Neni 18 paragrafi 3
Neni 6b paragrafi 4	Neni 18 paragrafi 4
Neni 6b paragrafi 5	—
—	Nenet 19 deri në 20
Neni 6c paragrafi 1	Neni 21 paragrafi 1
Neni 6c paragrafi 2, nënparagrafi i parë	—
Neni 6c paragrafi 2, nënparagrafi i dytë	Neni 21 paragrafi 2, nënparagrafi i parë dhe i dytë
—	Neni 21 paragrafi 2, nënparagrafi i tretë
Neni 6c paragrafët 3 deri në 5	Neni 21 paragrafët 3 deri në 5
Neni 6c paragrafi 6	—
Neni 6c paragrafët 7 deri në 10	Neni 21 paragrafët 6 deri në 9
Neni 7	Neni 22

Neni 8	Neni 23 paragrafët 1 deri në 3
—	Neni 23 paragrafët 4 deri në 6
Neni 9	Neni 24
Neni 10	Neni 25
Neni 11	Neni 26
Neni 12	Neni 27, nënparagrafi i parë dhe i dytë
—	Neni 27, nënparagrafi i tretë
Neni 13	Neni 28
Neni 13a paragrafi 1 nënparagrafi i parë	Neni 29 paragrafi 1, nënparagrafi i parë
Neni 13a paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse	Neni 29 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse
Neni 13a paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 29 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germat (a), (b) dhe (c)
Neni 13a paragrafi 1, nënparagrafi i tretë dhe i katërt	Neni 29 paragrafi 1, nënparagrafi i tretë dhe i katërt
Neni 13a paragrafët 2, 3 dhe 4	Neni 29 paragrafët 2, 3 dhe 4
Neni 13b	Neni 30
Neni 13c	Neni 31
Neni 14	Neni 32
Neni 15	Neni 33 paragrafët 1 deri në 3
—	Neni 33 paragrafët 4 deri në 6
Neni 16	Neni 34
Neni 17	Neni 35
Neni 18	Neni 36
—	Nenet 37 deri në 49
Neni 19 paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 1 germat (a) deri në (c)	Neni 50 paragrafi 1 germat (a) deri në (c)
Neni 19 paragrafi 1 germa (d), fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 1 germa (d), fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 1 germa (d), ndarja e parë dhe e	Neni 50 paragrafi 1 germa (d) pikat (i) dhe

dytë	(ii)
Neni 19 paragrafi 1 germa (e), fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 1 germa (e), fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 1 germa (e), ndarja e parë, e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 50 paragrafi 1 germa (e) pikat (i), (ii), (iii) dhe (iv)
Neni 19 paragrafi 1 germa (f)	Neni 50 paragrafi 1 germa (f)
Neni 19 paragrafi 1 germa (g), fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 1 germa (g), fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 1 germa (g), ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 50 paragrafi 1 germa (g) pikat (i), (ii) dhe (iii)
Neni 19 paragrafi 1 germa (h), fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 1 germa (h), fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 1 germa (h), ndarja e parë, e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 50 paragrafi 1 germa (h) pikat (i), (ii), (iii) dhe (iv)
Neni 19 paragrafi 2, fjalia hyrëse	Neni 50 paragrafi 2, fjalia hyrëse
Neni 19 paragrafi 2 germa (a)	Neni 50 paragrafi 2 germa (a)
Neni 19 paragrafi 2 germa (c)	Neni 50 paragrafi 2 germa (b)
Neni 19 paragrafi 2 germa (d)	Neni 50 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë
Neni 19 paragrafi 4	Neni 50 paragrafi 3
Neni 21 paragrafët 1 deri në 3	Neni 51 paragrafët 1 deri në 3
Neni 21 paragrafi 4	—
—	Neni 51 paragrafi 4
Neni 22 paragrafi 1, nënparagrafi i parë	Neni 52 paragrafi 1, nënparagrafi i parë
Neni 22 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse	Neni 52 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse
Neni 22 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 52 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë, germat (a) dhe (b)
Neni 22 paragrafi 2, nënparagrafi i parë,	Neni 52 paragrafi 2, nënparagrafi i parë
Neni 22 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse	Neni 52 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse
Neni 22 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 52 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë, germat (a), (b) dhe (c)
Neni 22 paragrafët 3 deri në 5	Neni 52 paragrafët 3 deri në 5

Neni 22a paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 53 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 22a paragrafi 1, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 53 paragrafi 1 germat (a), (b) dhe (c)
Neni 22a paragrafi 2	Neni 53 paragrafi 2
Neni 23	Neni 54
Neni 24	Neni 55
Neni 24a	Neni 70
Neni 25 paragrafi 1	Neni 56 paragrafi 1
Neni 25 paragrafi 2, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse	Neni 56 paragrafi 2, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 25 paragrafi 2, nënparagrafi i parë, ndarja e parë, e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 56 paragrafi 2, nënparagrafi i parë, germat (a), (b), (c) dhe (d)
Neni 25 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë	Neni 56 paragrafi 2, nënparagrafi i dytë
Neni 25 paragrafi 3	Neni 56 paragrafi 3
Neni 26	Neni 57
—	Nenet 58 deri në 67
Neni 27 paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 68 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 27 paragrafi 1, ndarja e parë	—
Neni 27 paragrafi 1, ndarja e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 68 paragrafi 1 germat (a), (b) dhe (c)
Neni 27 paragrafi 2, fjalia hyrëse	Neni 68 paragrafi 2, fjalia hyrëse
Neni 27 paragrafi 2, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 68 paragrafi 2 germat (a) dhe (b)
Neni 28 paragrafi 1 dhe 2	Neni 69 paragrafi 1 dhe 2
Neni 28 paragrafi 3 dhe 4	—
Neni 28 paragrafi 5 dhe 6	Neni 69 paragrafi 3 dhe 4
Neni 29	Neni 71
Neni 30	Neni 72
Neni 31	Neni 73
Neni 32	Neni 74

Neni 33 paragrafi 1, nënparagrafi i parë	—
Neni 33 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë	Neni 75 paragrafi 1
Neni 33 paragrafi 2	Neni 75 paragrafi 1
Neni 33 paragrafi 3	Neni 75 paragrafi 3
—	Neni 75 paragrafi 4
Neni 34	Neni 76
Neni 35	Neni 77
—	Nenet 78 deri në 82
Neni 36 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse	Neni 83 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 36 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 83 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, germat (a) dhe (b)
Neni 36 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalët e fundit	Neni 83 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 36 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë	Neni 83 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë
Neni 36 paragrafi 2	Neni 83 paragrafi 2
Neni 37	Neni 84
Neni 38	Neni 85
Neni 39	Neni 86
Neni 40	Neni 87
Neni 41 paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 88 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 41 paragrafi 1, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 88 paragrafi 1 germat (a) dhe (b)
Neni 41 paragrafi 1, fjalia e fundit	Neni 88 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 41 paragrafi 2	Neni 88 paragrafi 2
Neni 42, fjalia hyrëse	Neni 89, fjalia hyrëse
Neni 42, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 89 germat (a) dhe (b)
Neni 42, fjalia e fundit	Neni 89, fjalia hyrëse
Neni 43	Neni 90
Neni 44 paragrafët 1 deri në 3	—

—	Neni 91 paragrafët 1 deri në 4
Neni 45	Neni 92
Neni 46, paragrafi i parë, fjalia hyrëse	Neni 93 paragrafi 1, nënparagrafi i parë
—	Neni 93 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë
Neni 46, paragrafi i parë, ndarja e parë	—
Neni 46, paragrafi i parë, ndarja e dytë, e tretë dhe e katërt,	Neni 93 paragrafi 2 germa (a)
Neni 46, paragrafi i parë, ndarja e pestë	—
Neni 46, paragrafi i dytë	—
—	Neni 93 paragrafi 2 germa (b)
—	Neni 93 paragrafët 3 deri në 8
Neni 47	Neni 94
—	Neni 95
Neni 48	Neni 96
Neni 49 paragrafët 1 deri në 3	Neni 97 paragrafët 1 deri në 3
Neni 49 paragrafi 4	—
—	Nenet 98 deri në 100
Neni 50 paragrafi 1	Neni 101 paragrafi 1
—	Neni 101 paragrafët 2 deri në 9
Neni 50 paragrafët 2 deri në 4	Neni 102 paragrafët 1 deri në 3
Neni 50 paragrafi 5, fjalia hyrëse	Neni 102 paragrafi 4, fjalia hyrëse
Neni 50 paragrafi 5, ndarja e parë, e dytë, e tretë dhe e katërt	Neni 102 paragrafi 4 germat (a), (b), (c) dhe (d)
Neni 50 paragrafi 6, fjalia hyrëse dhe germat (a) dhe (b),	Neni 102 paragrafi 5, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 50 paragrafi 6 germa (b), ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 102 paragrafi 5, nënparagrafi i parë, germat (a), (b) dhe (c)
Neni 50 paragrafi 6 germa (b), fjalia e fundit	Neni 102 paragrafi 5, nënparagrafi i dytë dhe i tretë

Neni 50 paragrafi 7, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse	Neni 103 paragrafi 1, fjalia hyrëse
Neni 50 paragrafi 7, nënparagrafi i parë, ndarja e parë dhe e dytë	Neni 103 paragrafi 1 germat (a) dhe (b)
Neni 50 paragrafi 7, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse	Neni 103 paragrafi 2, fjalia hyrëse
Neni 50 paragrafi 7, nënparagrafi i dytë, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 103 paragrafi 2 germat (a), (b) dhe (c)
Neni 50 paragrafi 7, nënparagrafi i tretë	Neni 103 paragrafi 3
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i parë	Neni 103 paragrafi 4
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i dytë, fjalia hyrëse	Neni 103 paragrafi 5, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i dytë, ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 103 paragrafi 5, nënparagrafi i parë, germat (a), (b) dhe (c)
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i tretë	Neni 103 paragrafi 6
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i katërt	Neni 103 paragrafi 5, nënparagrafi i dytë
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i pestë	Neni 103 paragrafi 7
Neni 50 paragrafi 8, nënparagrafi i gjashtë	—
Neni 50 paragrafët 9 deri në 11	Neni 104 paragrafët 1 deri në 3
—	Neni 105
Neni 50a paragrafi 1, fjalia hyrëse	Neni 106 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 50a paragrafi 1 germa (a), fjalia hyrëse	Neni 106 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, fjalia hyrëse
Neni 50a paragrafi 1 germa (a), ndarja e parë, e dytë dhe e tretë	Neni 106 paragrafi 1, nënparagrafi i parë, germat (a), (b) dhe (c)
Neni 50a paragrafi 1 germa (b)	Neni 106 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë
Neni 50a paragrafi 2	Neni 106 paragrafi 2
Neni 51 paragrafi 1 dhe 2	Neni 107 paragrafi 1 dhe 2
—	Neni 107 paragrafi 3
Neni 52 paragrafi 1	Neni 108 paragrafi 1, nënparagrafi i parë

Neni 52 paragrafi 2	Neni 108 paragrafi 1, nënparagrafi i dytë
Neni 52 paragrafi 3	Neni 108 paragrafi 2
—	Neni 108 paragrafët 3 deri në 6
Neni 52a	Neni 109 paragrafi 1 dhe 2
—	Neni 109 paragrafi 3 dhe 4
Neni 52b paragrafi 1	Neni 110 paragrafi 1
Neni 52b paragrafi 2	—
Neni 52b paragrafi 3	Neni 110 paragrafi 2
Neni 53a	Neni 111
Neni 53b paragrafi 1	Neni 112 paragrafi 1
Neni 53b paragrafi 2	Neni 112 paragrafi 2
—	Neni 112 paragrafi 3
Neni 54	Neni 113 paragrafi 1
Neni 55	Neni 113 paragrafi 2
Neni 56 paragrafi 1	Neni 113 paragrafi 3
Neni 56 paragrafi 2	—
Neni 57	—
—	Neni 114
Neni 58	Neni 116 paragrafi 2
—	Neni 115
—	Neni 116 paragrafi 1
—	Nenet 117 dhe 118
Neni 59	Neni 119
Shtojca I, tabela A dhe B	Shtojca I, tabela A dhe B
Shtojca I, tabela C	—
Shtojca II	Shtojca II
—	Shtojca III
—	Shtojca IV

